

RELACION

mbi

PROJEKTLIGJIN

“PËR BUXHETIN E VITIT 2019”

HYRJE

Projektbuxheti 2019 mbështet konsolidimin e mëtejshëm të reformave të ndërmarra që promovojnë rritjen ekonomike, punësimin, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarit dhe procesin e integritetit në Bashkimin Europian.

Projektbuxheti 2019 dhe ai afatmesëm bazohen në një kuadër makroekonomik të kujdesshëm dhe realist. Politika fiskale do të vijojë të orientohet drejt konsolidimit fiskal për të vijuar **trajektoren rënëse të raportit të borxhit publik ndaj PBB**. Ky objektivi i politikës fiskale është tejte i rëndësishëm për të siguruar ambientin makroekonomik për një **rritje të qëndrueshme ekonomike mbi nivelin prej 4%**, dhe rritjen e punësimit. Rritja ekonomike dhe punësimi, do të mbështetet edhe nga objektivi tjetër i planifikuar në këtë buxhet, ai i sigurimit të një niveli të lartë të **investimeve publike prej 5% e PBB**.

Defiçiti buxhetor për vitin 2019 planifikohet në nivelin 1.9% të PBB, që është niveli më i ulët i targetuar në ligjin vjetor të buxhetit në dy dekadat e fundit. Për të katërtin vit rradhazi bilanci primar parashikohet të jetë pozitiv në nivelin 0.5% të PBB. Kjo pritet të çojë në një ulje të qenësishme të **borxhit publik** për të katërtin vit rradhazi. Në fund të vitit 2019 borxhi publik pritet të bjerë në nivelin e 64.9% të PBB.

Rritja ekonomike parashikohet të vijojë të forcohet dhe të arrijë nivelin 4.3% në vitin 2019. Norma mesatare e papunësisë parashikohet të bjerë në 12% në 2019, dhe pritet të gjenerohen mbi 30 mijë vende të reja pune.

Projektbuxheti 2019, planifikon më shumë burime si rezultat i politikave fiskale të cilat do të vazhdojnë të bazohen në taksimin e ndershëm dhe në nxitjen e investimeve private strategjike në sektorët prioritarë. Ky program bazohet në përmirësimin e administrimit fiskal dhe minimizimin e informalitetit në ekonomi. Në tre vitet e fundit, buxhetet e miratuara kanë synuar reduktimin gradual dhe të targetuar të barrës tatimorë nëpërmjet uljes së tarifave të tatimit dhe përjashtimeve të studiuara. Rritja e të ardhurave është synuar kryesisht nga zgjerimi i bazës së tatueshme, lufta ndaj informalitetit dhe përmirësimi i administrimit tatimor. Edhe Projektbuxheti i vitit 2019 synon të shpërndajë në mënyrë më të drejtë barrën fiskale, duke ulur ngarkesën për grupe, kategori dhe sektorë të caktuar.

Shpenzimet Buxhetore për periudhën 2019-2021 do të mbështesin një nivel të lartë investimesh publike duke u përqendruar në financimin e projekteve të rëndësishme strategjike. Shpenzimet e planifikuara synojnë finalizimin e projekteve të rrugëve nacionale, mbështetjen e sektorit të ujit, shëndetësisë, arsimit dhe veçanërisht për këtë vit mbështetjen e sektorit të bujqësisë. Rrijetëzimi rural do të jetë fokusi kryesor i mbështetjes së qeverisë për zhvillimin rajonal në këtë mandat katërvjeçar. Për këtë qëllim, programi *100 Fshatrat* do të synoj të koordinojë ndërhyrjet zhvillimore në hapësirën rurale të 100 fshatrave, sipas qasjes ndërsektoriale dhe me shumë aktorë. Programi konsiston në konsolidimin e investimeve publike, atyre të donatorëve dhe i investimeve private, në hapësirën e 100 fshatrave, me potenciale të larta zhvillimi ekonomiko-sociale, të agroturizmit e turizmit rural, natyrës dhe mjedisit, si dhe të trashëgimisë kulturore.

Projektbuxheti 2019 financon politika të reja për:

Rritjen e pagave në sektorët e shëndetësi, arsim parauniversitar, mbrojtje dhe sistemi penitenciar me një rritje prej 7%. Gjithashtu parashikohet dhe një rritje e pagës për punonjësit e përfaqësive diplomatike. Numri i përfituesve është 64 865 punonjës me një kosto prej 3 miliardë lekë në vit.

- Në shëndetësi përfitojnë 4,650 mjekë dhe 13,765 infermierë, në total 18,415 punonjës me një fond vjetor prej 1 miliardë lekë;
- Në arsim përfitojnë 35,783 staf mësimor me një fond vjetor prej rreth 1.4 miliardë lekë;
- Në mbrojtje përfitojnë 6,800 ushtarakë, më një fond vjetor prej rreth 300 milionë lekë;
- Në sistemin penitenciar, përfitojnë 3,560 policë të burgjeve më një fond vjetor prej 177 milionë lekë.
- Në sektorin e jashtëm, përfitojnë mbi 356 punonjës, me një fond vjetor prej 120 milion lekë.

Lehtësimin e barrës fiskale nga e cila përfitojnë:

- Mbi 15 mijë punëmarrës nga ulja e normës së tatimit mbi pagat e nivelit të mesëm;
- 20 mijë biznese ose mbi 50 mijë investitorë të kapitalit nga ulja e normës së tatimit mbi dividendin;
- 11 mijë biznese përfitojnë nga ulja e normës së tatimit mbi fitimin me 2/3;
- Mbi 50 Shoqëri të Bashkëpunimit Bujqësor nga incentivimi i fermerëve të inkuorpuar;
- Nga ulja e taksave të ndryshme si ajo e ambalazheve përfitojnë ulje kostoje dhjetra operatorë të fushës;
- Nga përjashtimet e parashikuara në Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, lehtësohet veprimtaria e qindra operatorëve ekonomikë në industrinë e fasonit, atë farmaceutike, makinerive bujqësore.

Shpërblimin për çdo lindje me synim përmirësimin e treguesit demografik të moshës mesatare të popullsisë nga e cila parashikohet të përfitojnë rreth 30 mijë familje.

Projektbuxheti 2019 garanton vazhdimin e mbështetjes financiare për thellimin e reformave të nisura në sektorë kyç të ekonomisë. Reforma në drejtësi, e cila do të marrë një mbështetje të konsiderueshme buxhetore, së bashku me reformën në administratën publike dhe reformën e menaxhimit të financave publike do të jenë instrumente të rëndësishëm të realizimit të prioriteve të programit të Qeverisë në përputhje me interesat e qytetarëve për përmirësimin e nivelit të jetesës së tyre.

Për të tretin vit radhazi vazhdon mbështetja për Reformën Administrativo-Territoriale dhe reformat e decentralizimit. Në projektbuxhetin e vitit 2019, burimet e financimit të vetëqeverisjes vendore do të rriten me rreth 5 miliardë lekë ose 11% më shumë se sa ato të vitit 2018, të cilat do shkojnë për më shumë investime dhe përmirësimin e shërbimeve publike. Ndër masat më të rëndësishme përmendim miratimin dhe zbatimin rigoroz të ligjit për financave të vetëqeverisjes vendore; dhe reformën për taksën e ndërtesave me ngritjen e strukturave të posaçme dhe krijimin e kadastrës fiskale. Të gjitha këto dëshmojnë vullnetin dhe seriozitetin e Qeverisë për zbatimin e reformës administrative-territoriale.

Në buxhetin vendor të vitit 2019, në vijim të reformës administrative-territoriale dhe decentralizimit, vënd të rëndësishëm zë **reforma e financimit të arsimit parashkollor**. Për vitin 2019, **fondet për pagat e edukatorëve do të rriten me 9.1%** në krahasim me vitin 2018. Në të njëjtën kohë do të **përmirësohet sistemi i ndarjes së fondeve ndërmjet bashkive**. Në ndryshim nga sistemi i mëparshëm, ku fondet ndaheshin sipas numrit të edukatorëve, konform praktikave të mira ndërkombëtare, financimi i këtij funksioni për vitin 2019, do të bazohet kryesisht në numrin e nxënësve (fëmijë 3-6 vjeç), si një kriter më objektiv për përcaktimin e nevojave për shpenzime. Si rrjedhojë e kësaj reforme, do të punësohen 438 mësuese (edukatore) më shumë se sa në vitin 2018, të cilët do të shkojnë në 32 bashki të cilat kanë një

nevojë më të madhe për shtimin e edukatorëve, e matur nga raporti “fëmijë për edukatore”. Kjo reformë do ketë ndikim të drejtpërdrejtë në uljen e madhësisë mesatare maksimale të grupeve në kopshte nga **26 në 18 nxënës për edukatore**, dhe madhësisë mesatare kombëtare nga **18 në 15 nxënës për edukatore**, duke krijuar kështu parakushtet për një sistem më efikas.

1. SITUATA EKONOMIKE

1.1 ZHVILLIMET KRYESORE MAKROEKONOMIKE GJATË VITIT 2018

Rritja ekonomike është forcuar. Për gjashtëmuorin e parë të vitit 2018 rezultoi një rritje ekonomike në nivelin 4.39% nga 4.08% në po të njëjtën periudhë të 2017-ës. Secili prej tremujorëve të parë dhe të dytë të vitit 2018 kanë shënuar përkatësisht norma rritjeje prej 4.46% dhe 4.32%. Rritja reale për vitin 2018 në tërësi parashikohet të jetë 4.2% në linjë me parashikimet fillestare.

Në anën e kërkesës agregate, rritja në gjysmën e parë të vitit 2018 është gjeneruar kryesisht nga kërkesa e brendshme. Në gjysmën e parë të vitit 2018 konsumi final regjistroi një rritje reale prej 2.71% duke vijuar të njëjtin trend të periudhave të mëparshme. Investimet totale për gjysmën e parë të 2018-ës regjistruan një rritje prej 2.77% në terma real.

Ndërkohë, për gjysmën e parë të vitit 2018 eksporti i mallrave dhe shërbimeve u rrit me 11.7% kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë. Vetëm exporti i mallrave u rrit me 24.8%. Për të njëjtën periudhë, importet e mallrave dhe të shërbimeve u rritën më 7.4%.

Në anën e ofertës agregate, kontributin kryesor në rritjen e gjysmës së parë të vitit 2018 e dhanë: Industria me rritje reale prej 20.51% dhe kontribut 2.64 pikë përqindje; Tregtia, akomodimi, shërbimi ushqimor, transporti, etj. me rritje 4.7% në terma real dhe kontribut prej 0.7 pikë përqindje; Aktivitete shkencore, profesionale dhe teknike me rritje 7.46% dhe kontribut 0.4 pikë përqindje; Arte, argëtim dhe çlodhje me rritje reale 6.61% dhe kontribut 0.2 pikë përqindje; si dhe Administrata publike dhe mbrojtja, arsimit dhe shëndetësia me rritje 2.1% dhe kontribut 0.2 pikë përqindje. Ndërtimi gjatë gjysmës së parë të vitit rezultoi thujase në të njëjtin nivel në terma real, më specifikisht me një rritje lehtësisht negative prej 0.26% krahasuar me një vit më parë, duke qenë neutral sa i takon kontributin në rritjen totale për këtë periudhë. I vetmi sektor që rezultoi me një rritje reale negative gjatë gjysmës së parë të 2018 ishte ai i informacionit dhe komunikacionit me -5.46%, por gjithsesi më një kontribut negativ vetëm marxhinal prej -0.16 pikë përqindje në rritjen totale në reflektim të peshës relativisht të ulët që zë ky sektor.

Zgjerimi i aktivitetit ekonomik është reflektuar edhe në tregun e punës. Sipas Anketës së Forcave të Punës, punësimi në gjysmën e parë të vitit 2018 u rrit me 3.3%, kundrejt gjysmës së parë të vitit 2017, ndërkohë shkalla e papunësisë ka vijuar trendin e saj rënës që prej T1-2014 ku shënoi pikun prej 18%, duke zbritur në 12.9% në T2-2018 për popullsinë e moshës 15-64 vjeç. Në harkun kohor të një viti, pra krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2017 ku shkalla e papunësisë regjistronte nivelin 14.3%, rezulton një reduktim prej 1.4 pikë përqindje.

Performanca e të ardhurave fiskale ka qenë i kënaqshëm. Gjatë 8-mujorit 2018 (Janar-Gusht) të ardhurat tatimore kanë njohur një rritje prej rreth 4.2% kundrejt një viti më parë, ndërsa të ardhurat nga kontributet e Sigurimeve shoqërore janë rritur me rreth 8.8% kundrejt një viti më parë.

Një ecuri pozitive paraqesin edhe zhvillimet e tregtisë së jashtme, sipas të cilave eksportet e mallrave gjatë 8-mujorit 2018, rezultojnë me një rritje prej rreth 16.1%, ndërsa importet totale të mallrave kanë

rezultuar me një rritje prej 4.0%. Gjatë tetë muajve të parë të vitit bilanci tregtar njohu një përmirësim me 5.6% kundrejt nivelit që shënonte gjatë së njëjtës periudhë një vit më parë.

Në sektorin e jashtëm, deficitin e llogarisë korrente u përmirësua ndjeshëm (rreth 18.2% më i ulët krahasuar me një vit më parë) kryesisht nga përmirësimi i deficitit tregtar (në mallra); zgjerimi i suficitit në shërbime; dhe zgjerimi i suficitit të të ardhurave dytësore. Një ndër kategoritë me kontribut domethënës pozitiv ishin shërbimet e lidhura me sektorin e turizmit, të cilat gjatë gjysmës së parë të 2018 (pra pa përfshirë ende tremujorin e tretë, i cili shënon pikun e sezonit turistik) u rritën me rreth 8.7% kundrejt gjysmës së parë të 2017. Sa i takon komponentëve të llogarisë financiare, kategoria që pati rritjen më të substanciale ishte ajo e flukseve hyrëse të investimeve të huaja direkte të cilat shënuan një rritje prej 28% gjatë gjysmës së parë të 2018 krahasuar me të njëjtën periudhë të 2017. Për gjysmën e parë të 2018 IHD financuan në masën 146% deficitin e llogarisë korrente, e cila përbën një element të rëndësishëm të qëndrueshmërisë së pozicionit të jashtëm të ekonomisë. Në tërësi Bilanci i Pagesave për gjysmën e parë të vitit rezultoi me një përmirësim kundrejt gjysmës së parë të 2017 me rreth 15%.

1.2 KRAHASIMI ME VENDET E RAJONIT

Bazuar në raportet dhe analizat e institucioneve ndërkombëtare, perspektiva afatmesme për vendet e Europës Juglindore dhe Ballkanit, parashikohet të jetë pozitive. Rritja mesatare e rajonit pritet të shkojë nga 2.4% në vitin 2017 në 3.2% në 2018 dhe 3.5% në vitin 2019.

Burimet e rritjes ndryshojnë nga vendi në vend, por kryesisht kanë qenë investimet ato që kanë mbështetur rritjen ekonomike në të gjithë rajonin. Papunësia vijon të qëndrojë në vlera të larta në rajon, por me një tendencë rënëse.

Vendet e rajonit priten të rriten më shpejt, duke u ndikuar nga qëndrueshmëria makroekonomike dhe nga përmirësimi i ekonomive europiane. Presionet inflacioniste janë në rritje dhe vlerat e inflacionit ndodhen në trajektore rritëse. Rritja ekonomike e Shqipërisë ka ndjekur një trajektore rritëse të qëndrueshme që prej vitit 2013, duke e tejkaluar mesataren e rajonit në dy vitet e fundit. Në vitin 2017 rritja ekonomike vjetore e vendit tonë ka qenë 1.4 pikë përqindje më shumë se rajoni dhe pritet që ky trend të vijojë së paku deri në 2019.

Tabela 1: Rritja e Produktit të Brendshëm Bruto (në %)

	2013	2014	2015	2016	2017*	2018 para	2019 para
<i>Rritja reale ekonomike, në %</i>							
Shqipëria	1.0	1.8	2.2	3.4	3.8	4.2	4.3
Bosnja dhe Hercegovina	2.4	1.1	3.0	3.1	3.0	3.2	3.4
Kosova	3.4	1.2	4.1	4.1	4.4	4.8	4.8
Maqedonia	2.9	3.6	3.9	2.9	0.0	2.3	2.7
Mal i Zi	3.5	1.8	3.4	2.9	4.3	2.8	2.5
Serbia	2.6	-1.8	0.8	2.8	1.9	3.0	3.5
Mesatarja e rajonit	2.5	0.3	2.2	3.1	2.4	3.2	3.5

Burimi: Raporti RER i Bankës Botërore, Pranverë 2018. Për Shqipërinë janë parashikimet e MFE

Rimëkëmbja e vazhdueshme ekonomike ka çuar në përshpejtimin e krijimit të vendeve të reja të punës në Mal të Zi, Shqipëri dhe Serbi. Ndërsa në Kosovë shkalla e punësimit është zvogëluar. Në përgjithësi, në tremujorin e parë të vitit 2018, rritja mesatare vjetore e vendeve të reja të punës në Ballkanin Perëndimor

ishite 1.5%, i ngjashëm me tremujorin e mëparshëm. Rritja e nivelit të punësimit ka kontribuar në uljen e normave të papunësisë në shumicën e vendeve të rajonit. Në përgjithësi, situata e tregut të punës në Ballkanin Perëndimor mbetet sfiduese me normat e papunësisë që variojnë nga 13.0% në Shqipëri në 26.5% në Kosovë. Në Shqipëri norma e papunësisë që prej vitit 2013 ka qënë poshtë nivelit të mesatares së rajonit dhe pritet që dhe në fund të 2018 dhe përgjatë vitit 2019 ky trend të vazhdojë të jetë i tillë.

Tabela 2 Norma e papunësisë (në %)

	2013	2014	2015	2016	2017	2018*	2019*
Shqipëria	16.4	17.9	17.5	15.6	14.1	12.9	12.0
Bosnia dhe Herzegovina	27.5	27.5	27.7	25.4	20.5	n.a	n.a
Kosovo	30.0	35.3	32.9	27.5	30.5	n.a	n.a
Maqedonia	29.0	28.0	26.1	23.8	22.4	21.9	21.6
Mal i Zi	19.5	18.2	17.8	18.0	16.4	15.6	14.8
Serbia	22.1	19.2	17.7	15.3	13.5	12.1	10.0

Burimi: ECFIN, Pranverë 2018, MFE

Dobësitë e sektorit të jashtëm u intensifikuan në disa vende të rajonit. Si rezultat i bazave të ngushta të prodhimit dhe sfidave të konkurrencës, deficitet e tregtisë së mallrave mbetën shumë të larta në të gjithë Ballkanin Perëndimor, duke filluar nga 12% e PBB-së në Serbi, në 18% ose më shumë për Maqedoninë, Shqipërinë dhe Bosnjë Hercegovinën dhe në 43% për Kosovën dhe Malin e Zi. Deficiti tregtar është kompensuar pjesërisht nga tepricat në llogarinë e shërbimeve dhe në transfertat korrente. Një analizë mbi qëndrueshmërinë e llogarisë korrente sugjeron që vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të reduktojnë deficitet e jashtme në periudhën afatmesme.

Tabela 3 Bilanci Tregtar i mallrave (% të PBB)

	2013	2014	2015	2016	2017	2018*	2019*
Shqipëria	-20.4	-22.2	-22.4	-24.2	-24.4	-23.2	-23.1
Bosnia dhe Herzegovina	-25.0	-27.8	-24.2	-22.7	-23.5	n.a	n.a
Kosovo	-40.5	-39.8	-39.8	-40.9	-42.5	n.a	n.a
Maqedoni	-22.9	-21.7	-20.1	-19.1	-17.9	-17.9	-17.9
Mal i Zi	-39.5	-39.8	-40.0	-41.9	-43.9	-38.8	-38.5
Serbia	-13.0	-13.0	-12.1	-10.5	-11.9	-11.5	-11.4

Burimi: ECFIN, Pranverë 2018, MFE

Tabela 4 Balanca Korrente (% të PBB)

	2013	2014	2015	2016	2017	2018*	2019*
Shqipëria	-9.3	-10.8	-8.6	-7.6	-6.9	-6.8	-6.4
Bosnia dhe Herzegovina	-5.0	-7.1	-5.2	-4.7	-4.7	n.a	n.a
Kosovo	-3.4	-6.9	-8.6	-8.3	-6.0	n.a	n.a
Maqedoni	-1.6	-0.5	-2.0	-3.1	-1.3	-1.2	-1.3
Mal i Zi	-11.4	-12.4	-11.0	-16.2	-16.3	-17.5	-16.7
Serbia	-6.1	-6.0	-4.7	-3.1	-5.7	-6.9	-6.9

Burimi: ECFIN, Pranverë 2018, MFE

Në muajt e parë të vitit 2018, politika e përgjithshme fiskale e kujdesshme dhe rimëkëmbja ekonomike vazhduan të mbështesin reduktimin e deficiteve fiskale në shumicën e vendeve të rajonit. Disa vende vazhduan të përjetonin shpenzime kapitale jo-performuese, duke treguar probleme të vazhdueshme në planifikim, përzgjedhjen dhe menaxhimin e investimeve publike. Megjithatë, konsolidimi i vazhdueshëm

fiskal (pa çënuar shpenzimet kapitale) është i nevojshëm në një numër vendesh për të rindërtuar hapsira fiskale dhe për të reduktuar nivelet e borxhit publik që janë shumë të larta në disa vende të rajonit.

Tabela 5 Bilanci Fiskal (Deficiti i përgjithshëm në % të PBB)

	2013	2014	2015	2016	2017*	2018 para	2019 para
<i>Balanca fiskale, (në % ndaj PBB)</i>							
Shqipëria	-5.0	-5.2	-4.1	-1.8	-2.0	-2.0	-1.9
Bosnja dhe Hercegovina	-1.8	-2.9	-0.2	0.3	2.1	1.2	0.2
Kosova	-3.1	-2.4	-1.8	-1.3	-1.4	-2.2	-3.0
Maqedonia	-4.0	-4.2	-3.4	-2.7	-2.7	-2.7	-2.5
Mal i Zi	-4.6	-3.1	-7.3	-3.1	-5.4	-3.1	-0.6
Serbia	-5.6	-6.6	-3.6	-1.3	1.2	-0.6	-0.5
Mesatarja e rajonit	-4.0	-4.2	-3.5	-1.6	-1.4	-1.6	-1.3

Burimi: Raporti RER i Bankës Botërore, Pranverë 2018, MFE

Rritja ekonomike kombinuar me disiplinën fiskale dhe mirë-menaxhimit të borxhit publik gjatë vitit 2017, uli nivelet e borxhit publik përkatësisht në Serbi, Shqipëri dhe Bosnjë Hercegovinë.

Tabela 6: Borxhi publik (% të PBB)

	2013	2014	2015	2016	2017	2018*	2019*
Shqipëria	70.4	72.0	72.7	72.3	70.1	69.1	65.5
Bosnia dhe Herzegovina	35.5	40.1	40.4	39.0	35.5	n.a	n.a
Kosova	8.9	10.7	13.1	14.6	16.6	n.a	n.a
Maqedoni	34.0	38.1	38.1	39.6	39.3	41.9	43.9
Mal i Zi	56.9	58.7	65.2	63.4	65.1	69.9	66.4
Serbia	59.6	70.4	74.7	71.9	61.6	58.9	55.9

Burimi: ECFIN, Pranverë 2018, MFE

1.3 PARASHIKIMET AFATMESME 2019-2021

Perspektiva ekonomike mbetet pozitive në periudhën afatmesme. Rritja ekonomike parashikohet të vijojë të qëndrojë mbi nivelin prej 4% përgjatë viteve 2019-2021, duke ardhur në përmirësim. Më konkretisht, rritja ekonomike parashikohet të jetë në nivelin prej 4.3% në vitin 2019. Në dy vitet e tjera rritja ekonomike parashikohet të jetë 4.4% në vitin 2020 dhe 4.5% në 2021.

Rritja pritet të mbështetet kryesisht nga kërkesa e brendshme, si konsumi privat ashtu edhe investimet. Ndërkohë kërkesa e huaj neto (eksport – import) pritet të sjellë gjithashtu një efekt pozitiv, por fare marxhinal. Konsumi privat pritet të nxitet kryesisht nga përmirësimi i besimit të konsumatorit, si dhe nga përmirësimet në tregun e punës. Këto të fundit pritet të transmetohen në një rritje graduale të pagave të cilat më tej pritet të stimulojnë të ardhurat reale të disponueshme të individëve, duke krijuar efektin e raundit të dytë në nxitjen e konsumit, si dhe duke intensifikuar prirjen e konsumatorëve për financimin e mëtejshëm të konsumit nëpërmjet një kredimarrje më të lartë. Ndërkohë, kredimarrja për konsum parashikohet të nxitet si nga përmirësimi i kushteve financiare të individëve, ashtu edhe nga lehtësimi i pritshëm i standardeve të huadhënies nga sistemi bankar. Megjithatë, edhe përgjatë një afati të mesëm ende pritet që konsumatorët të vijojnë të karakterizohen nga një sjellje relativisht prudente sa i takon konsumit.

Rritja e investimeve pritet të nxitet nga shfrytëzimi më i intensifikuar i kapaciteteve ekzistuese të prodhimit, si dhe nga përshpejtimi i aktivitetit ekonomik gjatë periudhës së parashikuar dhe perceptimi i përmirësuar i biznesit mbi perspektivën ekonomike afatmesme e afatgjatë. Njëkohësisht edhe vijimësia e përmirësimit të kushteve financiare dhe lehtësimit të standarteve të huadhënies pritet të jetë një faktor i rëndësishëm i investimeve private në afatin e mesëm.

Konsumi final total për periudhën afatmesme (2019 – 2021) parashikohet të rritet në terma real mesatarisht rreth 3.1% në vit, duke kontribuar mesatarisht rreth 2.8 pikë përqindje në vit në rritjen e PBB. Ndërsa investimet totale në ekonomi parashikohen të rriten në terma real mesatarisht rreth 5.6% në vit, me një përshpejtim të lehtë në vitin 2021, me një kontribut mesatar në rritjen totale prej rreth 1.5 pikë përqindje në vit.

Kërkesa e jashtme neto pritet të ketë efekte pozitive por të vogla në periudhën afatmesme. Eksportet e mallrave dhe shërbimeve për periudhën 2019-2021 parashikohen të rriten mesatarisht rreth 7.2% në vit në terma real, me një kontribut mesatar pozitiv prej rreth 2.3 pikë përqindje në vit në rritjen e PBB. Ndërsa importet e mallrave dhe shërbimeve për këtë periudhë afatmesme parashikohen të zgjerohen me mesatarisht rreth 4.7% në vit me një kontribut mesatar negativ në rritjen e PBB me rreth -2.1 pikë përqindje në vit. Rrjedhimisht, në terma neto kërkesa e huaj parashikohet të ketë një kontribut lehtësisht pozitiv në rritjen totale të PBB, me mesatarisht rreth 0.1 pikë përqindje në vit.

Politika fiskale do të vazhdojë drejt konsolidimit në periudhën afatmesme me efekt të kufizuar mbi konsumin. Por politika buxhetore e qeverisë e sigurimit të një niveli prej rreth 5% të PBB-së të investimeve publike, do të mbështesë krijimin e konsiderueshëm të kapitalit fiks bruto në ekonomi, e cila është e rëndësishme për të mbajtur nivele relativisht të larta rritjeje, si në afatin e shkurtër, ashtu edhe në afatin e gjatë. Në të njëjtën kohë, qëndrimi akomodues i parashikuar i politikës monetare për periudhën afatmesme, për sa kohë që presionet inflacioniste të mbeten në kahun e poshtëm, do të mbështesë gjithashtu konsumin privat dhe investimet.

Konsolidimi fiskal pritet të reduktojë më tej primet e risqeve në periudhën afatmesme dhe do të krijojë më shumë hapësira për financimin dhe zgjerimin e sektorit privat.

Rritja në periudhën afatmesme do të jetë e orientuar drejt krijimit të vendeve të punës krahasuar me historikun, pasi sektorët e prodhimit më intensiv të forcës së punës pritet të performojnë relativisht më mirë se të tjerët. Për këtë arsye, rritja e punësimit total pritet të përshpejtohet gjatë viteve 2019-2021. Ndërkohë shkalla e papunësisë përlllogaritet të zbresë në 12.0% për vitin 2019 dhe të vijojë gradualisht rënien në vitin 2020 dhe 2021, respektivisht në 11.2% dhe 10.6%.

Inflacioni pritet të rikthehet në objektivin e Bankës së Shqipërisë brenda vitit 2020, si rezultat i rritjes së konsumit privat dhe investimeve që do të mbështesin një ritëm më të shpejtë të rritjes ekonomike.

2. TREGUESIT KRYESORË TË BUXHETIT PËR VITIN 2019

2.1 PARASHIKIMI I TË ARDHURAVE PËR VITIN 2019

Programimi i të ardhurave për vitin 2019, mbështet synimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për konsolidimin e mëtejshëm fiskal, reduktimin e deficitit buxhetor dhe borxhit publik. Ky program bazohet në përmirësimin e administrimit fiskal dhe minimizimin e informalitetit në ekonomi, duke mbështetur në këtë mënyrë rritjen ekonomike të qëndrueshme, si dhe duke nxitur prodhimin dhe eksportet.

Në programimin e të ardhurave nga Tatimet dhe Doganat për vitin 2019, janë marrë në konsideratë faktorët kryesorë me ndikim në buxhet, përfshirë efektin e rritjes ekonomike dhe indeksit të çmimeve, politikat e reja fiskale si dhe efektet nga lufta kundër informalitet, e shoqëruar kjo me masa ligjore antishmangie me qëllim rritjen e nivelit të pajtimit vullnetar të tatimpaguesve me ligjin.

Metodologjia e programimit të të ardhurave është bazuar në modelet bashkëkohore të programimit, të sugjeruara dhe aplikuar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe në analizën e detajuar të faktorëve që ndikojnë në secilën taksë dhe tatim. Modelet bazë të përdorura janë:

- ✓ Parashikimet makroekonomike.
- ✓ Modeli bazuar në analizën e 60-grup produkteve kryesore në import dhe Analizën e Serive Kohore.
- ✓ Modeli bazuar në koeficientin e elasticitetit “Buoyancy” dhe “Effective Tax Rate” për çdo taksë.

Në planifikim janë harmonizuar faktorët makroekonomikë, me treguesit kryesorë që ndikojnë në taksë specifike. Janë analizuar në veçanti sasi të veçanta dhe çmimet e mallrave kryesorë të importit dhe prodhimit vendas që mbulojnë mbi 90% të vlerës së të ardhurave totale, si dhe tendenca e ecurisë së tyre për vitin në vijim. Në mënyrë të detajuar treguesit kryesorë për vlerësimin e të ardhurave janë:

- Rritja nominale e PBB-së, duke analizuar këtë efekt në mënyrë të integruar me faktorë të tjerë për çdo taksë në veçanti, të ndërlidhur me të dhënat historike dhe projeksionet e çmimeve të tregjeve ndërkombëtare tek taksat ad-valorem si Tatimi mbi Vlerën e Shtuar, Renta minerare dhe Taksë doganore.
- Kursi i këmbimit të dy monedhave kryesore: USD dhe EURO me Lekun.
- Çmimet në bursë që ndikojnë në të ardhurat nga TVSH-ja dhe Renta minerare.
- Sasi të pritshme të importit të mallrave.
- Rritja e të ardhurave nga akciza për karburantet, cigaret, pijet etj, si rezultat i rritjes së pritshme në sasi të tyre, në përputhje me konsumin. Janë programuar të zhdoganohen +200 ton ose 6.9% më shumë cigare krahasuar me realizimin e pritshëm 2018. Po kështu është parashikuar rritja me 4% e importit të karburanteve në përputhje me rritjen ekonomike dhe nevojat e tregut.
- Rritja e çmimit të naftës bruto me rreth 28%, krahasuar me muajin Gusht 2018, sipas parashikimeve “EIA- U.S Energy Information Administration”;
- Rritja e të ardhurave nga TVSH-ja në import dhe TVSH-ja brenda vendit, e shoqëruar me programimin e fondeve të nevojshme për rimbursimin në kohë të tatimpaguesve.
- Rritja e të ardhurave nga Tatimi mbi Fitimin, e cila reflekton rritjen e deklarimit dhe qarkullimit të realizuar të operatorëve ekonomikë.

Të ardhurat tatimore nga tatimet, doganat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për vitin 2019, vlerësohen të arrijnë 423.5 miliardë lekë, me një shtesë prej 27 miliardë lekë ose 6.8% më shumë se pritshmëria e vitit 2018. Të ardhurat nga DPT dhe DPD (pa përfshirë kontributet) parashikohet të jenë 325.6 miliardë lekë, me një rritje prej 6.7% ose 20.5 miliardë lekë më shumë se viti 2018.

Të ardhurat doganore janë parashikuar duke u bazuar në analizën e trendit historik të 60 grup-produkteve kryesore, për një periudhë katër-vjeçare. Ky parashikim është korriguar me efektet e faktorëve të tjerë të jashtëm në secilën taksë. E njëjta procedurë është ndjekur edhe për të ardhurat nga tatimet, duke marrë

për bazë modelin statistikor të projeksionit të të ardhurave të pritshme si dhe faktorët ekzogjenë me ndikim në çdo taksë.

Tabela 7

Tatime dhe Dogana	Fakt 2017	Plan 2018	Vlerësim Buxheti 2018	Diferenca		Diferenca	
				I pritshmi 2018 /Plani 2018	Buxhet 2019	Buxhet 2019-I pritshmi 2018	Buxhet 2019/I pritshmi 2018 ne %
TVSH	139,541	148,134	143,800	-4,334	153,314	9,514	6.6%
Tatim fitimi	31,645	33,823	31,300	-2,523	33,500	2,200	7.0%
Akciza	45,105	49,000	45,500	-3,500	48,300	2,800	6.2%
Tatimi mbi të ardhurat personale	32,102	36,800	37,400	600	43,400	6,000	16.0%
Taksa nacionale	38,502	38,340	40,100	1,760	39,700	-400	-1.0%
Taksa doganore	6,492	7,000	7,000	0	7,390	390	5.6%
Total të Ardhurat	293,387	313,097	305,100	-7,997	325,604	20,504	6.7%
Sigurime Shoqërore	73,999	78,536	78,828	292	84,142	5,314	6.7%
Sigurime Shëndetësore	11,602	12,526	12,672	146	13,729	1,057	8.3%
Total	378,988	404,160	396,600	-7,560	423,475	26,875	6.8%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Faktorët e marrë në konsideratë të cilët ndikojnë në rritjen e të ardhurave për vitin 2019 janë:

Kuadri Makroekonomik

Rritja nominale e Prodhimit të Brendshëm Bruto e skontuar me Koeficientin e Elasticitetit, është aplikuar duke analizuar këtë efekt në mënyrë të integruar me faktorë të tjerë për çdo taksë në veçanti, të ndërlidhur me të dhënat historike dhe projeksionet e çmimeve të tregjeve ndërkombëtare tek taksat ad-valorem si Tatimi mbi Vlerën e Shtuar, Renta minerare dhe Taksa doganore. Në projeksion janë përfshirë, faktorët e mëposhtëm:

- Rritja nominale e PBB-së.
- Kursi mesatar i këmbimit EURO–Lek dhe USD–Lek.
- Çmimet brent të naftës bruto dhe mineraleve të tjera.

Efektet e politikave fiskale

- Propozohet reduktim i normës së dividendit nga 15% në 8%, që vlerësohet të ketë impakt pozitiv në të ardhurat buxhetore të vitit 2019 me rreth 4.5 miliardë lekë, kjo i ofrimit të incentivës për zbatimin e kësaj norme të reduktuar edhe për fitimet e pashpërndara por të akumuluar apo të kapitalizuara të viteve të kaluara.
- Propozohet ulje e ngarkesës fiskale për të punësuarit, duke e rritur fashën e të ardhurave, nga 130.000 lekë/muaj në 150.000 lekë/muaj, që taten me normën 13%. Nëpërmjet kësaj mase synohet të ulet barra tatimore për rreth 15.400 punëmarrës. Ky ndryshim parashikohet të sjellë një efekt në buxhetin e shtetit prej -0.3 miliardë lekë.
- Rritja e akcizës së cigareve sipas kalendarit me 3 lekë/paketa me efekt 0.46 miliardë lekë;
- Ndryshimi i nivelit të akcizës për produktin e duhanit të grirë, puro dhe cigarrillos duke u rritur në masën 6,000 lekë/kg, me efekt pozitiv në buxhetin e shtetit prej 0.22 miliardë lekë.

- Ndryshime në Ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” vlerësohet të sjellin një efekt prej -0.3 miliardë lekë në të ardhurat e buxhetit të shtetit, por që parashikohet të sjellin efekte pozitive në zhvillimin e sektorëve që preken.
- Propozohet unifikim i tarifës doganore në masën 10% për të gjitha kodet tetëshifrore të kategorisë 8418 të NMK, që vlerësohet të ketë impakt pozitiv në buxhetin e shtetit në masën 0.05 miliardë lekë.

Parashikimi i të ardhurave sipas zërave për vitin 2019

Të ardhurat nga “T.V.SH-ja” parashikohet të jenë 153.3 miliardë lekë, 9.5 miliardë lekë më shumë se pritshmëria për vitin 2018, ose 6.6%. Burimet e rritjes së TVSH-se në vitin 2019 do të jenë:

- TVSH që do të gjenerohet si rezultat i rritjes ekonomike dhe indeksit të çmimeve;
- TVSH nga rritja e volumit të importeve dhe konjuktura e çmimeve ndërkombëtare;
- TVSH nga përmirësimi i administrimit, lufta ndaj informalitetit dhe kontrolli i zinxhirit të transaksioneve ndërmjet operatorëve.

Të ardhurat nga “Tatimi mbi Fitimin” vlerësohen me rritje 7% ose 2.2 miliardë lekë më shumë se viti 2018, pra parashikohet të arkëtohen 33.5 miliardë lekë. Rritja e parashikuar në tatimin mbi fitimin bazohet:

- në rritjen ekonomike të parashikuar, çka do reflektohet edhe në deklaratat e tatimpaguesve;
- në forcimin e kontrollit të deklaratave, bazuar në kriteret e riskut;
- në kontributet fiskale që do të gjenerohen nga sektori energjitik (OSHEE, KESH) të cilat në vitin 2018 paraqiten me një situatë të përmirësuar krahasuar me vitin 2017, çka do të reflektohet edhe në bilancet e tyre financiare. Theksojmë se performanca në tatimin mbi fitimin e vitit 2018 dhe rritja relativisht e ulët krahasuar me vitin 2017, lidhet me situatën energjitike që kaloi vendi në vitin 2018, e cila u reflektua në bilancet dhe kontributet fiskale të kompanive në vitin 2018.

Të ardhurat nga “Akciza” vlerësohen të jenë 48.3 miliardë lekë, me një rritje prej 2.8 miliardë lekë ose 6.2% më shumë se pritshmëritë për vitin 2018. Faktorët kryesorë që ndikojnë në rritjen e parashikuar të të ardhurave nga akciza janë:

- programimi i rritjes me 200 ton cigare krahasuar me të pritshmin 2018;
- rritja me 4% e importit/prodhimit të karburanteve;
- rritja e akcizës së cigareve me 3 lekë/paketa me efekt 0.46 miliardë lekë;
- rritja e të ardhurave nga akciza e duhanit dhe zëvendësuesve të tjerë 0.22 miliardë lekë;
- lufta kundër informalitetit, kontrolli rigoroz i subjekteve të akcizës si dhe disiplinimi i mëtejshëm i procedurave të përfitimit të përjashtimeve dhe rimbursimeve nga kjo taksë.

Të ardhurat nga “Tatimi mbi të Ardhurat Personale” parashikohen 43.4 miliardë lekë, me rritje +16% ose +6 miliardë lekë më shumë se viti 2018. Në parashikimin e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale janë marrë në konsideratë:

- rritja ekonomike dhe impakti i saj në nivelin e pagës mesatare;
- rritja e numrit të të punësuarve, bazuar në ecurinë e vitit 2018;
- uljen e të ardhurave nga rritja e pragut të taksimit të pagave me tarifën 23%, që vlerësohet në -320 milionë lekë në vit.

- uljen e normës së tatimit mbi dividendin nga 15% në 8%, përfshirë efektet pozitive që do gjenerohen nga incentiva për shpërndarjen e fitimeve të akumuluar të viteve të kaluara, që vlerësohet në 4.5 miliardë lekë.

Të ardhurat nga “Taksa Nacionale dhe të tjera” vlerësohen të jenë 39.7 miliardë lekë. Parashikimet për këtë taksë për vitin 2019 janë -1% ose 0.4 miliardë lekë më pak se i pritshmi 2018 dhe bazohen në:

- efektet e rritjes ekonomike;
- efektet nga mbyllja e lojrave të fatit e llogaritur në -4 miliardë lekë;
- efektet e ndryshimeve në taksën e ambalazheve plastike dhe taksën e rentës me rreth +0.5 miliardë lekë;

Të ardhurat nga “Taksa Doganore” në vitin 2019 vlerësohet të jenë 7.4 miliardë lekë, me rritje 390 milionë lekë ose 5.6% krahasuar me vitin 2018, realizimi i pritshëm i të cilit parashikohet të jetë 7 miliardë lekë. Në programimin e të ardhurave janë marrë në konsideratë efektet e rritjes së importeve të tatueshme, si dhe disa efekte minimale nga lëvizja e tarifave doganore.

Të ardhurat nga “Kontributet për Sigurime Shoqërore e Shëndetësore” në vitin 2019 parashikohet të rriten me +7%, ose +6.4 miliardë lekë krahasuar me të pritshmin e vitit 2018. Të ardhurat nga kontributet pritet të jenë 97.9 miliardë lekë, nga 91.5 miliardë lekë që do arkëtohen në vitin 2018. Rritja e programuar e të ardhurave mbështetet në këta faktorë:

- rritjen ekonomike çka do reflektohet në rritjen e numrit të punësuarve;
- forcimin e administrimit nëpërmjet kontrollit të nivelit të pagës të deklaruar dhe deviacionit të saj nga paga reale që përfitohet;
- ritmin e rritjes së të ardhurave nga kontributet në dy-tre vitet e fundit;
- efektin për rreth 1 miliardë lekë nga rritja e pagës minimale nga 24 mijë lekë në 25 mijë lekë, duke filluar nga 1 janari 2019.

2.2 SHPENZIMET PUBLIKE

Totali i shpenzimeve publike për vitin 2019 është planifikuar **519.4 miliardë lekë** ose **29.6% e PBB**.

Shpenzimet e personelit për vitin 2019, reflektojnë koston aktuale të Administratës Publike, politikën e rritjes së pagave për sektorin e shëndetësisë, arsimit, mbrojtjes, sistemit penitenciar dhe punonjësit e përfaqësive diplomatike. Krahas kësaj në këto shpenzime planifikohet kostoja e reformës në drejtësi, për akomodimin e pagave të reja të institucioneve aktuale të sistemit të drejtësisë si dhe, akomodimi i institucioneve të reja të krijuara për mbështetjen e kësaj reforme. Shpenzimet totale për pagat në Administratën Publike janë planifikuar në masën **80.6 miliardë lekë** ose **4.6% e PBB**.

Shpenzimet për interesa parashikohen në nivelin **41.7 miliardë lekë** ose **2.4% të PBB**, për të përballuar një rritje të mundshme të normave të interesit nga 1 pikë përqindje në 2 pikë përqindje.

Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes për qeverisjen qendrore për vitin 2019 (pa përfshirë shpenzimet që realizohen nga institucione publike, që kanë si burim financimi të ardhurat jashtë limitit), janë parashikuar në masën **44.6 miliardë lekë** ose rreth **2.5% e PBB-së**. Në këtë zë është programuar

mbështetja me prioritet e skemës së fermerëve, mirëmbajtja e rrjetit rrugor kombëtar dhe mirëmbajtja e sistemeve të teknologjisë së informacionit.

Shpenzimet e buxhetit vendor për vitin 2019, janë parashikuar në masën **51.14 miliardë lekë** me një rritje prej 11% më shumë se në vitin 2018. Këto shpenzime për vitin 2019, zënë 2.9% të PBB-së nga 2.3% që zinin në vitin 2013.

Burimi kryesor i rritjes së shpenzimeve vendore për vitin 2019, vjen kryesisht nga rritja e të ardhurave nga taksat dhe tarifat e veta si dhe nga rritja e transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme.

Skema e financimit të funksioneve të reja të transferuara në vitin 2016, dhe të financuara me transfertë specifike, në buxhetin e vitit 2019 dhe në vijim do të jetë transfertë e pakushtëzuar për sektorë të veçantë. Këto transferta mund të përdoren në autonomi nga Bashkitë.

Me qëllim rritjen e performancës së shërbimit që ofron arsimit parashkollor, fondet për pagat e edukatoreve do të rriten me 9.1% në raport me 2018 dhe ndarja e fondeve për çdo bashki, do bëhet me një formulë që mbështetet kryesisht në numrin e nxënësve (fëmijëve 3-6 vjeç) përfitues.

Shpenzimet e fondeve speciale që përfshin shpenzimet totale për Fondet e Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe kompensimin në vlerë të ish-pronarëve, janë planifikuar në vlerën prej **179.98 miliardë lekë**. Niveli i shpenzimeve për *Skemën e Sigurimeve Shoqërore* për vitin 2019, parashikohet në masën **130.63 miliardë lekë** ose **7.5% e PBB**, raport ky i njëjtë me vitin 2018. Nga ky fond, për rritjen e pensioneve është parashikuar niveli prej **2.45 miliardë lekë**. Ndërsa, shpenzimet e *Skemës së Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor* për vitin 2019 janë parashikuar në masën **41.9 miliardë lekë** ose **2.4% e PBB** nga 40.4 miliardë lekë të parashikuara në vitin 2018.

Së fundi, shpenzimet për *Fondin e Kompensimit në vlerë të Pronarëve*, parashikohen në total në masën **5 miliardë lekë** ose 0.3% e PBB.

Shpenzime të tjera sociale, përfshin fondet për pagesën e papunësisë, aftësisë së kufizuar, ndihmës ekonomike, dëmshpërblimin e ish-të përndjekurve politikë dhe bonusin e lindjeve.

- Shpenzimet për pagesën e papunësisë parashikohen në nivelin **500 milionë lekë**.
- Shpenzimet për pagesën e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar parashikohen në nivelin **20.5 miliardë lekë**, në të njëjtin nivel si vitin e kaluar.
- Për ish-të përndjekurit është parashikuar një fond prej **1 miliard lekë** ose 0.1% e PBB.
- Për bonusin e lindjeve është parashikuar një fond prej **2 miliardë lekë** ose 0.1% e PBB.

Shpenzimet për subvencione janë parashikuar në masën **1.49 miliardë lekë** duke rezultuar me një nivel më të ulët prej 600 milionë lekësh krahasuar me vitin e kaluar. Ky reduktim është bërë në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve bazuar në performancën e tij. Pjesa tjerë e fond shkon për të mbuluar një pjesë të shpenzimeve të veprimtarisë hekurudhore, veprimtarinë e shërbimeve qeveritare dhe nxitjen e punësimit.

Niveli i Fondit Rezervë për vitin 2019, planifikohet në masën **3 miliardë lekë**, përkatësisht **1.5 miliardë lekë** Fond Rezervë i Këshillit të Ministrave dhe **1.5 miliardë lekë** fond kontigjence për financimin e pagave të reja për magistratin dhe ngritjen dhe funksionimin e institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë.

Investimet Publike për vitin 2019 janë planifikuar në masën **5.1%** e PBB ose **88.8 miliardë lekë** (*duke përfshirë këtu dhe mbështetjen për Sektorin e energjisë 3 miliardë lekë*). Në planifikimin e investimeve për vitin 2019 janë mbajtur në konsideratë të gjitha detyrimet kontraktuale për projektet e investimeve me financim të huaj dhe të brendshëm. Ashtu, si edhe në vitin 2018, dhe në vitin 2019 do të ketë përparësi financimi i projekteve në vazhdim. Për planifikimin e investimeve janë ndjekur kriteret e mëposhtme:

- *Prioritetet e Programit të Qeverisë për periudhën 2017 – 2021;*
- *Prioritetet e integritit europian;*
- *Projektet në vazhdim.*
- *Mbështetja me kosto lokale dhe TVSH për projektet me financim të huaj;*

2.3 DEFICITI BUXHETOR

Defiçiti buxhetor për vitin 2019 planifikohet të jetë në nivelin 1.9% të PBB. Ky përbën nivelin më të ulët të targetuar në dy dekadat e fundit. Për të katërtin vit radhazi balanca primare parashikohet të jetë pozitive në nivelin 0.5% duke synuar mbajtjen e borxhit në trajektoren rënëse për të katërtin vit radhazi. Rrjedhimisht targetohet që niveli i “borxhit publik neto nga asetet likuide në TSA” do të ulet me rreth 2 pikë përqindje [në 64.9% të PBB] dhe do të vijojë këtë trend rënës në periudhën afatmesme dhe afatgjatë. Financimi i defiçitit do të realizohet nëpërmjet burimeve huamarrjes së brendshme në rreth 1.3% të PBB, huamarrjes së huaj në rreth -0.9% të PBB, si dhe nëpërmjet përdorimit të gjendjes së depoyitës në TSA të akumuluar gjatë vitit 2018 (kryesisht nga emetimi i Eurobondit) prej rreth 1.5% e PBB.

PARIMET DHE RREGULLAT FISKALË

Në përputhje të plotë me obligimet që rrjedhin prej Ligjit Organik të Buxhetit nr 57/2016, ligji i buxhetit për vitin 2019, materializojnë parimet dhe rregullat fiskalë të mëposhtëm:

1. Në çdo ligj vjetor të buxhetit, fillestar apo të rishikuar, si dhe në planifikimet e buxhetit afatmesëm, raporti i borxhit publik ndaj Produktit të Brendshëm Bruto do të planifikohet më i ulët se niveli i vlerësuar për vitin pararendës, deri atëherë kur niveli i borxhit të arrijë dhe qëndrojë poshtë nivelit 45 për qind të Produktit të Brendshëm Bruto;

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal) të LOB, ligji vjetor i buxhetit 2019 targeton një nivel të borxhit publik total në 65.5% të PBB nga niveli prej 69.1% e PBB i pritshëm për vitin 2018.

Njëkohësisht, edhe niveli i borxhit publik neto nga gjendja e mjeteve likuide në llogarinë e vetme të thesarit (TSA) targetohet me një reduktim në 64.9% e PBB në fund të 2019 nga 66.9% që pritet të rezultojë për vitin 2018.

2. Vlera e Produktit të Brendshëm Bruto, nominale në lekë, e cila do të përdoret për llogaritjen e raportit të borxhit publik ndaj Produktit të Brendshëm Bruto për vitet buxhetore që planifikohen dhe për vitin pararendës, nuk mund të jetë më e lartë se vlera respektive e parashikuar ose vlerësuar në raportin “Perspektiva ekonomike botërore” (World Economic Outlook), të Fondit Monetar Ndërkombëtar, më i fundit i publikuar në kohën kur ligji vjetor i buxhetit dorëzohet për miratim në Kuvend. Kjo dokumentohet qartësisht në relacionin shoqëruar të ligjit vjetor të buxhetit;

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal) të LOB, ligji vjetor i buxhetit 2019 bazohet në projeksionet e mëposhtme të PBB nominale, të cilat paraqiten në mënyrë krahasimore kundrejt projeksioneve të raportit “Perspektiva ekonomike botërore” (World Economic Outlook), të Fondit Monetar Ndërkombëtar, më i fundit i publikuar më Tetor 2018²:

Parashikimet e PBB nominale të FMN dhe Ministrisë së Financave

në miliard lekë	2015	2016	2017	2018 Para.	2019 Para.
FMN - Perspektiva Ekon. Bot.	1,434	1,475	1,553	1,654	1,754
Ministria e Financave	1,434	1,475	1,553	1,648	1,752
Diferenca FMN - MeF (duhet të jete jo më e vogël se zero)	0	0	0	6	2

3. Në çdo vit buxhetor të planifikuar duhet të përfshihet një kontingjencë e veçantë, prej jo më pak se 0,7 për qind e shpenzimeve totale të buxhetit, për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit ose normat e interesit, me ndikim në nivelin e borxhit.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal) të LOB, ligji vjetor i buxhetit 2019 përfshin në një zë të veçantë të tij, emërtuar “Kontingjencë për impaktin në borxhin publik nga luhatjet e normave të interesit, et.j” një kontingjencë prej 4.3 miliardë lekë ose 0.8% e shpenzimeve totale. Kjo vlerë e përfshirë në buxhet është e papërdorshme për qëllime të tjera përveç pagesës së interesave nëse këto të fundit për të gjithë vitin në tërësi rezultojnë më tepër se sa alokimet respektive në buxhet.

4. Të ardhurat nga privatizimi nuk janë pjesë e procesit të programimit buxhetor. Në rastet e arkëtimit ato përdoren, jo më pak se 50 për qind, për uljen e borxhit publik dhe pjesa tjetër për investime publike. Pas arritjes së nivelit të borxhit publik, sipas përcaktimeve të shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij neni, përdorimi i të ardhurave të arkëtuara nga privatizimet përcaktohet në ligjin vjetor të buxhetit.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal) të LOB, ligji vjetor i buxhetit 2019 nuk përfshin të hyra nga privatizimet e mundshme.

5. Masa e deficitit buxhetor nuk mund të tejkalojë masën e shpenzimeve kapitale të parashikuara çdo vit në ligjin e buxhetit.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal – “rregulli i artë”) të LOB deficitit i targetuar në këtë ligj vjetor të buxhetit 2019 është 62% më i ulët se sa shpenzimet kapitale të planifikuara. Rrjedhimisht, balanca korente e tarteguar është pozitive në nivelin prej rreth 3.1% të PBB.

1 Në vlerë nominale stoku i borxhit total i pritur (vlerësuar) për vitin 2018 është 1,139.0 miliardë lekë, ndërsa ai i targetuar për vitin 2019 është 1,147.9 miliardë lekë. Ndërsa projeksionet (parashikimet) e PBB nominale janë respektivisht 1,647,6 miliardë lekë për vitin 2018 dhe 1,752.7 miliardë lekë për vitin 2019.

2

<http://www.imf.org/en/Publications/WEO/Issues/2017/09/19/world-economic-outlook-october-2017>

3. MENAXHIMI I BORXHIT PUBLIK

Borxhi i Qeverisjes Qendrore gjatë vitit 2018 përgjithësisht u karakterizua nga një ecuri pozitive, duke qenë në përputhje me buxhetin e planifikuar për vitin 2018 dhe objektivat e Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit (*SAMB*). Huamarrja do të mundësojë rifinancimin e borxhit ekzistues dhe mbulimin e nevojave të qeverisë për likuiditet.

Në përputhje me objektivat e Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit, gjatë vitit 2018 është mundësuar reduktimi i mëtejshëm i ekspozimit ndaj risqeve të borxhit të brendshëm, si edhe mbajtja nën kontroll e kostove. Në drejtim të reduktimit të risqeve në portofolin e borxhit të brendshëm vlen të theksohet zgjatja e jetëgjatësisë së borxhit si edhe reduktimi i peshës së titujve me norma interesi të ndryshueshme. Kontribut të rëndësishëm në realizimin e objektivave strategjike të vitit 2018 edhe atyre afatmesme ka pasur edhe emetimi i Eurobond-it, shoqëruar me procesin e blerjes mbrapsht (*buyback*) të një pjese të Eurobondit ekzistues që maturohet në vitin 2020. Transaksioni i Eurobond-it do të shërbejë: a) për të menaxhuar nevojat për likuiditet të vitit aktual si edhe të viteve pasardhëse; b) për të reduktuar riskun e rifinancimit; c) për të mbajtur nën kontroll kostot që mund të materializohen në periudhën afatmesme si rezultat i rritjes së normave të interesit në tregjet ndërkombëtare përtej pritshmërive; si edhe d) për të ulur presionin për hua në tregun e brendshëm.

Për sa i përket zhvillimeve në tregun primar, kërkesa për tituj shtetërorë, megjithëse mbetet ende jo shumë e diversifikuar dhe e bazuar kryesisht tek sektori bankar, gjatë vitit 2018 ka qenë e kënaqshme dhe është shoqëruar me rritje në drejtim të individëve.

Në vazhdim të angazhimit të ndërmarrë në lidhje me përmirësimin e mëtejshëm të tregut primar të titujve shtetërorë, si edhe hedhjen e hapave për zhvillimin e tregut sekondar, përgjatë vitit 2018 janë realizuar objektiva të tilla si:

- i. Reduktimi i numrit të ankandëve dhe konsolidimi i shumave të shpallura me qëllim rritjen e konkurrueshmërisë në treg;
- ii. Komunikimi i vazhdueshëm me aktorët kryesorë të tregut të titujve shtetërorë;
- iii. Zbatimi i *Projektit Pilot* për Obligacionin 5 vjeçar Referencë ¹.

Gjatë vitit 2019 edhe në vijim, përveç reduktimit të konsiderueshëm të ekspozimit ndaj risqeve, rëndësi e veçantë do t'i kushtohet aktiviteteve të cilat do të kenë në fokus zhvillimin e mëtejshëm të tregut të titujve shtetërorë.

Në periudhën afatmesme, mesatarisht rreth 85% e nevojave të përgjithshme për financim do të realizohen nëpërmjet burimeve të brendshme. Niveli i financimit të brendshëm në terma neto do të synohet të mbahet i qëndrueshëm duke mos tejkaluar kapacitetet optimale të tregut (*rreth 20-22 miliard Lek në vit*). Duke qenë se normat e interesit priren të qëndrojnë ende në nivele të ulëta, financimi i brendshëm do të orientohet kryesisht në drejtim të titujve afatgjatë me norma interesi fikse, me qëllim reduktimin e risqeve

¹ https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Titujt_shteterore/Titujt_reference/
<http://www.qbz.gov.al/Botime/Akteindividuale/Janar%202018/Fletore%2096/UDHEZIM%20nr.%2021.%20date%2022.6.2018.pdf>

me kosto sa më të ulët. Titujt afatshkurtër kryesisht do të shërbejnë për të rifinancuar maturimin e titujve ekzistues, si dhe menaxhimin aktiv të nevojave për likuiditet.

Financimi i huaj do të shërbejë si një plotësues i mirë i burimeve të brendshme dhe përveç të tjerash edhe si optimizues i kostove të borxhit. Ky financim do të mbështetet: i) në huatë me terma pjesërisht të buta, të cilat do të financojnë projektet ekzistuese dhe projektet e reja të konsideruara si prioritare nga Qeveria për zhvillimin e vendit; ii) në huatë me terma të buta të akorduara nga institucionet ndërkombëtare financiare për të mbështetur politikat zhvillimore të vendit; dhe iii) në instrumentet financiare të tregjeve të kapitalit mbi baza oportuniste dhe kryesisht për të mundësuar një menaxhim aktiv të detyrimeve të borxhit dhe optimizuar risqet e portofolit.

Zhvillimi i mëtejshëm i tregut primar vendas dhe hedhja e hapave për zhvillimin e tregut sekondar të titujve shtetërorë është një tjetër objektiv afatmesëm, realizimi i të cilit do të shoqërohet me aktivitete të cilat do të kenë në fokus:

- Krijimin dhe standardizimin e madhësive *benchmark* për titujt afatgjatë nëpërmjet konsolidimit të numrit të ankandëve dhe rritjen e frekuencës së rihapjeve;
- Reduktimin e fragmentimit të kërkesës nëpërmjet konsolidimit të numrit të titujve shtetërorë të tregtueshëm;
- Rritjen e transparencës nëpërmjet konsultimit të vazhdueshëm me aktorët kryesorë të tregut dhe raportimit e publikimit periodik në kohë të të dhënave të borxhit;
- Përdorimin e ankandëve të riblerjes (*buyback auctions*) dhe shkëmbimit (*exchange auctions*) për të rritur efikasitetin në procesin e reduktimit të ekspozimit ndaj risqeve;
- Përmirësimin dhe standardizimin e rregullave të emetimit të titujve shtetërorë;
- Analizimi i rezultateve të projektit pilot për emetimin e obligacioneve 5 vjeçare referencë dhe shqyrtimi i mundësisë në bashkëpunim me aktorët kryesorë të tregut për shtrirjen e këtij projekti edhe tek titujt e tjerë afatgjatë.
- Përmirësimin e kuadrit ligjor dhe rregullator;
- Diversifikimin dhe zgjerimin e bazës së investitorëve.

4. POLITIKAT SEKTORIALE DHE PËRFITIMET PËR QYTETARIN

BUJQËSIA DHE ZHVILLIMIT RURAL

❖ Prioritetet 2019-2021

Prioritetet e sektorit të bujqësisë, për periudhën afatmesme 2019-2021, janë si më poshtë:

- ✓ Mbështetjen e modernizimit të sektorit të bujqësisë nëpërmjet fondeve IPARD;
- ✓ Garantimi i sigurisë ushqimore, shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve, dhe shëndetit të bimëve përmes adoptimit të standardeve përkatëse të BE-së në kuadrin normativ vendas;
- ✓ Konsolidimi i pronësisë mbi tokën bujqësore, administrimi i qëndrueshëm, ruajtja e saj nga dëmtimi, gjërryerja, shpërdorimi dhe faktorë të tjerë,;
- ✓ Nxitja e tregut të tokës dhe konsolidimi i fermës bujqësore duke rritur sipërfaqen dhe nxitur kooperimin;

- ✓ Mbështetje për agroindustrinë;
- ✓ Mbështetje për tregjet dhe marketingun e produkteve bujqësore dhe blegtorale;
- ✓ Administrimi i sistemit të ujitjes nëpërmjet kujdesit, sigurimit dhe administrimit të qëndrueshëm të sistemit të ujitjes dhe shmangia e përmytjeve;
- ✓ Mbështetje financiare dhe asistencë teknike për fermerët.
- ✓ Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit të peshkimit dhe akuakulturës, shfrytëzimin e përgjegjshëm të burimeve peshkore dhe kapaciteteve të flotës së peshkimit si dhe ngritjen e një sistemi kontrolli dhe inspektimi për peshkimin në det, në tokë dhe në të gjithë zinxhirin e tregut.

❖ **Rezultatet që synohet të arrihen për periudhën afatmesme 2019-2021**

Në fushën e “Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit”, synohet të realizohet:

- ✓ Rritja e sipërfaqes së tokës bujqësore që i ofrohet shërbimi i ujitjes nga 63.8% në 68.1% të totalit potencial prej 360 mijë hektarë tokë në vitin 2021;
- ✓ Mirëmbajtje vjetore të rrjetit kullues për 45 000 hektarë tokë si proces ciklik vjetor;
- ✓ Mundësimi i kullimit me ngritje mekanike me hidrovorë për 70 mijë hektarë tokë;
- ✓ Rehabilitimi/ndërtimi i rreth 16 km argjinatura të mbrojtjes nga përmytja dhe erozioni.

Në fushën e Zhvillimit Rural synohet:

- ✓ Rritja e produktivitetit dhe konkurrueshmërisë së produkteve bujqësore dhe blegtorale përmirësimi i standardeve dhe garantimi i sigurisë ushqimore, si dhe zhvillimi i zonave rurale për një zhvillim bujqësor dhe rural të qëndrueshëm përmes nxitjes së shumëllojshmërisë së veprimtarive ekonomike në zonat rurale, duke rritur:
 - ✓ Numrin e fermerëve që përfitojnë nga skemat mbështetëse;
 - ✓ Sipërfaqet e mbjella me fruta dhe perime.
- ✓ Arritja e standardeve të BE-së, në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural, nëpërmjet shtimit progresiv të:
 - Numrit të përfituesëve nga skema e masave mbështetëse në peshkim dhe akuakulturë për tre vite 230 ose (rreth 76 përfitues mesatarisht në vit)
 - Numrit të përfituesëve nga skema e investimeve në agropërpunim 150 për tre vite ose 50 përfitues mesatarisht në vit.
 - Numrit të përfituesëve nga skema e masave mbështetëse në zhvillimin rural rreth 120 për tre vite (40 përfitues mesatarisht në vit)

Në fushën e Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit synohet fuqizimi i sistemit të kontrollit dhe inspektimit, duke përfshirë të gjithë zinxhirin ushqimor nga ferma në tavolinë nëpërmjet:

- ✓ Kontrolleve dhe monitorimeve të sëmundjeve infektive dhe zoonotike në kafshët e gjalla, duke ulur konsiderueshëm numrin e jo-konformiteteve të konstatuara në të gjithë zinxhirin ushqimor. Në vitin 2021 parashikohet që numri i kafshëve të vaksinuara të shkojë 1.003.000 kafshë nga 1.000.500 kafshë që është aktualisht.
- ✓ Do të vijojë zbatimi i politikave të shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve të gjalla, si dhe programet e parandalimit, kontrollit, eliminimit deri në çrrënjësjen e sëmundjeve infektive në kafshë, sipas përcaktimeve të legjisllacionit veterinar, nëpërmjet:

- rritjes së numrit të gjurmimeve nga 54.500 në vitin 2018 në 56.000 në vitin 2021.
- Shtimit të numri të analizave të kryera, duke arritur një mesatare vjetore prej rreth 5,250 analizash në vit.
- ✓ Do të kryhen inspektime të vazhdueshme (rreth 86 mijë inspektime në tre vitet e adhsme dhe kontrollit dhe mbrojtës nga parazitët në fushën e bujqësisë të rreth 25,000 ha mesatarisht)
- ✓ Rritjes së numrit të operatorëve që aplikojnë standardet HACCP në sigurinë ushqimore, nëpërmjet kryerjes të:
 - Mesatarisht 89.000 inspektimeve; shtimit të numrit të gjobave të vendosura nga inspektimet në terren; numrit të bizneseve të mbyllura për mosplotësimin e kushteve të sigurisë ushqimore; numrit të rasteve të produkteve ushqimore të hequra nga tregu; numri të ngarkesave të kthyer në Pikat e Inspektimit Kufitar.
- ✓ Uljen e rasteve të sëmundshmërisë së njerëzve të shkaktuara nga kafshët;
- ✓ Uljen e rasteve të sëmundshmërisë së kafshëve në blegtori prej brucelozës, plasjes, tuberkulozit dhe LSD;

ZHVILLIMI EKONOMIK

❖ Prioritetet 2019-2021

Gjatë periudhës 2019-2021 prioritetet në fushën e mbështetjes së zhvillimit ekonomik do të jenë:

- Promovimi i Shqipërisë si destinacion investimesh nëpërmjet organizimit dhe pjesëmarrjeve në panairë ndërkombëtare dhe road show promovuese, vizita në kompani (after care) si dhe monitorim efektiv investimesh strategjike;
- Ndërmarrja me sukses e aktiviteteve promovuese për nxitjen e investimeve të huaja dhe të produkteve "Made in Albania";
- Rritja e konkurrueshmërisë së bizneseve shqiptare në tregun ndërkombëtar nëpërmjet granteve nga Fondi i Konkurrueshmërisë (60 biznese të mbështetura financiarisht në 2019-2021);
- Avancimi i mëtejshëm në fushën e teknologjisë dhe inovacionit nëpërmjet granteve që i akordohen bizneseve të specializuara në këtë fushë nga Fondi i Inovacionit (75 biznese të mbështetura financiarisht në 2019-2021);
- Nxitja e krijimit të bizneseve të reja në sektorë me potencial zhvillimi nëpërmjet Fondit Start-Up (60 biznese të mbështetura financiarisht në 2019-2021);
- Mbështetja e sipërmarrjeve të sektorit të artizanatit dhe zejtarisë me qëllim konsolidimin e tyre në treg dhe rritjen e numrit të të punësuarëve nëpërmjet "Fondit në mbështetje të biznesit kreativ", ku në total parashikohet të përfitojnë 85 SME vendase me qëllim rritjen e konkurrueshmërisë (60 biznese të mbështetura financiarisht në 2019-2021).

INFRASTRUKTURA DHE ENERGJIA

❖ Prioritetet 2019-2021

Prioritetet e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për periudhën 2019-2021 në sektorët e infrastrukturës dhe energjisë janë:

- ✓ Zgjerimi i rrjetit të rrugëve kombëtare nëpërmjet, ndërtimit, rehabilitimit dhe sistemimit të rrugëve kombëtare dhe përveç kësaj kalimin në praktikën e mirëmbajtjes së rrugëve bazuar në performancë;
- ✓ Zgjerimi i aksesit dhe cilësisë së shërbimit të ujit të pijshëm dhe kanalizimeve përmes: (i) një portofoli të investimeve publike; dhe (ii) përmirësimit rrënjësor të menaxhimit të shoqërive aksionere të ujësjellës kanalizimeve, duke standartizuar parimet e qeverisjes së sektorit;
- ✓ Rritja e efikasitetit të energjisë kundrejt konsumit të përgjithshëm final të energjisë nëpërmjet shqyrtimit të programeve për promovimin e tregut, për penetrimin e teknologjive të përparuara si dhe rritjen e përdorimit të energjive të rinovueshme;
- ✓ Trajtimi i mbetjeve në mënyrë të kontrolluar sanitare, nëpërmjet vazhdimit të ndërtimit të impianteve të reja të trajtimit të mbetjeve të ngurta dhe rehabilitimit të venddepozitimeve ekzistuese.

❖ Rezultatet që synohet të arrihen për periudhën afatmesme 2019-2021

Për Transportin Rrugor

- Përfundimi i akteve rrugore nacionale si: Rruga e Arbrit, Thumanë – Vorë – Kashar, Kashar – Rrogozhinë; Milot – Balldren; Orikum – Dukat brenda vitit 2021 nëpërmjet Partneritetit Publik Privat në kuadër të projektit “1 Miliard”;
- Rritja e sigurisë rrugore në të gjitha akset kombëtare ku synohet ulja e numrit të aksidenteve me pasojë humbje jetë njerëzish dhe numri i pikave të zeza me 23%, sipas Strategjisë Kombëtare të Transportit.
- Vazhdimi i financimit për akset rrugore:
 - *Kardhiq – Delvinë, Lotet 4,5,6,7 Dhe 8*
 - *Fushë Krujë-Milot-Morinë*
 - *Qafë Thanë-Lin-Pogradec*
 - *Unaza Verilindore e Tiranës*
 - *Unaza E Tiranës, Pallati me Shigjeta Rrethrotullimi Shqiponja*
 - *Rikualifikimi i Akteve Rrugore, Unaza Lindore Loti 2 Dhe Loti 3*
 - *By Pass Tepelenë*
 - *By Pass Shkodër*
- Fillimi i tunelit “Kardhiq – Delvinë”

Për shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime

- Deri në vitin 2027, raporti mesatar i mbulimit me shërbimin e furnizimit me ujë për të gjithë popullatën e vendit do të jetë 99% nga 78.8% në vitin 2017;
- Raporti mesatar i mbulimit me shërbime kanalizimi të ujrave të ndotur do të jetë 75% në vitin 2027, nga 51.66% në vitin 2017;
- Mbulimi me shërbim i ujrave të ndotura në impiantet e trajtimit të ujrave të ndotura në 70% në vitin 2027;
- Mesatarja e orëve të furnizimit me ujë të pijshëm në rang kombëtar rritet në 14 orë në ditë në 2021, nga 12.5 orë në ditë në vitin 2018;
- Reduktimi i humbjeve në nivel kombëtar në masën 20% në vitin 2021;
- Furnizimi me ujë dhe shërbime i zonës bregdetare 24 orë në vitin 2021;
- Mbyllja e 44 kontratave në vazhdim me vlerë rreth 1.8 miliardë lekë.

- Shtesë kontrate me vlerë 80 milionë lekë për projektin "Përfundimi i rrjetit të Kanalizimeve të Ujrave të Zeza në zonën Përroi i Agait - Qerret, Loti II (Linjat KUZ Perroi Agait, Stacioni Pompimit Nr.1 deri tek Stacioni Pompimit Nr.2)" .
- Financimi i projektit të ri "Mbështetje teknike në zbatim të reformës në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve" (sipas performancës, për uljen e humbjeve deri në nivelin teknik 20% dhe matjen e prodhimit të ujit).
- Financimi i projektit të ri "Përmirësimi i infrastrukturës së ujrave të zeza në zonën bregdetare Vlorë"

Për mbështetjen për Energjinë

- Sigurimi i furnizimit të pandërprerë i konsumatorit me energji elektrike pa mbështetje buxhetore;
- Në vitin 2020 do të rritet përdorimi i energjisë së rinovueshme me 38% kundrejt vitit 2009;
- Në vitin 2020 do të rritet efënca e energjisë me 6.5% referuar vitit 2009.

Për Menaxhimin e Mbetjeve Urbane

- Në vitin 2019, synohet që të trajtohen 30% të mbetjeve me landfill duke synuar të arrijë rreth 43% të mbetjeve me landfill-e sipas standardeve në vitin 2021. Ndërkohë, në fund të vitit 2018 ky tregues parashikohet të arrijë në 24% të mbetjeve;
- Në vitin 2021, synohet të riciklohet rreth 20% e totalit të mbetjeve të prodhuara, nga 0.05% që parashikohet në fund të vitit 2018;

Për Planifikimin Urban

- Do të përfundohen brenda vitit 2019 të gjitha Planet Vendore për të 61 njësitë e reja vendore në bashkëpunim me qeverisjen qendrore, ekspertizën e huaj dhe kombëtare të cilat do të shërbejnë si bazë për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik e social të tyre.

Për Transportin Ajror

- Rritja e standarteve dhe performancës së Organit Kombëtar të incidenteve/Aksidenteve ajrore nëpërmjet investimeve për forcimin e kapaciteteve, në kuadër edhe të ndërtimit të infrastrukturave të reja aeroportuale;
- Zbatimi i standarteve të njehsuara të sigurisë dhe parrezikshmërisë në transportin ajror.

Për Transportin Detar

- Kryerja e investimeve prioritare për funksionimin me kapacitet të plotë të porteve dhe përmirësimin e infrastrukturës portuale në vend, me qëllim shndërrimin e Shqipërisë në një vend të zhvilluar detar që mbështet rritjen ekonomike dhe shpejton procesin e integritit në BE;

Për Transportin Hekurudhor

- Rikostruksioni i segmentit hekurudhor Tiranë – Durrës si dhe ndërtimi i linjës së re hekurudhore Tiranë-Rinas;
- Mirëmbajtja e infrastrukturës hekurudhore ekzistuese si dhe mirëmbajtja e mjeteve-hekurudhore;

Për Mbështetjen për Burimet Natyrore

- Nxitja dhe inkurajimi i ndërtimit të objekteve të përpunimit të mineraleve;

- Realizimi në vazhdimësi i funksioneve të mbikëqyrjes së shfrytëzimit racional e efektiv të pasurive minerale, monitorimit mineral dhe të fenomeneve të postshfrytëzimit, rritja e kontrollit për rehabilitimin mineral;
- Përmirësimi i transparencës së biznesit në industrinë nxjerrëse, në mënyrë që të ardhurat nga ky biznes të kontribuojnë më shumë në zhvillimin e vendit.

Për Mbështetjen për Industrinë

- Zhvillimi i strukturave dhe burimeve njerëzore dhe forcimi i kapaciteteve institucionale për inspekimin dhe mbikëqyrjen, sigurinë në punë për monitorimin e inspektimit dhe mbikëqyrjes së sigurisë teknike të produkteve / pajisjeve / instalimeve në fushat e veprimtarisë së MIE.
- Zhvillimi i strukturave dhe burimeve njerëzore dhe forcimi i kapaciteteve institucionale për sigurimin e kushteve të domosdoshme për inspekimin dhe mbikëqyrjen e shëndetit, sigurisë në punë, emergjencat dhe shpëtimin në veprimtarinë minerare dhe në punimet nëntokësore të veprave hidroenergjetike.
- Rritja dhe përmirësimi i standarteve, kushteve të punës dhe të sigurisë së depozitimit dhe ruajtjes së kimikateve të rrezikshme nën përgjegjësinë e MIE-s, në Qendrën e Grumbullimit dhe Trajtimin të Kimikateve të Rrezikshme.
- Përfundimi i procesit të likuidimit dhe mbylljes së ish ndërmarrjeve industriale në varësi të MIE. Rehabilitimi i territoreve të ish ndërmarrjeve për nxitjen e investitorëve dhe promovimin e tyre për përdorim si parqe industriale.
- Promovimi tek biznesi i studimeve tekniko-ekonomike për industrinë e Lëkurë-Këpucës, industrisë së bakrit, nikel-silikateve dhe kuarciteve, zhvillimit të QGTK dhe hartimi i raporteve mjedisore si dhe zhvillimi i disa ish territoreve industriale për ushtrimin e veprimtarive ekonomike.

REFORMA E UJIT

Duke patur si qëllim krijimin e një sektori të qëndrueshëm, i cili ofron shërbim cilësor për qytetarët, reforma në sektorin e ujit, është një nga prioritetet e Qeverisë.

Reforma në sektorin e ujësllës kanalizimeve është mbështetur në reformimin e mirëqeverisjes dhe orientimin e investimeve drejt performancës, si dhe drejt sigurimit të kohëzgjatjes së furnizimit me ujë.

Dy nga objektivat strategjik të sektorit janë:

- Reduktimin e Ujit pa të Ardhura;
- Përmirësimin e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në zonat bregdetare me rëndësi turistike.

Në kuadër të mirëqeverisjes Ministria përgjegjëse për infrastrukturën ka ndërmarrë këto nisma:

1. Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe rregullator për sektorin e ujësllës kanalizimeve;
Me Urdhërin e Ministrit të MIE, Nr.581, datë 18.07.2018 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e ligjit të funksionimit të sektorit të ujësllës kanalizimeve”, është ngritur grupi i punës i cili, do të përgatisë ligjin sektorial të ujësllës kanalizimeve, duke sjellë për herë të parë një ligj sektorial, i cili do të rregullojë raportet e funksionimit të gjithë aktorëve, institucioneve të përfshira në sektor, duke arritur kështu qartësinë dhe shmangjen e mbivendosjeve ndërmjet kompetencave të institucioneve.
2. Po punohet për hartimin e Strategjisë sektoriale 2019-2030, e cila do të integrojë brenda saj dhe një mekanizëm të qartë dhe operacional për qëndrueshmërinë financiare të sektorit.
3. Forcimi i kapaciteteve të institucioneve kryesore në këtë sektor;

Në kuadër të forcimit të kapaciteteve në nivel qendror, u krijua me anë të VKM Nr 431, datë 11.07.2018 Agjencia Kombëtare të Ujësllës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve. AKUM do të luajë një rol të rëndësishëm në monitorimin e standardeve të shërbimit të ofruar për qytetarët dhe gjithashtu në monitorimin e performancës së shërbimeve UK me qëllim shtyerjen e sektorit drejt performancës.

Në kuadër të forcimit të kapaciteteve të shoqërive të ujësllës kanalizimeve u miratua programi kombëtar I trajnimit dhe certifikimit bazuar në testim, në sektorin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotur, me anë të Udhëzimit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr.660, datë 28.09.2018.

Shtyrja e sektorit drejt performancës:

Në fillim të vitit 2018, në mbështetje të Udhëzimit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 138, date 30.01.2018 “Për miratimin e treguesve dhe kriterëve, të përfshira në kontratën e performancës (Model Tip), për ofruesit e shërbimeve në sektorin e ujësllës kanalizimeve” u nënshkruan me secilin prej Krytarëve të bashkive kontratat e performancës, të cilat synonin formalizimin e sektorit, rezultatet e të cilit, në sajë edhe të aksionit në këtë sektor, për 9 muajin e 2018 janë:

- Vendosija 74 000 matësave
- 37 000 kontrata të reja
- Rreth 17 milion Euro më shumë, të arkëtuara për të njejtën periudhë të një viti më parë.

Përmirësimi i performancës së shoqërive të ujësllës kanalizimeve do të arrihet edhe nëpërmjet një program gjithëpërfshirës të Reduktimit të Ujit pa të Ardhura, ku synohet që në fund të vitit 2021, ky tregues të jetë ulur me 20%; Për secilën shoqëri ujësllës kanalizimesh, është hartuar një plan I detajuar masash teknike dhe menaxheriale, i cili do të monitorohet nga MIE.

Sa i përket subvencioneve, në kuadrin e zbatimit të Reformës së Ujit, janë miratuar këto akte nënligjore:

- Udhëzim i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 665, datë 4.10.2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr. 837, date 10.02.2017 të Ministrit të Transportit dhe Infrastruktures “Për miratimin e metodologjisë për kriteret dhe procedurat për shpërndarjen dhe përdorimin e subvencioneve shtetërore për ofruesit e shërbimeve në sektorin e ujësllës-kanalizimeve”;
- VKM Nr.18, datë 12.01.2018 “Për subvencionimin e lidhjes së kontratave dhe të vendosjes së matësave të ujit **për kategoritë në nevojë**”.

Përmirësimi i shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në zonat bregdetare me rëndësi turistike, për të cilën në vitin 2019 është planifikuar objekti:

- Studim projektim i furnizimit me ujë dhe sistemim i ujërave të perdorua për zonat bregdetare –I, i cili do të japë në menyre të detajuar sasinë e fondeve që do të nevojiten për investime për brezin e parë të bregdetit në vitet 2020 e vazhdim.
- Përmirësimi i infrastruktures së ujërave të zeza në zonën bregdetare Vlorë, i cili do të sistemojë ujërat e zeza në zonën kodrinore mbi Lungo Mare.

REFORMA E UJIT

Që prej vitit 2017, me miratimin e Strategjisë së re të Ujit, subvencionimi nga buxheti i shtetit për këto ndërmarrje u rrit ndjeshëm, duke kapur nivelin e parashikuar në strategji prej 1 miliard lekë. Nivel ky që është akorduar sistematikisht për secilin nga vitet 2017-2018, dhe gjithashtu parashikohet edhe në projektbuxhetin 2019 për periudhën 2019-2021. Shtesa e subvencionit të këtyre ndërmarrjeve, është e lidhur ngushtë me realizimin e një sërë kriterëve/treguesve të performancës për secilën ndërmarrje, realizim ky që kushtëzon alokimin respektiv të ‘**Subvencionit mbi bazë Performance**’. Kështu, në zbatim të Udhëzimit nr.665 datë 04.10.2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr.837 datë 10.2.2017, të Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës “Për miratimin e metodologjisë për kriteret dhe procedurat për shpërndarjen dhe përdorimin e subvencioneve shtetërore për ofruesit e shërbimeve në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve”, përcaktphet se:

- **40% e fondit** të përgjithshëm të subvencionit do të shkojë për mbulimin e “Kostos direkte të operimit” (në rastet e shoqërive me vlerë negative të diferencës së të ardhurave të faturuara) dhe për të mbështetur përmirësimin e performancës së U-K sh.a që operojnë në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve.
- **60% e fondit** të përgjithshëm do të shkojë për nxitjen e performancës së shoqërive, pavarësisht diferencës së kostos, bazuar në:
 - a) *Pikët e arritura nga vlerësimi i treguesve të performancës së tyre në krahasim me objektivat. Për këtë, AKUM-ja harton matricën e performancës, ku liston pikët e realizueshmërisë për secilën sh.a. UK, të kontratës së performancës.*
 - b) *Në numrin e popullsisë së shërbyer.*

SHËNDETËSI

❖ **Prioritetet 2019-2021**

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në sektorin e shëndetësisë do të prioritzojë:

- ✓ Mbulimin universal i popullsisë me shërbim cilësor, diagnostikimi dhe parandalimi i sëmundjeve si dhe, shtimi i gamës së medikamenteve që trajtohen me recetë rimbursimi, reflektuar kjo në rritjen e jetëgjatësisë mesatare të grave dhe burrave në Republikën e Shqipërisë, mbi nivelet aktuale prej respektivisht 80 dhe 77 vjeç.
- ✓ Rikonstrukcionin e 200 Qendrave shëndetësore (100 Qendra çdo vit) për periudhën 2019-2020, me një vlerë të përllogaritur mesatarisht 470 milionë lekë në vit. Këto qendra do të mobilohen dhe pajisen me pajisje mjekësore.
- ✓ Rikonstrukcionin e godinave spitalore me një vlerë 2.1 miliardë lekë për periudhën 2019-2021. Në këtë projekt përfshihen: spitali Lushnje, spitali psikiatrik Elbasan, Spitali Vlorë, Berat, Lezhë, Pogradec, Mat.

❖ **Rezultatet që synohet të arrihen për periudhën afatmesme 2019-2021**

- Rritja e numrit të vizitave në kujdesin parësor nga 6.4 milionë që janë aktualisht (2018) në 6.6 milionë në vitin 2021;
- Ofrimi i shërbimit të kontrollit bazë (check-up) për mesatarisht 475 mijë pacientë në vit;
- Trajtimi me recetë rimbursimi një numër më i lartë pacientësh nga 475 mijë pacientë aktualisht (2018) në 478 mijë pacientë në vitin 2021.
- Rritja e numrit të pacientëve të trajtuar nga 290 mijë pacientë në vitin 2018 në 310 mijë pacientë për vitin 2019, duke synuar në 330 mijë pacientë në vitin 2021;

- Rritja e numrit të pacientëve që përfitojnë nga paketat e kardiokirurgjisë dhe kardiologjisë (200 pacientë më shumë çdo vit, për periudhën 2019-2021);
- Rritje e ndjeshme e numrit seancave për pacientët që përfitojnë nga trajtimi me dializë nga 170 mijë seanca në vitin 2018, në 234 mijë në vitin 2021; (1 pacient kryen mesatarisht 13 seanca në muaj).
- Ulja e nivelit aktual prej 15% të pacientëve të ri-shtruar për të njëjtën diagnozë brenda 72 orësh, nëpërmjet urgjencës;
- Reduktimit të kohës aktuale prej 45 ditësh të pritjes për ekzaminime të rëndësishme (rezonancë magnetike, skaner etj.);
- Uljes nën 5.3 për 1000 lindje të gjalla të indeksit aktual të vdekshmërisë foshnjore;
- Përmirësimi i mëtejshëm i koeficientit të shfrytëzimit të shtretërve më shumë se 49% që rezulton në vitin 2018.
- Rritjes me më shumë se 40% të nivelit të numrit të pacientëve të vizituar për herë të parë brenda vitit nga personeli shëndetësor;
- Rritjes me më shumë se 45% të numrit të grave mbi 35 vjeç të depistuar për kancer gjiri.

MBROJTA SOCIALE

❖ Prioritetet 2019-2021

Në fushën e mbrojtjes sociale, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale synon zbatimin me sukses të reformës së programit të përkujdesit social në tre shtyllat kryesore të tij: Ndihma Ekonomike, Paftësia e Kufizuar dhe Shërbimet Sociale. Risi në këtë fushë është mbështetja e personave nga grupet e pafavorizuara përmes punësimit në ndërmarrjet sociale. Synohet që në periudhën 2019-2021, nëpërmjet këtij mekanizmi, të punësohen rreth 600 persona të trajtuar më parë me Ndihmë Ekonomike (NE) dhe pagesë të Aftësisë së Kufizuar. Gjithashtu, krijimi i fondit social synon mbështetjen e njësive të qeverisjes vendore për ofrimin e shërbimeve sociale për grupet në nevojë dhe mbështetjen e familjeve të NE me paketa sociale shëndetësore.

❖ Rezultatet që synohet të arrihen për periudhën afatmesme 2019-2021

- Zbatimi i skemës së re të vlerësimit dhe programeve të ri-integrimit social do të sjellë reduktimin e numrit të familjeve dhe individëve në nevojë që përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike nga 70 mijë familje aktualisht në 67 mijë familje në vitin 2021.
- Numri i përfituesve nga PAK dhe kujdestarëve të tyre do të rritet nga 160 mijë në 167 mijë në vitin 2021, kjo si rezultat i zbatimit të skemës së re të vlerësimit sipas modelit bio-psiko-social. Ky sistem i ri shërbimi synon krijimin e një sistemi shërbimesh integruese të cilat kombinojnë pagesat me shërbimet e përkujdesit social.
- Rritjen mbi 80% të numrit të përfituesve të varfër që marrin NE mbi totalin e aplikuesve.
- Rritjen me 57% të numrit të personave me aftësi të kufizuar që janë komisionuar përmes sistemit të menaxhimit të informacionit;
- Rritjen me 12% të numrit të përfituesve të grave kryefamiljare që marrin Ndihmë Ekonomike mbi totalin e aplikuesve gra kryefamiljare;
- Rritja me më shumë se 66 e numrit të grave dhe vajzave në nevojë të ri-integruara pas trajtimit në institucionet e përkujdesit social.

SIGURIMI SHOQËROR

Prioritetet për periudhën 2019-2021:

Në fushën e Sigurimeve Shoqërore, për periudhën 2019-2021 synohet:

- Garantimi i mbulimit sa më të plotë të popullsisë së vendit me elementë të sigurimeve shoqërore të detyrueshme, të mbajtura në nivele të pranueshme.
- Përsosja e menaxhimit të skemës së sigurimeve shoqërore, sidomos të mbledhjes së të ardhurave kontributive si dhe shpërndarjes së drejtë të tyre në formën e përfitimeve, aty dhe atëherë kur lind e drejta.
- Vazhdimi i implementimit të reformës së pensioneve dhe përmirësimi i efikasitetit të ISSH në menaxhimin e fondeve të sigurimeve shoqërore të detyrueshme, suplementare dhe programore.
- Vazhdimi i punës për konsolidimin administrativ të ISSH, si një institucion bashkëkohor e i aftë për t'u integruar dhe për të zbatuar standartet e BE.
- Vendosja e personave të siguar dhe e përmirësimit të shërbimit ndaj tyre, në qendër të veprimtarisë së tij. Në këtë kontekst, plotësimi i kërkesave të aplikanteve jo më vonë 30 -35 ditë nga data e aplikimit.
- Përmirësimi i infrastrukturës së shërbimeve, vazhdimi i punës për arkivimin e përqëndruar të dokumentacionit për periudhat e sigurimit dhe dixhitalizimin e tyre.

Rezultatet e synuara për t'u arritur në periudhën 2019-2021:

- Rritja e nivelit të përfitimeve të pensionistëve me mesatarisht 3%. Fondet e përcaktuara si kontigjence për indeksimin e pensioneve, për tre vite, rezultojnë të jenë rreth 2.5 miliardë lekë në vit.
- Mbulimi i efekteve financiare të shtesës natyrale të numrit të përfituesve e cila në harkun e tre viteve parashikohet të jetë rreth 47,000 përfitues, pra një shtesë neto me rreth 15,600 persona në vit, me një efekt financiar rreth 12,4 miliardë lekë.
- Mbulimi i efekteve financiare të skemave të reja të përfitimeve, naftëtare minatore të cilat pas rishikimit parashikohet të sjellin një efekt financiar të harmonizuar prej rreth 1.4 miliardë lekë.
- Sistemi do të vazhdojë të mbështesë me të ardhura 710 mijë deri 759 mijë persona që kanë përfituar dhe përfitojnë pensione publike, pensione suplementare si dhe një sërë të ardhurave të tjera të parashikuara me ligje të veçanta.
- Numri mesatar i kontribuuesve në skemën e sigurimeve shoqërore parashikohet rreth 809.6 mijë persona me një rritje në masën 7.3% më shumë se i pritshmi i vitit 2018
- Shkalla e mbulimit të popullsisë në moshë punë (kontribues / popullsi në moshë pune) do të rritet nga 41.7% në vitin 2018 në 42.8% në vitin 2019.
- Shkalla e mbulimit të forcës së punës (kontribues / forcat e punës) do të rritet nga 68% në vitin 2018 në 69.8% në vitin 2019;
- Shkalla e mbulimit të të punësuarve (kontribues / të punësuar) do të rritet nga 71.5% në vitin 2018 në 73.2% në vitin 2019;
- Përpjesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore ndaj totalit të fondeve të alokuara për skemat e sigurimeve shoqërore do të rritet nga 63.6% në fund të vitit 2018 në 64.4% në vitin 2019;

ARSIMI, SPORTI DHE RINIA

❖ Prioritetet 2019-2021

Për periudhën 2019-2021, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë do të financojë me prioritet:

- ✓ Projekte për ndërtime të reja, rikonstrukcion/rindërtimin apo shtesa në objektet aktuale për më shumë se 170 objekte arsimore të tjera ose rreth 1500-1700 klasa / laboratorë mësimore në arsimin parauniversitar, nga të cilat do të përfitojnë 50,000- 55,000 nxënës dhe 3000-3500 mësues dhe edukatorë.
- ✓ Transportin e 28-30 mijë nxënësve që kanë vendbanimi mbi 2 km nga shkolla si dhe transportin e 10 mijë mësuesve që punojnë mbi 5 Km nga vendbanimi/qendra e përhershme e punës në shkollë;
- ✓ Blerjen e teksteve shkollore për rreth 190 mijë nxënës të arsimit para-universitar nga shtresat sociale në nevojë;
- ✓ 1000-1400 nxënës të arsimit para-universitar nga shtresat sociale në nevojë me kuotë ushqimore;
- ✓ Bursat e studentëve nga shtresat sociale në nevojë, krijimit të kushteve të përshtatshme të akomodimit në tetë “Shoqëritë e Trajtimit të studentëve në Tiranë dhe në Rrethë” për rreth 8-10 mijë studentë, mbështetjes me bursa të rreth 100-120 studentë të rinj ekselentë që ndjekin studimet në 15 universitetet më të mira, referuar renditjes së “Times Higher Education”;
- ✓ Edukimin nëpërmjet sportit si një faktor efikas në përmirësimin e shëndetit e të mirëqenies për qytetarët përmes sigurimit të një shërbimi cilësor nëpërmjet sportit elitare dhe sportit në tërësi në institucionet arsimore duke kontribuar kështu dhe në forcimin e statusit të të rinjve shqiptarë në të gjitha fushat e jetës.

❖ Rezultatet që synohet të arrihen për periudhën afatmesme 2019-2021

Për arsimin parauniversitar për periudhën 2019-2020 synohet si më poshtë :

- ✓ Në arsimin nparashkollor: Rritja e aksesit të fëmijëve 3-6 vjeç që ndjekin arsimin parashkollor nga rreth 75.7% në vitin 2018, në nivelin 84.9% në vitet 2020-2021.
- ✓ Për një arsim gjithpërfshirës, deri në vitin 2021 do të sigurohet arsim cilësor me synim 100% e fëmijëve të grupmoshës 6-16 vjeç të ndjekin arsimin 9-vjeçar.
- ✓ Rritja e treguesit të regjistrimit me 10-15% ose 350-500 fëmijë për nxënësit romë dhe egjiptianë, 10% për nxënësit me aftësi të Kufizuar.
- ✓ Rritja e numrit të mësuesve ndihmës për nxënësit me aftësi të Kufizuar. Gjithashtu do të synohet deri në 2021 dyfishimi i mësuesëve ndihmës për fëmijët me aftësi të Kufizuar.
- ✓ Në vitin 2021 synohet të sigurohet aksesit që 100% e fëmijëve 5- 6 vjeçarë të ndjekin klasat ose grupet përgatitore të arsimit parashkollor.
- ✓ Reformimi i arsimit parashkollor, përmes miratimit të programeve për çdo grup-moshe, trajnimit të 900-1000 mësuesve/ edukatorëve në vitin 2019.
- ✓ Reduktimi i braktisjes shkollore në arsimin bazë, duke synuar drejt braktisjes 0 nga 0.57% që rezulton në vitin 2018. Të rritet kalueshmëria pa mbetje nga klasat 1-9 me 2%.
- ✓ Të rritet kalueshmëria në provimet e lirimimit me 1% si dhe të përmirësohet në vijimësi rezultatet e nxënësve të arsimit bazë në vlerësimin e arritjeve. Të rritet nota mesatare në provimet e lirimimit me 0.6%, e konkretisht nga 7 në vitin 2018 në 8 për vitin 2020.
- ✓ Të rritet numri i shkollave Qendër Komunitare, nga viti 2018 me 20% ose me 50 shkolla të tjera nga numri aktual.
- ✓ Në vitin 2021, 98% e nxënësve që mbarojnë arsimin bazë të regjistrohen në një nga format/ llojet e arsimit të mesëm, nga të cilët 65% të ndjekin Arsimin e Mesëm të Përgjithshëm Gjinnaze dhe 35% Arsimin Profesional.

- ✓ Shërbimi Psiko-Social, aktualisht në shkollat e arsimit të mesëm të lartë ofrohet sipas kësaj norme: Një psikolog dhe një punonjës social për çdo 2,800-3,500 nxënës. Deri në 2021 çdo shkollë e mesme do të ketë një psikolog dhe/ose një punonjës social.
- ✓ Deri në 2021, 100% e shkollave do të kenë shërbimin e internetit nga niveli aktual prej 85%. Të arrihet raporti 1 kompjuter/2 nxënës.
- ✓ Do të vijojë zhvillimi profesional përmes trajnimeve mbështetur mbi nevojat për mësuesit dhe drejtuesit e insitucioneve shkollore si në nivel shkolle ashtu dhe ato të ofruara përmes sistemit kërkesë/ofertë. Në këtë skemë do të përfshihen edhe trajnimet e mësuesëve të diasporës dhe minoriteteve. Përkatësisht trajnimi çdo vit 40 -50 mësuesve të minoriteteve dhe trajnimi i 70 -100 mësuesve dhe trajnerëve të diasporës për mësimin plotësues në gjuhën shqipe.
- ✓ Në vitin 2021, për arsimin parashkollor dhe bazë synohet arritja e standardit evropian me 20 nxënës për mësues dhe jo më shumë se 30 nxënës për klasë në zonat urbane.
- ✓ Në vitin 2021 për arsimin e mesëm synohet arritja e standardit evropian, jo më shumë se 28 - 30 nxënës për klasë në zonën urbane, e cila do të mundësohet përmes investimeve në infrastrukturën shkollore.

Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor për periudhën 2019-2020 parashikohet sa më poshtë:

- ✓ Sigurimi i cilësisë në arsimin e lartë në nivel institucional e të programeve të studimit sipas kritereve e standardeve ndërkombëtare të HEAL-it, në përputhje me kërkesat e tregut lokal dhe kombëtar të punës.
- ✓ 100% e Institucioneve të Arsimit të Lartë deri në vitin 2021, të sigurojnë akreditimin institucional e akreditim e programeve të studimit. Konkretisht, rritja e numrit të programeve që akreditohen nga 237 në vitin 2018 në 513 në vitin 2021.
- ✓ Rritja e kapaciteteve akademiko-kërkimore dhe stafit të Institucioneve të Arsimit të Lartë në përmbushje të standardeve akademike;
- ✓ 95% e doktorantëve janë pjesë e stafëve me kohë të plotë e departamenteve në 2021;
- ✓ Synohet që 30% e financimit për kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë vjen nga ente private në 2021;
- ✓ Rritja e mobilitetit të stafit dhe studentëve me 20% ndaj viti paraardhës;(e matur me javë, muaj) ;
- ✓ 100% e studentëve ekselentë, studentë në nevojë të përfitojnë bursa, tarifa shkollimi zero dhe kredi studentore në 2021;
- ✓ Nxitja e punës kërkimore në Institucionet e Arsimit të Lartë publike nëpërmjet financimit të drejtpërdrejtë të 3,500 - 4000 kërkuesve gjatë periudhës 2019-2021, ku 30% e kërkuesëve të jenë femra në përputhje me parimet e barazisë gjinore.

Për sportin dhe rininë për periudhën 2019-2021 parashikohet:

- ✓ Rritja e numrit të sportistëve të licensuar në federata shqiptare të sportit, nga 20 384 në vitin 2018, në 21 000 në vitin 2021.
- ✓ Rritja e pjesëmarrjes së të rinjëve në programin e praktikave të punës nga 600 në vitin 2019, në 900 të rinj në vitin 2021.
- ✓ Sigurimi i mbështetjes financiare për 25 federata Olimpike dhe jo Olimpike në aktivitete Evropiane, Botërore dhe Ballkanike me synim kualifikim për lojërat Olimpike Japoni 2020.
- ✓ 20-25 Sportistë elitare të mbështetur financiarisht për rezultate të larta në aktivitete ndërkombëtare. (medalje e fituara);
- ✓ Rritja e pjesëmarrjes së të rinjve në aktivitete me karakter social-kulturor dhe edukativ përmes rindërtimit dhe përmirësimit të infrastrukturës së 3 qendrave rinore rajonale.

ARSIMI PROFESIONAL DHE PUNËSIMI

Prioritetet gjatë periudhës 2019-2021 që synohen në fushën e arsimit profesional dhe punësimit janë:

- Punësimi në total prej 7,260 të papunë nga grupet e veçanta;
- Përfshirja në programet e nxitjes së punësimit të praktikave profesionale të rreth 2,250 të rinj të sapodiplomuar në Arsimin e Lartë;
- Punësimi në total i rreth 900 grave kryefamiljare me fëmijë në ngarkim dhe vajza nëna;
- Trajnimi nëpërmjet programeve të nxitjes së punësimit të rreth 5,100 të papunëve të trajtuar më parë me ndihmë ekonomike;
- Rritjen e numrit të të punësuarve pas diplomimit në shkollat e mesme profesionale në 46% të totalit që mbarojnë studimet në vitin 2021, krahasuar me 42% në vitin 2018;
- Rritja e numrit të të diplomuarve në shkollat e mesme profesionale, nga 3.300 nxënës në 2018, në 3.600 nxënës në vitin 2021;
- Rritja e numrit të nxënësve që vijnë nga zonat rurale të cilët ndjekin studimet në shkollat e mesme profesionale, nga 40% e totalit në vitin 2018 në 55% e totalit në vitin 2021;
- Rritja e numrit të nxënësve me aftësi të kufizuar që ndjekin studimet në shkollat e mesme profesionale nga 90 nxënës në vitin 2018 në 120 nxënës në vitin 2021.

TURIZMI DHE MJEDISI

Prioritetet për periudhën 2019-2021:

Në fushën e turizmit dhe mjedisit për periudhën 2019-2021 synohet të arrihet:

- ✓ Diversifikimi i produktit turistik për të arritur një turizëm gjithëvjetor;
- ✓ Arritja e përmirësimeve të matshme të cilësisë së ajrit në vitin 2021 sipas përcaktimeve në strategjinë kombëtare të ajrit;
- ✓ Përmirësimi i performancës së menaxhimit të integruar të mbetjeve;
- ✓ Reduktimi i ndotjes nga shkarkimet industriale për lejet e tipit A dhe B dhe i rrezeve nga aksidentet industriale sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- ✓ Forcimi i mbrojtjes së natyrës dhe biodiversitetit dhe forcimi i menaxhimit dhe ruajtjes së burimeve ujore;
- ✓ Përmirësimi i menaxhimit efektiv dhe sigurimi i vazhdueshëm i mbrojtjes dhe administrimit të zonave të mbrojtura.

KULTURA

Prioritetet 2019-2021:

Në fushat e kulturës dhe trashëgimisë kulturore do të prioritetizohet:

- Mbështetja e veprimtarive të artit skenik; përfshirë edhe teatrin eksperimental dhe nxitjen e artistëve të rinj;
- Mbështetja e arteve pamore përmes organizimit të ekspozitave kombëtare dhe ndërkombëtare të arteve pamore; kinematografisë;
- Edukimi përmes librit dhe veprimtarive bibliotekare;
- Rritja e aksesit të publikut në Muze, Monumentet e kulturës, ansambleve arkitektonike, qyteteve muze, qendra historike, zonave dhe parqeve arkeologjike në funksion të turizmit kulturor.

❖ **Rezultatet që synohet të arrihen për periudhën afatmesme 2019-2021**

Për Trashëgiminë kulturore

- Restaurimi dhe mirëmbajtja e trashëgimisë arkitektonike dhe peisazhit, duke përfshirë restaurimin e disa linjave muzeale, përfshirë edhe në Muzeun Kombëtar të Tiranës si edhe përshtatjen me standarde bashkëkohore.
- Rritja e aksesit të publikut në Muze, Monumentet e kulturës, ansambleve arkitektonike, qyteteve muze, qendra historike, zonave dhe parqeve arkeologjike në funksion të turizmit kulturor, rritjen e numrit të bartësve të trashëgimisë jomateriale dhe spektatorëve me 10% në vit, nga pothuaj 700,000 vizitorë në 2017-ën (Përmirësimi i standardeve dhe përvojës së vizitorëve në muze dhe objektet e trashëgimisë kulturore).
- Edukimi përmes kulturës - Aktivitete periodike të fushës së trashëgimisë kulturore të zhvilluara nga Qendra Kombëtare e Veprave Folklorike, si nismat “Miku i monumentit” dhe “Edukimi përmes trashëgimisë kulturore”; nga 22 në vit në 2018 në 40 në 2019 dhe 50 – 55 përkatësisht në vitet 2020 – 2021;
- Mbështetja e aktiviteteve të fushës së trashëgimisë kulturore organizuar nga organizata jopublike (projekte me thirrje) dhe vijimi i mbështetjes financiare për projektet në fushën e artizanatit, kulinarisë dhe dukurive të tjera të trashëgimisë jomateriale, veçanërisht për gratë artizane.

Për Artin dhe Kulturën

- Rritja e aksesit në kulturë, e cila parashikon një rritje të vazhdueshme të numrit dhe cilësisë së aktiviteteve në të gjitha zhanret. Rrjet aktivitetesh që synojnë në konsolidimin e vlerave artistike, promovimin e Artit Shqiptar në arenën ndërkombëtare, mbështetja e aktiviteteve kulturore në mbarë vendin nëpërmjet thirrjeve për aplikime në fushën e artit dhe kulturës librit dhe përkthimit.
- Prioritet do të jetë integrimi, angazhimi dhe promovimi i të rinjve më të evidentuar të kësaj fushe.
- Mbështetja e skenës së pavarur për të mundësuar edukimin përmes kulturës si dhe përfaqësimin e produktit artistik në arenën elitare ndërkombëtare

DREJTËSIA

❖ Prioritetet 2019-2021:

Ministria e Drejtësisë për periudhën 2019-2021 do të prioritetizojë:

- ✓ Jetësimin e Reformës në Drejtësi;
- ✓ Forcimin e luftës kundër Korrupsionit në Administratë;
- ✓ Legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve dhe zonave informale.
- ✓ Rregullimin e çështjes së pronave në zbatim të ligjit 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” dhe akteve nënligjore;
- ✓ Garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të personave me liri të kufizuar në sistemin e burgjeve dhe sigurimin e ri-integrimit të tyre në shoqëri;
- ✓ Rritjen e performancës së Shërbimit të Provës në zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi dhe standardeve më të larta në fushën e masave alternative për realizimin e programeve sa më efikase në realizimin e rehabilitimit të të dënuarve me masa alternative.

❖ Rezultatet që synohet të arrihen për periudhën afatmesme 2019-2021

Për Sistemin e Burgjeve synohet:

- Numri i Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) sipas standardeve të ketë një trend rritës nga 42% që është aktualisht;

- Norma e recidivitetit (burra) të ketë një trend rënës nga 11% që është aktualisht;
- Norma e recidivitetit (gra) të ketë një trend rënës nga 1% që është aktualisht;
- Të dënuar që punësohen pasi fitojnë lirinë të rritet nga 10% e totalit që është aktualisht.

Për Shërbimin e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave synohet:

- Sigurimi i një numri praktikash legalizimi pasurish informale prej 25,000 raste në vit;
- Realizimi i sigurtë i të ardhurave nga legalizimi me një vlerë prej 1,150,000,000 lekë çdo vit;
- Realizimi i skemës së shpërndarjes së Fondit Special të Kompensimit nga 68% që është aktualisht në 99% në 2021;
- Ndarja e fondit të vënë në dispozicion kundrejt subjekteve që kanë përfituar të drejtën e kompensimit duke bërë që të rritet numri subjekteve të kompensuara nga viti në vit.

REFORMA NË DREJTËSI, ARRITJET 2018 DHE SYNIMET 2019-2021

Sistemi i drejtësisë në Shqipëri i është nënshtruar një sërë reformash të thella, në funksion të përmbushjes së standardeve evropiane në këtë sistem. Përmes miratimit të Ligjit nr. 76/2016 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417/1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", e ndryshuar, Shqipëria filloi zbatimin e reformës në drejtësi.

Synimet e Reformës në Drejtësi ne periudhën afatgjatë janë:

- Të forcoje llogaridhënien e gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe të luftojë korrupsionin brenda sistemit të drejtësisë;
- Të demonstrojë progres të mëtijshëm me synim krijimin e precedentëve solidë të hetimeve, ndjekjes penale dhe dënimeve në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar në të gjitha nivelet;
- Të përmirësojë mekanizmat institucionale për të nxitur përpjekjet për ta sjellë legjislacionin ekzistues për drejtësinë për të mitur në përputhje me standarde ndërkombëtare;

Arritje 2018 dhe Objektivat 2019-2021

Një paketë prej 27 ligjesh është planifikuar të miratohet, duke mbuluar të gjitha aspektet e reformës gjyqësore. Deri më sot, Kuvendi ka miratuar 17 ligje, ndërkohë janë në proces edhe 6 projektligje të tjera, ku 4 prej tyre janë tërhequr nga procesi i miratimit. Gjatë vitit 2018, Parlamenti i Shqipërisë ka miratuar dy ligje si pasoje e reformimit të Sistemit të Drejtësisë.

1. Ligjin nr. 26/2018, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 385, datë 24.2.2011, "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve"
2. Ligji nr.55/2018 "Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë"

Janë ngritur dhe po funksionojnë 3 institucione të reja të sistemit të drejtësisë:

- Komisioneri Publikë;
- Kolegji i Posaçëm të Apelit;
- Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.

Procesi i vlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga këto institucione, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë.

- Në datën **15 janar 2018** u zhvillua shorti për shpërndarjen e çështjeve në trupat gjyqësore. Pjesë e kësaj liste janë kryetarët e gjykatave, prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme, gjyqtarët e Gjykatave të Apelit; në total **36 subjekte rivlerësimi**, për të cilët nisi menjëherë procedura e rivlerësimit.
- Në datën **15 mars 2018** u zhvillua shorti i radhës për shpërndarjen e çështjeve në trupat gjyqësore. Pjesë e kësaj liste janë kryetarët e gjykatave të rretheve dhe drejtuesit e prokurorive të rretheve; në total 36 subjekte rivlerësimi, për të cilët nisi menjëherë procedura e rivlerësimit.
- **Përmbledhje:** Numri i përgjithshëm i vendimeve të dhëna nga Komisioni është 67 vendime:
 - 27 vendime për konfirmimin në detyrë të 17 gjyqtarëve dhe 10 prokurorëve
 - 25 vendime për shkarkimin nga detyra të 16 gjyqtarëve dhe 9 prokurorëve
 - 7 vendime për ndërprerjen e procesit për 3 gjyqtarë dhe 2 prokurorë, 1 këshilltar ligjor në Gjykatën Kushtetuese;
 - 8 vendime për pushimin e procesit për 2 gjyqtarë, 1 prokuror dhe 5 ndihmësve ligjorë të Gjykatës së Lartë.

Objektivat

- Forcimi i statusit të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve të gjitha niveleve, përfshirë ndihmës-magjistratët /këshilltarët ligjorë në përputhje me standardet evropiane që sigurojnë emërim dhe zhvillim të karrierës që janë të bazuara në meritë
- Krijimi i një inspektorati të vetëm të pavarur përgjegjës për të hetuar shkeljet disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe për të zhvilluar shërbime të tjera inspektimi në gjykata dhe prokurori në përputhje me standardet evropiane
- Rritja e funksionimit të KLGJ dhe zgjerimi i objektit të kompetencave të tij, duke i bërë gjykatat më të larta pjesë të objektit të saj dhe duke zgjeruar funksionet, p.sh. në lidhje me IT, buxhetin gjyqësor, administrimin e gjykatave, raportimin dhe marrëdhëniet me publikun në bazë të standardeve Evropiane dhe ndërkombëtare.
- Krijimi i KLP dhe ngritja e kapaciteteve në bazë të standardeve moderne evropiane dhe zbatimi i ndryshimeve të fundit ligjore
- Krijimi i një strukture të specializuar anti-korrupsion në nivel kombëtar, të përbërë nga policia, prokuroria dhe gjykata.

POLITIKA E JASHTME

❖ Prioritetet 2019-2021:

Objektivat kryesorë që synohen të arrihen nga aktiviteti i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme për vitin 2019-2021 janë:

- Hapja e negociatave për anëtarësimin në Bashkimin European, duke mbështetur strukturat e administratës publike që do të angazhohen në procesin e “screening”
- Zhvillimi i mëtejshëm i marrëdhënieve me prioritet partneriteti strategjik.
- Vazhdimi i angazhimeve për njohjen e mëtejshme ndërkombëtare të shtetit të Kosovës për pjesëmarrje dhe anëtarësimin e saj në organizatat rajonale dhe ndërkombëtare.
- Funksionalizimi dhe mbështetja e punës së dy nismave rajonale me seli në Tiranë: Zyra Rajonale për Bashkëpunim Rinor dhe Fondi i Ballkanit Perendimor si dhe në tërësi pjesëmarrjes aktive në bashkëpunimet shumëpalëshe rajonale.
- Kryesimi i disa nismave rajonale dhe organizatave ndërkombëtare.
- Pjesëmarrje aktive dhe realizimi i kontributit të Republikës së Shqipërisë në kuadër të NATO-s.
- Zbatimi i detyrimeve të anëtarësimit në organizata dhe forume shumëpalëshe.
- Plotësimi i bazës ligjore të bashkëpunimit me vendet e tjera.
- Forcimi dhe rritja e rolit të diplomacisë publike ekonomike dhe diasporës, në shërbim të interesave ekonomike të Shqipërisë, promovimit dhe potencialit për investime, tregti dhe bashkëpunim ekonomik, tregëtar dhe kulturor me partneret tanë ndërkombëtarë dy dhe shumë palësh.
- Realizimi i shërbimit konsullor mbështetur në profesionalizëm, efikasitet, transparencë dhe përgjegjshmëri.

MBROJTJA

❖ Prioritetet 2019-2021:

Ministria e Mbrojtjes synon të përmbushë reformat e nisura dhe realizimin e detyrave kushtetuese të Forcave të Armatosura (FA), angazhimeve ndërkombëtare në kuadër të NATO-s, angazhimeve të FA në kuadër rajonal dhe në aftësitë trajnuese të vetë FA. Më konkretisht, Ministria e Mbrojtjes synon:

- Modernizimin e kapaciteteve dhe infrastrukturës së FA duke:
 - zhvilluar kapacitetet e FA në përputhje me Planin Afatgjatë të Zhvillimit;
 - vijuar pajisjen e Forcave Tokësore me armatim të ri të ndërveprueshëm me aleatët në NATO;
 - zgjeruar investimet në infrastrukturë për përmirësimin e mjediseve të punës dhe ushtarake;
 - modernizuar pajisjet dhe sistemet kompjuterike.
- Vijimin e pjesëmarrjes në operacionet e NATO-s duke rritur nivelin e angazhimit të FA, në operacionet e Aleancës dhe pjesëmarrjen në misionet e iniciativat e reja që NATO mund të ndërmarrë.
- Zhvillimin dhe mbajtja në gatishmëri të kapaciteteve të FA për operacione të mbrojtjes kombëtare dhe kolektive, operacione në përgjigje të krizave, si dhe kapacitetet për përballimin e Emergjencave Civile, dhënien e ndihmës vendeve të rajonit në rast emergjencash civile në kuadrin e NATO-s, OKB-se dhe BE-së.

Lartësimin e figurës dhe integritetit të ushtarakut, nëpërmjet zhvillimit të politikave të nevojshme në fushën e personelit, promovimit në karrierë, trajtimit të ushtarakut, rritjes së transparencës, llogaridhënies, si dhe eliminimin e korrupsionit në Forcat e Armatosura.

RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE

❖ Prioritetet 2019-2021:

Në fushën e rendit dhe sigurisë publike përgjatë viteve 2019-2021, synohet mbrojtja e të drejtave dhe lirive të njeriut, si dhe garantimi i sigurisë së jetës, shëndetit dhe pronës së qytetarit, të cilat janë dhe prioritete për veprimtarinë e Policisë së Shtetit, e cila do të ketë si togfjalësh kyç në veprimtarinë e saj, 'kontrollin e territorit' dhe 'policimin në komunitet', të realizuara në praktikë përmes riorganizimit të sistemit të prezencës së policisë në territor, në funksion të një kontrolli më efektiv të tij dhe transformimin rrënjësor të marrëdhënieve dhe shërbimit ndaj komunitetit.

Gjithashtu, synohet sigurimi i rendit publik, pronës publike e private, rritja e parametrave të sigurisë rrugore, krijimi i një mjedisi të sigurt për komunitetin, nëpërmjet shërbimeve profesionale, në kohë dhe me cilësi dhe policimit me standardet me të larta të performancës.

Synohet përmirësimi i vazhdueshëm i Sigurisë së Personaliteteve Vendas dhe të Huaj, të Objekteve të Rëndësisë së Veçantë nëpërmjet rritjes së kapaciteteve menaxhuese dhe përputhjes me standardet europiane në fushën e sigurisë.

❖ Rezultatet që synohet të arrihen për periudhën afatmesme 2019-2021

Përgjatë 3 viteve të PBA 2019-2021, Ministria e Brendshme do të përmbushë objektivat e saj përmes:

- Rritjes së numrit të hetimeve proaktive në luftën kundër krimit të organizuar, trafikëve, korrupsionit dhe terrorizmit;
- Përmirësimit rrënjësor të sistemit të kontrollit rrugor, duke synuar krijimin e një kulture të re në qarkullimin e mjeteve dhe të qytetarëve dhe sidomos në menaxhimin e sigurisë rrugore. Synohet ulja e numrit të aksidenteve në rrugë në masën 1% çdo vit, nga 1959 raste që parashikohen deri në fund të vitit 2018;
- Rritjes së nivelit të sigurisë publike duke forcuar kontrollin e territorit dhe policimin në komunitet përmes rritjes së numrit të shërbimeve të patrullimit (nga 296,276 shërbime në vitin 2018 në 362,950 shërbime në vitin 2021) si dhe reduktimit të kohës së reagimit të shërbimeve policore (nga 23 minuta në vitin 2018 në 15 minuta në vitin 2021).
- Reduktimit të trafikëve, krimit ndërkufitar dhe rasteve të imigrimit të paligjshëm kryesisht nëpërmjet reduktimit të kohës së procedimit (nga 30 minuta në vitin 2018 në 15 minuta në vitin 2021).
- Të kontribuojë në përmirësimin e vazhdueshëm të Sigurisë së Personaliteteve Vendas dhe të Huaj në përputhje me standardet europiane (nga 90% në vitin 2018 në 96% në vitin 2021).
- Përdorimit në mënyrë efektive të përditësimit të ngjarjeve në regjistrin civil, në autorizimin dhe certifikimin e aplikimeve për lëshimin e dokumenteve të identitetit. Synohet reduktimi i kohës për trajtimin e kërkesës nga sistemi i Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile (nga 1.5 orë në vitin 2018 në jo më shumë se 0.5 orë në vitin 2021).

5. BUXHETI VENDOR 2019

Thellimi i decentralizmit fiskal, rritja e autonomisë financiare dhe konsolidimi i financave vendore janë ndër objektivat kryesore të qeverisë në drejtim të përdorimit me efektivitet të fondeve publike në nivel vendor dhe përmirësimit të shërbimeve. Viti 2019, do të jetë viti i implementimit të plotë të të gjithë

instrumentave të reja të parashikuara në ligjin për financat e vetëqeverisjes vendore duke konsoliduar burimet e financimit dhe sigurojnë një menaxhim më cilësor të shpenzimeve vendore.

Buxheti i pushtetit vendor për vitin 2019, do të jetë rreth **11 përqind** më i lartë se ai i 2018-ës ose **5 miliardë lekë** më shumë fonde për shërbime dhe investime publike. Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme e buxhetit të shtetit për njësitë e vetëqeverisjes vendore do të jetë 1 përqind e PBB-së ose **1 miliard lekë** më e madhe se sa ajo e vitit 2018 dhe **5.2 miliard lekë** më e lartë se transferata e vitit 2015. Të ardhurat nga taksat dhe tarifatat në vitin 2019 do të jenë **22.6 miliardë lekë** ose **21 përqind** më të larta se në vitin 2018. Të ardhurat e veta të njësitë të vetëqeverisjes vendore për vitin 2019, krahasuar me vitin 2015, si viti para zbatimit të reformës administrativo-territoriale, janë dy herë më të larta, **10 miliardë lekë** më shumë. Buxheti për vitin 2019 do të jetë 2.92 përqind e PBB-së, dhe krahasuar me vitin 2015 rezulton me një rritje të ndjeshme me rreth 50 përqind.

Miratimi i akteve nënligjore në zbatim të ligjit “Për financat e vetëqeverisjes vendore” si:

- udhëzimeve të procedurave standarte për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm të njësitë të vetëqeverisjes vendore dhe të monitorimit të buxhetit vendor;
- përdorimi i një instrumenti të ri për planifikimin financiar dhe hartimin e programit buxhetor afatmesëm që standardizon mënyrën e paraqitjes së informacionit buxhetor;
- unifikimi i programeve buxhetore të standartizuara për të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- mbështetja dhe monitorimi i procesit të hartimit të programit buxhetor afatmesëm për njësitë të vetëqeverisjes vendore;
- zhvillimi i seancave degjimore dhe konsultative midis qeverisë qendrore dhe asaj vendore; si dhe
- hyrja në fuqi e udhëzimit për vështirësitë financiare të njësitë të vetëqeverisjes vendore.

Këto masa, për vitin 2019 dhe në vazhdim, rrisin autonominë financiare dhe për rrjedhojë më shumë fonde për njësitë e vetëqeverisjes vendore, garantojnë më shumë parashikueshmëri, stabilitet dhe transparencë të buxheteve vendore dhe njëkohësisht disiplinë financiare dhe mirëmenaxhim të financave publike në nivel vendor.

Tashmë, me buxhetin e vitit 2019, konsolidohet transferimi i plotë pranë bashkive i funksioneve të decentralizuara në vitin 2016 me Ligjin për Vetëqeverisjen Vendore, dhe bashkë me to mbështetja financiare për periudhën tranzitore prej 3 vitesh. Rritja e burimeve të buxhetit vendor në vitin 2019, për të tretin vit radhazi, krijon më shumë hapësira për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve për qytetaret (për funksionet ekzistuese dhe ato të reja të tranferuara në 2016) dhe njëkohësisht për uljen e stokut të detyrimeve të prapambetura të trashëguara nga ndarja e vjetër administrativo territoriale.

Fokusi kryesor në buxhetin vendor të vitit 2019 do të jetë në funksion të vazhdimit të zbatimit të reformës administrativo territoriale dhe decentralizimit fiskal të njësitë të vetëqeverisjes vendore nëpërmjet:

- *Rritjes së nivelit, stabilitetit dhe parashikueshmërisë së transfertave ndërqeveritare.*
- *Konsolidimit të procedurave dhe sistemit të menaxhimit të financave vendore në të gjitha hapat, që nga hartimi i programit buxhetor afatmesëm tek zbatimi dhe monitorimi i tij.*
- *Sigurimit të menaxhimit financiar transparent dhe efektiv për të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore;*
- *Planifikimit dhe buxhetimit eficient dhe të mirë-integruar i shpenzimeve publike në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimeve ndaj qyteratëve dhe përdorimit me ekonomi të fondeve vendore;*

- *Unifikimit të standardeve të procesit të hartimit të programit buxhetor afatmesëm dhe programimi mbi bazën e një sistemi të unifikuar programesh;*
- *Përmirësimit të cilësisë së raporteve të monitorimit të buxhetit vendor dhe krijimi i një sistemi të monitorimit mbi bazën e treguesve të performancës.*
- *Garantimit të një sistemi të financave publike vendore që nxit transparencën, përgjegjshmërinë dhe eficiencën në menaxhimin dhe përdorimin e burimeve publike.*
- *Implementimit të një metodologjie të mirëstrukturuar në lidhje me evidentimin e rasteve të vështirësive financiare të njësisve të vetëqeverisjes vendore.*

❖ **Arsimi Parashkollor në Buxhetin 2019**

Arsimi parashkollor është një nga funksionet më të kushtueshme që iu transferua bashkive në janar të vitit 2016. Përgjatë tre viteve të fundit, ky funksion është financuar me transferta specifike, të kushtëzuara për pagat e edukatoreve dhe personelit mbështetës të kopshteve, sipas gjendjes në fund të vitit 2015. Përgjatë tre viteve të fundit fondet për kopshtet janë rritur ndjeshëm me 670 milionë lekë ose 18%, duke rritur kryesisht numrin e edukatoreve. Periudha tranzitore e parashikuar për financimin e këtij funksioni por edhe disa funksioneve të tjera të decentralizuara rishtazi, me transferta specifike përfundon në dhjetor 2018, dhe duke filluar nga janari 2019, këto fonde do tu transferohen bashkive si transfertë e pakushtëzuar sektoriale.

Në kuadrin e politikave efektive të decentralizimit fiskal, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë kanë punuar për të siguruar që transferimi i funksioneve në nivel vendor të shoqërohet me vendosjen e një skeme financimi të përshtatshme dhe efektive që synon përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve. Në këtë kuadër, në buxhetin e vitit 2019 është hartuar një formulë e re e ndarjes së fondeve për arsimin parashkollor e cila, implementon legjislacionin për arsimin parauniversitar, legjislacionin për qeverisjen dhe financat vendore dhe që bazohet në praktikën e mira ndërkombëtare.

Buxheti i vitit 2019, shënon fillimin e një reforme të rëndësishme që vendos një standard të ri në arsimin parashkollor. Duke filluar nga viti 2019, konform kuadrin ligjor në fuqi dhe praktikave më të mira ndërkombëtare, fondet për arsimin parashkollor do të ndahen kryesisht mbi bazën e numrit të nxënësve, si treguesi më i mirë i nevojës për fonde dhe shërbime, dhe pjesërisht do të bazohet në sistemin aktual të ndarjes së fondeve sipas numrit të edukatoreve të transferuara në vitin 2016 deri në vitin 2018.

Ndryshimi i sistemit të ndarjes së fondeve për arsimin parashkollor në vendin tonë përbën një domosdoshmëri, pasi sistemi aktual nuk reflekton në mënyrë të saktë ndryshimet sociale, demografike dhe infrastrukturore që kanë ndodhur përgjatë më shumë se dy dekadave të fundit. Raporti aktual i madhësisë mesatare të grupeve të fëmijëve në kopshte është 18 fëmijë për një edukatore, me një minimum prej 3 fëmijësh për edukatore dhe një maksimum prej 26 fëmijësh për edukatore. Pra, ekziston një nevojë shumë e madhe për shtimin e edukatoreve në disa bashki të cilat përpjestimisht kanë një numër shumë më të lartë fëmijësh të cilëve duhet t'u garantojmë aksesin në kopshte.

Pranohet gjerësisht në fushën e financave të arsimit që madhësia e grupeve dhe klasave në zonat urbane priret të jetë relativisht më e lartë se mesatarja, ndërsa pranohen grupe mesatare të vogla apo edhe shumë të vogla në zonat rurale dhe sidomos ato të thella rurale me relief malor, të cilat kanë përjetuar edhe valë masive migrimi dhe emigrimi. Megjithatë, ndryshimi i sistemit të financimit të kopshteve është i domosdoshëm, sidomos në ato bashki të cilat përgjatë dy dekadave të fundit janë përballur me një rritje të madhe dhe të shpejtë të popullsisë, ndërkohë që numri i kopshteve dhe edukatoreve nuk ka ndjekur të njëjtat ritme rritjeje. Në praktikën ndërkombëtare, rekomandohet kalimi në një sistem financimi të bazuar kryesisht mbi numrin e fëmijëve. Kjo domosdoshmëri njihet edhe nga legjislacioni aktual për arsimin

parauniversitar në vendin tonë. Reforma është plotësisht në përputhje me parashikimet e nenit 28 dhe 37 të Ligjit nr. 69 datë 21.06.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar” dhe praktikat e mira ndërkombëtare që rekomandojnë një ndarje të fondeve, kryesisht mbi bazën e numrit të fëmijëve (me moshë 3-6 vjeç).

Për sa më sipër, në buxhetin e vitit 2019, fondet e pagave për edukatorët do të ndahen kryesisht mbi bazën e numrit të fëmijëve. Më specifikisht, 60% e fondeve për pagat e edukatoreve do të ndahen mbi bazën e numrit të fëmijëve (me moshë 3-6 vjeç) dhe 40% mbi bazën e numrit të edukatoreve. Kjo reformë siguron një ndarje më të përshtatshme të fondeve, duke u bazuar në numrin e fëmijëve që duhet t’u ofrohet edukimi parashkollor, por njëkohësisht siguron një tranzicion gradual që minimizon kostot, duke ruajtur 40% të sistemit aktual.


Kjo reformë synon dhe siguron:

- Uljen e madhësisë së grupeve/klasave të fëmijëve në kopshte nga raporti aktual mesatar 18 fëmijë për një edukatore në raportin 15 fëmijë për një edukatore.
- Shtimin e fondeve në ato bashki ku ka një nevojë reale dhe të menjëhershme për shtimin e numrit të edukatoreve duke ulur madhësinë maksimale të grupeve nga 26 apo 23 fëmijë për një edukatore në 18 fëmijë për edukatore, një parakusht për përmirësimin e cilësisë së edukimit për fëmijët nga 3-6 vjeç që ndjekin kopshtet publike. Shtimi i numrit të edukatoreve nënkupton edhe shtimin e kapaciteteve të shërbimit, duke ulur kështu nevojën për dërgimin e fëmijëve në kopshte private.
- Ruajtjen e nivelit aktual të fondeve për ato bashki të cilat rezultojnë të kenë një numër relativisht “të lartë” edukatoresh për numrin e fëmijëve të regjistruar në kopshte, krahasimisht me bashkitë e tjera.
- Një ndarje më të drejtë të fondeve për pagat e edukatoreve, duke zbutur diferencat ndërmjet bashkive përsa i përket raportit fëmijë për edukatore.

Kostoja e kësaj reforme është 327 milionë lekë, dhe mbulohet nga rritja e transfertës së pakushtëzuar për bashkitë për vitin 2019. Kjo siguron një rritje të numrit të edukatoreve nga 4410 në 4850, pra 440 edukatorë më shumë, të cilët do të shpërndahen në 32 bashki të cilët kanë nevojën më imediate për shtimin e numrit të edukatoreve. Në këtë grup kemi si bashki të mëdha ashtu edhe të vogla për nga popullsia, bashki me një territor kryesisht urban, bashki me një territor kryesisht rural, bashki me relief relativisht malor dhe fushor. E thënë ndryshe nuk janë vetëm bashkitë e mëdha urbane por janë disa lloje bashkish që përfitojnë.

Kjo reformë, bën një ndarje më të drejtë të fondeve, zbut diferencat ndërmjet bashkive përsa i përket raportit “fëmijë për edukatore” dhe siguron fonde shtesë për ato bashki që kanë një nevojë imediate për rritjen e numrit të edukatorëve. Grafiku nr.1, tregon efektet e kësaj reforme nëpërmjet raportit fëmijë për edukatore. Në krahun e djathtë të grafikut, tregohet se në bashkinë e Tiranës, aktualisht ka një raport prej 26 fëmijësh për një edukatore sikurse tregohet nga kolona gri, në bashkinë Ura Vajgurore me një raport 25 fëmijë për edukatore, në bashkinë Kamëz me një raport 23 fëmijë për edukatore e kështu me radhë. Të tre këto bashki, nëpërmjet kësaj reforme do të kenë mundësinë të ulin madhësinë mesatare të grupeve në 18 fëmijë për një edukatore. Vija e kuqe e pandërprerë tregon raportin e ri “fëmijë për edukatore” që do të vendoset me kalimin e kësaj reforme. Në krahun e djathtë të grafikut tregohen të gjitha bashkitë që do të përfitojnë fonde shtesë nga kjo reformë dhe që do të jenë në gjendje të ulin madhësinë mesatare të grupeve të fëmijëve duke mundësuar një cilësi më të mirë të edukimit.

Figura 1



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Në krahasim të grafikut, vija blu e ndërprerë tregon ato bashki të cilat do duhej të rrisnin madhësinë aktuale të grupeve të fëmijëve, pra ato bashki që aktualisht rezultojnë të kenë një numër relativisht më “të lartë” të edukatoreve për numrin e fëmijëve që duhet t’u shërbejnë. Megjithatë ekzistojnë hapësira për optimizim të përdorimit të fondeve, duhet të mbahet në konsideratë që në ato bashki të cilat kanë një territor kryesisht rural apo malor, është e pritshme që grupet dhe klasat do të jenë më të vogla se mesatarja në zonat urbane. Në këtë kuadër, bashkitë në krahasim të grafikut, që do të rezultojnë me humbje nga ndryshimi i formulës së ndarjes së fondeve për edukatorët e arsimit parashkollor, do të kompensohen plotësisht, pra do marrin të njëjtat fonde që kanë marrë në vitin 2018.

Në përfundim, reforma rrit financimin për një nga nivelet më delikate dhe të rëndësishme të arsimit dhe synon një përmirësim të cilësisë së shërbimeve në kopshte, sidomos në ato bashki të cilat kanë një nevojë reale dhe urgjente për shtimin e numrit të edukatoreve. Reforma bazohet në praktikën më të mirë ndërkombëtare dhe është plotësisht në harmoni me kuadrin ligjor për arsimin parauniversitar, financat vendore dhe reformat e decentralizimit të ndërmarra. Ndërkohë, për vitin 2019 nuk do të ketë asnjë humbje nga ndryshimi i formulës së ndarjes së fondeve për pagat e edukatoreve. Kjo reformë është në harmoni dhe mbështet edhe planet e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë për kthimin e arsimit parashkollor në të detyrueshëm për fëmijët e moshës 5-6 vjeçare.

❖ Transferta e pakushtëzuar 2019 dhe formula e shpërndarjes së saj

Ndarja e transfertës së pakushtëzuar për vitin 2019, bazohet në një formulë të thjeshtë për t’u kuptuar dhe zbatuar; të bazuar në kritere që garantojnë funksionimin normal të njësive të vetëqeverisjes vendore. Transferta e pakushtëzuar do t’u sigurojë njësive të vetëqeverisjes vendore mbulimin e diferencës mes kostos së ushtrimit të funksioneve (nevojat për shpenzime) dhe të ardhurave që ato krijojnë në mënyrë të pavarur.


Për vitin 2019, transferata e pakushtëzuar përbëhet nga dy pjesë: a) pjesa e përgjithshme që rezultojnë nga zbatimi i pikës 2 të nenit 23 të Ligjit nr. 68 datë 27.04.2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, i cili përcakton se madhësia e transfertës së pakushtëzuar për vitin 2019 është 1% e Produktit Brendshëm Bruto të parashikuar për vitin 2019 që rezultojnë në nivelin 17.5 miliard lekë; dhe b) pjesa sektoriale prej

7.4 miliard lekë, që rezulton si pasojë e zbatimit të pikës 3 të nenit 95 të Ligjit nr. 139 datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore” për përfundimin e periudhës tranzitore për financimin me transferta specifike të funksioneve të decentralizuara nga ky ligj, dhe zbatimin e pikës 4 të nenit 23 të Ligjit 68 datë 27.04.2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” që rregullon konvertimin e transfertave specifike për funksionet e decentralizuara rishtazi në nivel vendor në transfertë të pakushtëzuar sektoriale.

Formula garanton një sistem më të drejtë ekualizimi fiskal duke ndihmuar bashkitë me kapacitet më të ulët fiskal. Mekanizmi i shpërndarjes së transfertës është i përshtatur në funksion të reformës administrativo-territoriale. Ndarja e grantit bazohet plotësisht në formulë, pa përfshirë fondet për konviktet, shërbimet sociale, fondet e rrugëve rurale dhe rajonale. Gjithshtu, formula e shpërndarjes së transfertës së pakushtëzuar identifikon nevojat për shpenzime të bashkive duke u bazuar tek popullsia relative, dendësia e popullsisë (që reflekton diferencat në koston e ushtrimit të funksioneve ndërmjet bashkive) dhe tek numri faktik i nxënësve në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme në çdo bashki. Përveç ekualizimit të kostove të shërbimeve që bëhet nëpërmjet komponentit të dendësisë, formula e ndarjes së transfertës së pakushtëzuar sjell edhe ekualizimin e kapacitetit fiskal (të matur nga të ardhurat faktike nga taksat e ndara ndërmjet qeverisë qendrore dhe asaj vendore), të cilat mbledhen dhe u transferohen plotësisht ose pjesërisht bashkive nga administrata tatimore qendrore. Ekualizimi fiskal bazohet në të ardhurat faktike nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, nga taksa vjetore e automjeteve të përdorura dhe taksa e kalimit të pasurisë për pasuritë e paluajtshme të shitura nga personat juridik.

Në buxhetin e vitit 2019, shuma e transfertës së pakushtëzuar e shpërndarë me anë të formulës rritet në 17.5 miliardë lekë, nga 16.6 miliardë lekë që ishte në buxhetin e vitit 2018, pra rreth 1 miliardë lekë më shumë (ose rreth 6 % më e lartë) se në vitin 2018. Transferta e pakushtëzuar për vitin 2019, krahasuar me vitin 2013, është 5.4 miliardë lekë më shumë ose rreth 45 përqind më e lartë (sic paraqitet edhe në grafikun e mëposhtëm). Rritja e konsiderueshme e transfertës së pakushtëzuar për të tretin vit radhazi, tregon rëndësinë që ky buxhet i kushton procesit të decentralizimit dhe efikasitetit të qeverisjes vendore.

Figura 2: Transferta e pakushtëzuar 2011-2019



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018);

Viti 2018, ishte viti i fundit i periudhës tranzitore për financimin me transfertë specifike të funksioneve të transferuara në nivel vendor. Në transfertën e pakushtëzuar të parashikuar për vitin 2019, në nivelin prej 1% të PBB-së ose 17.5 miliard, do të shtohen edhe fondet prej 7,4 miliard lekë për funksionet e reja që

për periudhën 2016-2018 janë financuar nëpërmjet transfertave specifike. Duke filluar nga 1 janari 2019, transfertat specifike kthehen në transfertat të pakushtëzuara sektoriale të cilat përdoren në autonomi nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Në përfundim, në vitin 2019, transfertat e pakushtëzuar do të jetë 24.9 miliard lekë.


❖ Detyrimet e prapambetura të njësive të vetëqeverisjes vendore

Ligji i ri për financat e vetëqeverisjes vendore do të forcojë disiplinën financiare për të parandaluar akumulimin e detyrimeve të prapambetura në të ardhmen, që mund të kthehen në një rrezik serioz potencial për këto njësi, me impakt negativ edhe në ekonominë e vendit në tërësi. Në këtë kuadër, qeveria po i kushton një fokus të posaçëm shlyerjes së detyrimeve të prapambetura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore ka zbatuar një plan veprimi për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura që nga viti 2017. Stoku i detyrimeve të prapambetura, i cili parashikohet të shlyhet në një periudhë afatmesme, bazuar në planin e shlyerjes së dërguar nga të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë është ulur në **7.4 miliard lekë nga 11.8 miliard lekë në 2015**. Në vitin 2019 do të vazhdojë të monitorohet periodikisht zbatimi i planit të shlyerjes së detyrimeve nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, deri në shlyerjen e plotë të tyre.

❖ Treguesit Fiskal e Buxhetor të Pushtetit Vendor

Buxheti vendor i vitit 2019, parashikohet të jetë rreth 11 përqind më i lartë se ai i vitit 2018, ose në nivelin prej 2.92 përqind e PBB-së. Krahasuar me vitin 2015 me një rritje të ndjeshme me rreth 50 përqind. Me buxhetin e vitit 2019, do të financohen funksionet e transferuara në 61 bashkitë, dhe të gjitha funksionet e tjera të parashikuara në ligj, të cilat njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë ti ushtrojnë në shërbim të cilësisë së jetës së qytetarëve.

Figura 3: Buxheti Vendor 2015-2019




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018);

Shpenzimet e buxhetit vendor për vitin 2019, janë parashikuar në masën 51.148 miliardë lekë ose 2.92 përqind e PBB-së. Në këtë zë është përlogaritur rritja e transfertës së pakushtëzuar për njësitë e vetëqeverisjes vendore, financimi i funksioneve të reja, të cilat janë transferuar në nivel vendor si dhe rritja e të ardhurave të veta.

Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore për vitin 2019, parashikohet të kenë një rritje me mbi 3.8 miliard lekë më shumë se sa plani i vitit 2018 ose e thënë ndryshe me një rritje prej 21%, ndërkohë krahasuar me vitin 2015 të ardhurat vendore parashikohen me një rritje të konsiderueshme me rreth 90 përqind. Kjo rritje e nivelit të të ardhurave do të vazhdojë si rrjedhojë e ndarjes më të drejtë dhe transparente të financave për njësitë e vetëqeverisjes vendore, përmirësimit të vazhdueshëm të skemës së financimit të funksioneve të veta si dhe rritjes së burimeve të financimit të njësive të vetëqeverisjes vendore. Gjithashtu, ndryshimet që po zbatohen në taksën e pronës, kadastrën fiskale parashikojnë të ndikojnë në peshën e rritjes së të ardhurave në buxhetin vendor.

Në vitet 2017 dhe 2018, ka patur një prirje në rritje të buxhetit vendor, respektivisht me 2.76 përqind të PBB-së në 2017, dhe 2.8 përqind të PBB-së në buxhtin e vitit 2018. Kjo vjen si rezultat i vazhdimit të zbatimit të Reformës Administrativo - Territoriale, rritjes së transfertave qeveritare nga buxheti i shtetit, si dhe politikës së re të decentralizimit fiskal. Po ashtu tendenca e rritjes do të vazhdojë edhe në projektbuxhetin e vitit 2019 (Grafiku 4), ku buxheti vendor, me autonomi të plotë financiare, parashikohet të jetë 2.92 përqind e PBB-së.


Figura 4: Shpenzimet dhe të ardhurat e NJVQV-ve



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018);

Rritja e të ardhurave të mbledhura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore gjatë viteve 2015-2018, evidentohet edhe në rritjen e peshës që zënë këto të ardhura si ndaj të ardhurave totale të buxhetit të shtetit, ashtu edhe ndaj Produktit të Brendshëm Bruto, sikurse shihet edhe në grafikun e mëposhtëm. Kjo tregon qartazi suksesin e Reformës Administrativo-Territoriale në drejtim të mbledhjes së më shumë të ardhurave nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.


Figura 5 :Pesha specifike e të ardhurave të buxhetit vendor ndaj të ardhurave të buxhetit të shtetit dhe PBB-së



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018);

Rritja e shpenzimeve të realizuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, gjatë viteve 2015-projekt buxhet 2019, konstatohet edhe në rritjen e peshës që zënë këto shpenzime si ndaj shpenzimeve buxhetore në total, ashtu edhe ndaj Produktit të Brendshëm Bruto. Pesha specifike e shpenzimeve të buxhetit vendor ndaj buxhetit të shtetit është rritur ndjeshëm për periudhën 2016 – 2019 (9.8 përqind), krahasuar me vitin 2015, ku shpenzimet e buxhetit vendor zinin vetëm 7.7 përqind të shpenzimeve të buxhetit shtetit. Ndërkohë, siç vihet re edhe nga grafiku i mëposhtëm, për vitet 2018 - 2019, pesha specifike e buxhetit vendor ndaj Produktit të Brendshëm Bruto është rritur ndjeshëm me rreth 1 përqind më shumë se pesha që zinte në vitin 2015.

Figura 6:Pesha specifike e shpenzimeve të buxhetit vendor ndaj shpenzimeve të buxhetit të shtetit dhe PBB-së



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018);

❖ Objektivat kryesore për buxhetin vendor të vitit 2019

Efektet pozitive në buxhetin vendor të vitit 2019 do të jenë në drejtim të:

- **Rritjes së burimeve të financimit të qeverisjes vendore me rreth 5 miliardë lekë ose 11% më shumë se në vitin 2018** që sigurohet nga transfertat e pakushtëzuar dhe të ardhurat nga taksat e tarifatat vendore. Kjo rritje krijon hëpësirat e nevojshme për përmirësimin e shërbimeve publike dhe fokusim më të madh në investime kapitale;
- **Ngritjes së kadastrës fiskale** dhe implementimit në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore me qëllim taksimin sa më të drejtë, me objektiv rritjen e të ardhurave për njësitë e vetëqeverisjes vendore.
- **Rritjes së fondeve për pagat e edukatoreve të arsimit parashkollor me 9.1%** krahasuar me vitin 2018;
- **Rritjes së numrit të edukatoreve me 10% ose 438 punonjës** të cilat shkojnë në bashkitë që kanë nevoja më emergjente për edukatore e matur sipas treguesit “fëmijë për edukatore”;
- **Përmirësimin të standardit të cilësë së arsimit parashkollor: madhësia mesatare e grupeve të nxënësve të arsimit parashkollor ulet nga 18 në 15 nxënës** për edukatore (dhe rastet e madhësisë maksimale ulen nga 25 apo 26 në 18 nxënës për edukatore;
- **Harmonizimit dhe unifikimit të procedurave për hartimin, zbatimin, raportimin, monitorimin e buxheteve** të njërive të vetëqeverisjes vendore, konform standarteve ndërkombëtare;
- Në buxhetin e vitit 2019 synohet **rritja e investimeve vendore me rreth 60% krahasuar me vitin 2014**, në funksion të zhvillimit ekonomik vendor;
- **Menaxhimit më të mirë të shpenzimeve administrative** me qëllim ofrimin e më shumë shërbimeve publike cilësore me një kosto sa më të ulët. Kjo, do të arrihet nëpërmjet rritjes së peshës së shpenzimeve për investime dhe uljes së peshës që zënë shpenzimet administrative;
- **Rritjes së eficiencës në ofrimin e shërbimeve publike** në nivel vendor, duke identifikuar tregues të performancës së shërbimit të ofruar;
- **Rritjes së transparencës dhe llogaridhënies** së qeverisjes vendore në raport me komunitetin, në drejtim të monitorimit të publikimit të dokumentave buxhetorë dhe zhvillimin të seancave të vazhdueshme të konsultimit me qytetarët.

6. POLITIKAT E TAKSAVE PËR VITIN 2019

6.1 PAKETA E RE FISKALE

Paketa Fiskale 2019 synon arritjen e disa objektivave:

- Uljen e barrës tatimore për grupe të caktuara individësh si të punësuarit me nivel të mesëm pagash, investitorët e kapitalit.
- Dhënien e incentivave dhe stimujve tatimorë për industri dhe sektorë të caktuar si bujqësia, fasoni, farmaceutika etj.
- Stimulimin e politikave në transport, në funksion të mbrojtjes së ambientit.
- Rregullime të barrës fiskale në fushën e mallrave të akcizës
- Mbrojtjen e bazës së tatimit dhe interesit financiar të vendit tonë, nëpërmjet të drejtës së taksimit në shqipëri të fitimeve kapitale që rrjedhin nga pasuri, asete dhe të drejta në territorin shqiptar.
- Mbylljen e mundësive për përfitimin e stimujve fiskalë, nëpërmjet keqpërdorimit të legjisllacionit fiskal
- Implementimin në legjisllacionin tatimor shqiptar të Direktivës së BE në lidhje me transparencën fiskale dhe rregullave që duhen zbatuar për shmangien e qëllimshme të tatimeve

Në këtë kuadër, Paketa Fiskale 2019 përmban:

➤ **Ligji Nr. 92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar”, të ndryshuar.**

- Propozohet që shkalla e reduktuar 6 % të aplikohet edhe për furnizimin e shërbimit të reklamave nga media audiovizive (televizionet), me qëllim nxitjen dhe lehtësimin e investimeve në kuadër të dixhitalizimit të mediave audiovizive (televizionet).
- Shkallë e reduktuar e TVSH-së 10% propozohet për furnizimin me autobuzë elektrikë që synohet të zëvendësojnë autobuzët me naftë. Argumentat që mbështesin këtë propozim lidhen me nevojën e të ashtuquajturit “Transport i Gjelbërt”, që do të thotë çdo lloj praktike e transportit apo automjet, që është eko-miqësore dhe që nuk ka ndikim negativ në mjedis.
- Propozohet që furnizimi i makinave bujqësore, të jetë furnizim i përjashtuar jo vetëm në import (importimi i makinave bujqësore aktualisht është furnizim i përjashtuar nga TVSH-ja) por edhe brenda vendit, sipas po së njëjtës listë makinash bujqësore, të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 953/2014, “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Ky propozim bëhet me qëllim lehtësimin e kostove të investimit dhe vijimin e mbështetjes së sektorit bujqësor.
- Furnizimi i shërbimit të përpunimit të mallrave joshqiptare të destinuara për t’u rieksporuar, të kryera nga nënkontraktorët për llogari të shoqërisë së përpunimit aktiv që e ka kontraktuar, propozohet të përjashtohet nga TVSH-ja. Aktualisht ky furnizim është i tatueshëm me shkallën standarde 20 për qind, ndërkohë që më herët ka qënë i përjashtuar nga TVSH-ja.
- Propozohet që, importimi i lëndëve të para që përdoren për prodhimin e barnave, të kryera nga mbajtësit e autorizimit të prodhimit, sipas legjislacionit të fushës për barnat, të jetë furnizim i përjashtuar nga TVSH-ja. Lëndët e para, që janë me përdorim të dyfishtë nuk e përfitojnë përjashtimin nga TVSH-ja. Argumentat mbi të cilat mbështetet ky propozim kanë të bëjnë me zhvillimin e industrisë vendase të prodhimit të barnave, duke lehtësuar koston e lëndëve të para për prodhimin e tyre.

Këto ndryshime parashikohet të sjellin një efekt prej -300 (treqind) milionë lekë në të ardhurat e buxhetit të shtetit, por që parashikohet të sjellin efekte pozitive në zhvillimin e sektorëve që preken.

➤ **Ligji për Akcizat në Republikën e Shqipërisë nr. 61/2012, të ndryshuar.**

- Propozohet për vitin 2019 ndryshimi i nivelit të akcizës për produktin e duhanit të grirë, duke u rritur në masën 6000 lekë/kg. Argumentat mbi të cilat mbështetet propozimi lidhen me përafrimin/barazimin e taksimit të produkteve të kësaj kategorie me kategorinë T200 “Cigare që përmbajnë duhan” (nga 1 janari 2019 sipas kalendarit akciza do të jetë 6000 lekë/1000 copë). Gjithashtu me anë të këtij ndryshimi sigurohet përafrimi i mëtejshëm me Direktivën e BE 2011/64, e cila përcakton nivelin minimal të akcizës për duhanin e grirë të paktën 60 euro për kg. Riskedulimi i rritjes siguron një politikë të qëndrueshme taksimi sipas standardeve të BE-së. Efekti në të ardhura e buxhetit të shtetit parashikohet të jetë +140 milionë lekë.
- Niveli i akcizës për kategorinë T500 “Puro, cigarillos dhe cigare me zëvendësues duhani” propozohet të rritet në masën 6000 lekë/kg. Efekti në të ardhurat e buxhetit të shtetit parashikohet të jetë +3.8 milionë lekë.
- Propozohet heqja nga lista e mallrave të akcizës për fishekzjarrët, llambat dhe pilat/bateritë në Kategoritë F000, A100 dhe Y100, të cilat nga viti 2012 janë trajtuar si mall akcize. Ky propozim

mbështetet në nevojën për mbikëqyrje efektive të produkteve të tilla, të cilët janë lehtësisht të transportueshëm dhe ngarkesa fiskale me akcizë rrit interesin për kontrabandë. Heqja e këtyre produkteve nga lista e mallrave të akcizës do të stimulonte deklarimin e sasisë reale, duke arkëtuar më shumë të ardhura në TVSH dhe taksë doganore. Efekti në të ardhurat e buxhetit të shtetit parashikohet të jetë -40 milionë lekë.

- Shtohet kategoria T402 “Duhan me ngrohje” në kreun 2403, kodi tarifor 2403 90 90 me akcizë 6000 lekë/kg. Arsyeja për shtesën e kësaj kategorie, në listën e mallrave të akcizës është se, në tregun vendas do të tregtohet një produkt i ri, “duhan me ngrohje”. Referuar përvojave të vendeve të Bashkimit Europian, llogaritja e akcizës së këtij produkti bëhet duke u bazuar në taksimin për kg. Propozohet që taksimi me akcizën i këtij produkti si dhe llojeve të tjera të produkteve të ngjashme me të, të kategorizohen në një nënkategori të re, ku të përfshihen produkte të kreut 2403, Kategoria T402 specifikuar për kodin 2403 90 90 të NK dhe taksimi për akcizën të llogaritet 6000 lekë/kg.
- Propozohet heqja nga lista e mallrave të akcizës, të produktit “rërë bituminoze” me kod 27 14 10 00 dhe vendosjen e akcizës në masën 2 lekë/kg, për produktin “zhavorr bituminoz” me kod 27 14 90 00. Ky propozim mbështetet në rritjen e përdorimit si lëndë djegëse zëvendësuese të zhavorrit bituminoz, dhe si i tillë në zbatim të ligjit nr. 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 1, 2 dhe 3, të nenit 50, duhet t’i nënshtrohet pagesës së akcizës në të njëjtin nivel me produktin që zëvendëson”.

➤ **Ligji nr. 9981, datë 08.09.2008 “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore”, të ndryshuar.**

Propozohet unifikim i tarifës doganore në masën 10% për të gjitha kodet tetëshifrore të kategorisë 8418 të NMK “Frigoriferet, ngrirësit dhe pajisje të tjera ftohëse apo ngrirëse, elektrike apo të tjera”. Ky propozim mbështetet në faktin se çdo vit kodet doganore të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave ndryshojnë për shkak të hyrjes në treg të mallrave të reja të cilët nuk janë të klasifikuar, si e tillë procesi i korelimit të kodeve tarifore, sjell ndryshimin e kodeve dhe tarifa të ndryshme. Nga diferencimi i tarifave doganore në këto kode, vihet re se çmimi mesatar për njësi frigoriferike është i ndryshëm, duke sjellë problematika të konkurrencës së ndershme. Klasifikimi i njëjtë i tarifës doganore të këtyre 4 kodeve do të sjellë krijimin e kushteve të barabarta për të gjithë importuesit që operojnë në këtë aktivitet dhe impakt pozitiv në buxhetin e shtetit në masën 50 milionë lekë.

➤ **Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar**

- Propozohet reduktimi i normës së dividendit nga 15% në 8%. Ky propozim mbështetet mbi argumentin se aktualisht norma e tatimit mbi dividendin prej 15%, duke u kombinuar me normën e tatimit mbi fitimin korporativ 15%, prodhon një ngarkesë fiskale prej 27.75% për investitorët. Gjithashtu është propozuar që norma 8% të aplikohet edhe për shpërndarjen e dividendëve që mund të bëjë shoqëria dhe që i përkasin fitimeve të viteve para se ky ndryshim të prodhojë efekte (fitimeve të viteve 2017 e me parë). Reduktimi i normës së dividendit nga 15-8%, ul të ardhurat nga ky tatim me rreth 1 miliardë lekë në vit, por prishshmëria që të rritet numri i kompanive shpërndarëse të dividendit dhe shpërndarja e fitimeve të akumuluar nga vitet e kaluara, vlerësohet që të ketë impakt pozitiv në të ardhurat buxhetore të vitit 2019 me afërsisht 4,5 miliardë lekë.
- Propozohet ulje e ngarkesës fiskale për të punësuarit, duke e rritur fashën e të ardhurave, nga 130.000 lekë/muaj në 150.000 lekë/muaj, që tatohen me normën 13%. Nëpërmjet kësaj mase

synohet të ulet barra tatimore për rreth 15.400 punëmarrës. Ky ndryshim parashikohet të sjellë një efekt në buxhetin e shtetit prej -319 milionë lekë.

➤ **Ligji nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare”, të ndryshuar**

- Propozohet që niveli i ri i taksës që do të aplikohet mbi produktet e plastikës të jetë 35 lekë/kg, pra sa 1/3 e nivelit ekzistues (prej 100 lekë/kg). Propozohet gjithashtu të vendoset në nivelin 25 lekë/kg, taksa mbi granulatin që importohet dhe përdoret për prodhimin e mallrave plastike, përfshirë ambalazhin. Qëllimi është që të mos taksohet thjesht ambalazhi, por materiali, qoftë ambalazh, qoftë produkt tjetër plastik, pasi japin pasoja mbi ambientin në mënyrë të njëjtë. Nëpërmjet këtij ndryshimi, shfuqizojmë edhe taksën simbolike 1 lekë/kg për ambalazhet e prodhuara nga riciklimi. Në këtë mënyrë përmbushet edhe kërkesa e strukturave të BE-së, që e shihnin këtë diferencë 1:100, në kuadrin e diskriminimit të importeve. Ky ndryshim parashikohet të sjellë një efekt në të ardhurat e buxhetit të shtetit me rreth +300 milionë lekë.
- Propozohet rritja e përqindjes e rentës minerare nga 6 për qind, në 9%, për “Mineralet e kromit për eksport” pjesë e grupit të parë (I) “Mineralet metalike”, të shtojcës Nr.2 “Renta minerare sipas klasifikimit”. Ky propozim mbështetet në nevojën e ndërmarrjes së politikave që stimulojnë përpunimin e mineralit në vend dhe rritjen e vlerës së tij për eksport, si dhe dekurajimin e eksportit të mineralit krom të papërpunuar.

6.2 PËRJASHTIMET NGA TAKSAT (“TAX EXPENDITURES”)

Përrjashtimet e taksave, apo “tax expenditures” konsiderohen humbje nga të ardhurat fiskale të parashikuara në legjislacionin fiskal në fuqi, si rezultat i lehtësirave fiskale ose normave preferenciale të vendosura për kategori të caktuara taksapaguesish ose aktivitetesh. “Përrjashtimet e taksave” janë vlerësuar duke përdorur metodën “Të ardhura të munguara”. Analiza e përrjashtimeve ligjore dhe përcaktimi i benchmark-ut (përrjashtime që janë normë në të gjithë vendet) u krye me asistencë të Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Për vlerësimin dhe matjen e “përrjashtimeve nga taksat” janë marrë në konsideratë tatimet dhe taksat e mëposhtme:

- Tatimi mbi vlerën e shtuar, përkatësisht në Ligjin nr. 92/2014 “Për Tatimin mbi vlerën e shtuar” në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar.
- Tatimi mbi të ardhurat, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar.
- Akciza, përkatësisht në Ligjin nr. 61/2012 “Për Akcizën në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Janë identifikuar në total për TVSH-në, 78 përrjashtime, ku ndër këto 35 përrjashtime të veprimtarive me interes të përgjithshëm, 42 përrjashtime në import dhe 2 përrjashtime të tjera. Për TVSH-në janë llogaritur si “Tax Expenditure”, të gjitha furnizimet e përrjashtuara, duke supozuar që të tatohen me normë standarde 20%. Efekti i munguar do të jetë 73 miliardë lekë.

Bazuar në Ligjin e të Ardhurave Personale janë llogaritur si “Tax Expenditure”:

- Tatim Fitimi: me supozimin që të mos paguajnë 5% por 15% mbi fitimin e tatueshëm, të gjithë subjektet me xhiro vjetore 5-8 milionë lekë. Efekti i munguar do të jetë 0.7 miliardë lekë.
- Të ardhurat personale mbi pagat: me supozimin që të punësuarit me fashën e të ardhurave nga 30.000 lekë/muaj në 130.000 lekë/muaj, të taten me normë 15% dhe jo 13%, siç është aktualisht. Efekti i munguar do të jetë 1.6 miliardë lekë.

Në ligjin mbi akcizën, janë identifikuar 5 përjashtime nga akciza, me vlerën 0.9 miliardë lekë.

Tabela e mëposhtme pasqyron një përmbledhje të përjashtimeve të taksave, si përqindje e Prodhimit të Brendshëm Bruto, bazuar në të dhënat e marra nga Administrata Tatimore dhe Administrata Doganore për vitin 2017.

Tabela 8 (në milionë lekë)

LLOJI TAKSËS	TAX EXPENDITURE (në milionë lekë)	Në % PBB
TVSH	73,316	4.72%
TAP (15%)	1,647	0.11%
TTHF* (nëse 15%)	693	0.04%
Akciza	881	0.06%
Totali	76,536	4.9%
GDP*	1,552,868	

Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)*

7. REFORMAT NDËRSEKTORIALE NË BUXHETIN 2019

7.1 REFORMA NË ADMINISTRATËN PUBLIKE

Reforma në administratën publike në Shqipëri vijon të jetë një proces i rëndësishëm dhe kyç, i lidhur ngushtë me procesin e integritit në Bashkimin Evropian (BE) si dhe një nga parakushtet kryesore për një qeverisje transparente dhe efektive. Një administratë publike funksionale tregon aftësinë e qeverisë për t'ju përgjigjur nevojës për përmirësimin e shërbimeve publike të ofruara për qytetarët dhe biznesin, rritjen e transparencës dhe përgjegjësisë dhe për të ndihmuar zhvillimin e mëtejshëm të vendit. Mbi rreth tre vjet pas fillimit të zbatimit të strategjisë në Prill 2015, mbi 80% e nën-aktiviteteve të parashikuara në Strategji janë nën zbatim.

Arritjet e vitit 2018:

- Në lidhje me finalizimin e Planit të Ri të Aktiviteteve 2018-2020 të SNRAP; Strategjia e Reformës në Administratën Publike dhe realizimi i objektivave të saj me arritjet dhe sfidat e hasura gjatë zbatimit ka patur impakt pozitiv dhe tregues real e konkret. Gjatë vitit 2018 u zhvillua një punë intensive me të gjithë institucionet e përfshira në Strategjinë e Reformës në Administratën Publike për hartimin e draft Planit të Ri të Aktiviteteve 2018-2020. Për finalizimin e këtij Draft Plani u organizuan më tej nën udhëheqjen e Zëvendëskryeministrit në nivel politik dhe nën udhëheqjen e Departamentit të Administratës Publike në nivel teknik, konsultime publike me shoqërinë civile

dhe me partnerët ndërkombëtarë nëpërmjet zhvillimit të tryezave të rrumbullakëta. Plani i Ri i Aktiviteteve 2018-2020, i cili parashikon zbatimin e 34 aktiviteteve bazë dhe 95 nën-aktiviteteve, u miratua me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 447 datë 26.07.2018 dhe është publikuar në faqen zyrtare të DAP. Ndërkohë është drejt përfundimit raporti i parë i monitorimit sipas këtij plani plani të ri aktiviteteve.

- Në lidhje me shkallën e zbatimit të planit vjetor të rekrutimit në përputhje me ligjin për shërbimin civil. DAP ka vijuar përpjekjet për të përmirësuar më tej procesin e rekrutimit dhe plotësimin e nevojave institucionale duke ndërmarrë një sërë masash në drejtim të rritjes së objektivitetit në procesin e testimit, pasurimit dhe përmirësimit cilësor të bankës së pyetjeve për proceset e rekrutimit në shërbimin civil, përgatitjes së një sërë materialesh orientuese, dhe bashkëpunimin me institucionet e arsimit të lartë. Deri më tani nga 1073 vende të lira të përfshira në Planin Vjetor të Rekrutimit për vitin 2018, janë publikuar 885 vende të lira ose 82.4% të totalit.
- Në lidhje me zhvillimin e HRMIS dhe shtrirjen e tij në të gjithë institucionet e administratës publike, pjesë e shërbimit civil, institucioneve të pavarura dhe njësisve të qeverisjes vendore, sistemi HRMIS përmban aktualisht 69500 pozicione pune dhe dosjet personale për mbi 50000 punonjës. Deri në shtator të 2018 janë gjeneruar me sukses bordero nga 42 institucione dhe bazuar në planin e punës është parashikuar se deri në fund të vitit 2018 do të gjenerohen bordero për 70 institucione të administratës publike.
- Në lidhje me zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë: rezulton se deri në Shtator të vitin 2018 janë zbatuar 178 vendime të formës së prerë nga totali i 295 vendimeve gjyqësore për tu zbatuar (që nga fundi i viti 2013), pra gati 60.3 % e vendimeve gjyqësore janë zbatuar duke shënuar një rritje të indikatorit të dedikuar ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të Budget Support.
- Në lidhje me uljen e numrit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë që konfirmojnë lirimin e paligjshëm të nëpunësve civilë, konstatohet në shifra konkrete ulje e vazhdueshme e numrit të largimeve nga shërbimi civil për shkak të masave disiplinore. Kështu në vitin 2017 ka patur 44 vendime të formës së prerë me objekt “largim nga shërbimi civil” ndërsa në periudhën Janar-Tetor 2018 rezultojnë 29 të tilla. Kjo vjen edhe si pasojë e njohjes së legjislacionit të shërbimit civil dhe punës së vazhdueshme të përfaqësuesve të DAP për ndërgjegjësimin e anëtarëve të komisioneve për respektimin e të gjithë elementëve të procedurës formale të këtij procesi.
- Në lidhje me përfundimin me sukses të projektit Young Civil Servant Scholarship Scheme; Projekti pilot “Skema e Bursave për Nëpunësit e Rinj Civilë” u financua nga Bashkimi Evropian dhe u zbatua nga ENA në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) dhe Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, në kuadrin e përgatitjeve të vendit për hapjen e negociatave të pranimit me Bashkimin Evropian. Qëllimi i këtij projekti ishte rritja e performancës dhe kapaciteteve të administratës publike shqiptare, përmes rritjes së përgjegjësisë së punonjësve publikë në shërbim të qytetarëve. Nëpunësit civilë, pjesëmarrës në këtë projekt u zgjodhën nga fusha kyçe dhe të rëndësishme si politikat publike; monitorimi dhe zbatimi i strategjive; hartimi i legjislacionit; integrimi evropian, planifikimi i buxhetit dhe menaxhimi financiar.
- Në lidhje me përfundimin me sukses të projektit “Reforma e administratës publike në Shqipëri: Mbështetje për komunikimin dhe vizibilitetin” si pjesë e asistencës teknike të mbështetjes buxhetore; Në kuadër të këtij projekti u realizuan disa produkte me qëllim rritjen e vizibilitetit të Reformës në Administratën Publike, në të cilat përfshihet një video, pjesë e një serie dokumentari për Reformën e Administratës Publike, ku shpjegohet informatizimi i procesit të aplikimeve për pozicionet në shërbimin civil, shpallja e vendeve vakante dhe procedura e rekrutimit online, procedura e pranimit të kandidatëve etj.; një spot transmetuar në radio kombëtare në formën e një

thirrje për çdo të ri që dëshiron të bëhet pjesë e administratës publike; U përfundua anketa e cila përfshin një sërë pyetjesh në lidhje me Reformën në Administratën Publike, digjitalizimin, shërbimin civil, anti-korrupsionin etj, dhe përceptimin e qytetarëve ndaj tyre. Gjithashtu u përgatitën dhe u shpëndanë në të gjitha bashkitë e vendit materiale në formën e broshurave, fletëpalosjeve, dhe posterave dedikuar rritjes së informacionit mbi reformën në administratën publike si dhe për mundësitë e punësimit në shërbimin civil.

Prioritetet për vitin 2019:

1. Zbatimi i Planit të Ri të Veprimit të SNRAP dhe aktiviteteve për periudhën 2018-2020 synon fuqizimin e strukturave të administratës publike me qëllim përmirësimin e ofrimit të shërbimit ndaj publikut, nëpërmjet:

- Rishikimit funksional dhe organizimit të brendshëm në institucionet e administratës shtetërore përmes pilotimit të metodologjisë së SIGMA-s për ristrukturimin në 3 sisteme ministrore (institucionet e varësisë);
- Forcimit të kapaciteteve të DAP dhe njësisive të burimeve njerëzore në institucionet e administratës shtetërore për të vijuar me reformën në shërbimin civil;
- Përmirësimin të mëtejshëm të procesit të rekrutimit nëpërmjet krijimit të mekanizmave të feedback-ut nga publiku nëpërmjet vlerësimeve ad-hoc si dhe ndërlidhja, efekti, adresimi i këtyre çështjeve.

2. Zbatimi i projektit IPA 2014 “Zbatimi i reformës së shërbimit civil në administratën publike”, i cili ka nisur më datë 9 tetor 2018 dhe do të ketë një kohëzgjatje prej 30 muajsh. Projekti ka për qëllim forcimin e mëtejshëm të qeverisjes së sektorit publik dhe efikasitetin e Administratës Publike Shqiptare duke realizuar objektivat e mëposhtëm:

- Forcimi i kapacitetit të menaxhimit dhe mbikëqyrjes së DAP-it në zbatimin e reformës së shërbimit civil dhe të pagave.
- Rritja e kapaciteteve në përdorimin e mjeteve të ndryshme për zbatimin e procesit të biznesit.
- Forcimi i kapaciteteve të ASPA-s në menaxhimin dhe realizimin e trajnimeve cilësore.

Kontraktori do të asistojë qeverinë shqiptare në arritjen e dy rezultateve të rëndësishme:

- Një administratë publike bazuar fort në meritë, profesionalizëm, e paanshme dhe e pavarur.
- Kontrolli dhe mbikëqyrja e mekanizmave mbi administratën publike për të garantuar të drejtat e qytetarëve dhe zgjerimin e informacionit.

3. Vijimin e zbatimit të Programit për Administratën që Duam, një program i qeverisë shqiptare për energjizimin e administratës publike nëpërmjet orientimit të përpjekjeve të administratës drejt prioriteteve dhe vizionit qeverisës, rritjes së aftësive dhe kapaciteteve profesionale të nëpunësve publikë, motivimit dhe angazhimit të tyre si dhe rritjes së ndërveprimit dhe bashkëpunimit ndër-institucional. Ky program është në linjë me përpjekjet e përbashkëta drejt Reformës së Administratës Publike dhe ka si synim final përmirësimin e performancës së administratës publike dhe përmirësimin e nivelit të ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarëve, nëpërmjet koordnimit dhe integritit të aktiviteteve nën katër komponentët e tij:

- *Komponenti 1: Orientimi i Administratës* (Orientimi i stafit të administratës drejt objektivave strategjike dhe prioriteteve të programit qeverisës, prioriteve të anëtarësimit në Bashkimin Evropian si dhe drejt vizionit, misionit e objektivave të institucionit ku bëjnë pjesë);

- *Komponenti 2: Aftësimi i Administratës* (Aftësimi i administratës me njohuri, dije dhe kompetencat e duhura për të bërë të mundur përmbushjen e kërkesave të pozicionit të punës)
- *Komponenti 3: Motivimi i Administratës* (Garantimi i një administrate të motivuar, të angazhuar, që përfshihet dhe jep rezultate në punë)
- *Komponenti 4: Ndërveprimi i Administratës* (Rritja e nivelit të komunikimit, të ndërveprimit dhe të frymës së identitetit brenda mjedisit institucional, në nivel ndërinstitucional si dhe ndërveprimi me publikun e gjerë)

4. Puna për zhvillimin e Sistemit Informatik të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (SMIBNJ/HRMIS) dhe finalizimi i bashkërendimit midis HRMIS dhe sistemit të thesarit. Me rritjen e planifikuar të user-ave dhe rritjes së veprimtarisë së tyre në sistemin HRMIS, për vitin 2018-2019, në lidhje me hedhje të dhënash, gjenerim borderoje dhe si rrjedhojë logo auditi, back up bazë të dhënash synohet shtimi i kapaciteteve procesuese në një infrastrukturë serverash të rinj ku do të vendoset sistemi dhe shtimi i kapaciteteve sa i takon infrastrukturës së ruajtjes dytësore të të dhënave (back up).

5. Projekti nën IPA 2015 “Profesionistë të rinj për Shqipërinë” do të jetë në formën e një granti, ku objektivi kryesor i zbatimit të këtij projekti do të jetë rritja e kapacitetit dhe ekspertizës së nëpunësve civilë në sektorët kryesorë në përputhje me prioritetet e Qeverisë dhe me kërkesat e anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Nëpërmjet këtij projekti është parashikuar realizimi i dy objektivave/rezultateve specifike:

- Përmirësimi i kapacitetit profesional dhe ekspertizës së nëpunësve civilë në sektorët kyç të administratës publike shqiptare, duke u ofruar nëpunësve të konfirmuar civilë mundësinë për të ndërmarrë trajnime praktike dhe internshipe në shkollat më prestigjioze europiane, si dhe në administratën publike europiane.
- Zhvillimi i mekanizmave të qëndrueshëm që synojnë mbështetjen e zhvillimit të karrierës së nëpunësve të rinj civilë të aftë, duke u mundësuar atyre që të kontribuojnë dukshëm në efikasitetin dhe prurjen e risive në administratën publike shqiptare dhe në reformat kryesore.

7.2 REFORMA E MENAXHIMIT TË FINANCAVE PUBLIKE

Strategjia e “Menaxhimit të Financave Publike (MFP) për periudhën 2014-2020” është një dokument, i cili reflekton angazhimin e Qeverisë Shqiptare ndaj qytetarëve për zbatimin e një sërë reformave të rëndësishme për mirëmenaxhimin e financave publike. Gjatë gjysmë së dytë të vitit 2018 u ndërmor rishikimi dhe vlerësimi afatmesëm i Strategjisë, për përcaktimin e prioriteteve për periudhën 2018-2022.

Arritjet për vitin 2018

Gjatë vitit 2018, Qeveria ka bërë progres për përmbushjen e kësaj reforme, ku arritjet kryesore veçohen si më poshtë:

- Raporti vjetor i zbatimit të buxhetit për vitin 2017, i publikuar në qershor 2018, dëshmon se rregullat fiskale të prezantuara në Ligjin Organik të Buxhetit, të ndryshuar janë respektuar, duke përfshirë

reduktimin gradual të borxhit publik dhe parashikimin e PBB-së nominale nga Qeveria në përputhje me atë të FMN-së.

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka avancuar me përgatitjen e draft-deklaratës së risqeve fiskale, që pritet të publikohet si pjesë e dokumentacionit të buxhetit 2019.
- INSTAT ka përpiluar dhe transmetuar në EUROSTAT, deri në korrik 2018 u dërguan tre tabela të të dhënave të SFQ-së sipas kërkesave të Standarteve Europiane të Kontabilitetit 2010, duke vijuar me përmirësimin e cilësisë dhe sasisë së të dhënave të nevojshme të Statistikave Financiare Qeveritare (SFQ) dhe Sistemit të Llogarive Europiane (ESA) 2010.
- Komiteti i Planifikimit Strategjik ka përgatitur një listë të re të projekteve prioritare për tu përfshirë në Paketën Kombëtare të Projekteve Strategjike për periudhën 2018-2019.
- Në shkurt 2018 u miratua udhëzimi i ri standard për përgatitjen e buxhetit. Për përgatitjen e PBA 2019-2021 të gjitha ministrinë e linjës dhe institucionet qendrore kanë përgatitur kërkesa buxhetore sipas kërkesave të udhëzimit të ri.
- Në 29 mars 2018, Këshilli i Ministrave miratoi procedurat e menaxhimit të investimeve publike.
- MFE në vitin 2018 ka miratuar mjetin e ri të Planifikimit Financiar për përgatitjen e PBA-së për njësitë vendore dhe Manualin për Mjetin e Planifikimit Financiar.
- MFE ka përgatitur dhe miratuar dy udhëzime të reja për monitorimin e buxhetit dhe përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm të NJQV-ve, me qëllim që të sigurojnë që procedurat dhe raportet të jenë të unifikuara për të gjitha NJQV-të në periudhën afatmesme.
- Gjatë vitit 2018, Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me Agjencinë Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (SIDA) ka bërë progres në realizimin e projektit për ngritjen e kadastres fiskale. Janë realizuar të gjitha ndryshimet ligjore dhe vendimet e Këshillit të Ministrave lidhur me zbatimin e tatimit në pronë si: VKM nr.132, datë 07.03.2018 "Për metodologjinë e tatimit në pronë; VKM nr.171, datë 28.03.2018 'Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimit në Pronë'; VKM nr. 273, datë 16.05.2018 "Mbi Themelimin e Regjistrimit Qendror të të Dhënave të Tatimit në Pronë Lokale, Ndërtesa; VKM nr.235, datë 02.05.2018 'Për miratimin në parim të Marrëveshjes së Kontributimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (marrës), dhe SIDA, për mbështetjen e projektit 'Zbatimi i tatimit në pronë në vlerën e bazuar në treg', versioni 0.93, i datës 20 shkurt 2018.
- Bazuar në ligjin "Për Prokurimet Publike", i ndryshuar në 2017, gjatë vitit 2018 u realizua emërimi i antarëve KPP-së nga Parlamenti pas një procedure konkurruese përzgjedhëse.
- MFE ka vënë në dispozicion në faqen e saj të internetit aplikacionin BOOST. Iniciativa e BOOST lehtëson qasjen e publikut në të dhënat e buxhetit dhe promovon përdorimin efektiv të të dhënave për proceset e përmirësuara të vendimmarrjes, transparencën dhe llogaridhënien.
- Gjatë vitit 2018, është ngritur një funksion i veçantë i kontabilitetit, brenda Drejtorisë së Harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, përgjegjës për mbikëqyrjen e kontabilitetit dhe kalimin në Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik.
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka miratuar Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", të cilat synojnë të krijojnë një bazë rregullative për përgatitjen, prezantimin dhe raportimin e pasqyrave vjetore financiare nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, bazuar në Parimet e

Përgjithshme të Kontabilitetit të Sektorit Publik të pranuar, si një masë kalimtare që do të bëhet deri në modifikimin përfundimtar të Parimeve të Kontabilitetit të Sektorit Publik të pranuar përgjithësisht (kuadri rregullator i fushës), në mënyrë që ato të jenë në përputhje me seksionet e përzgjedhura për zbatimin e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP).

- Bazuar në detyrimin e NJQH / MFK për të monitoruar në mënyrë sistematike sistemin e kontrollit të brendshëm në të gjitha njësitë publike, monitorimi në terren është kryer në 20 institucione (ministri, bashki dhe institucione të pavarura), ku në bazë të gjetjeve NjQH / MFK janë dhënë rekomandimet për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. NjQH / MFK është duke kryer zbatimin e këtij sistemi në 4 institucione të përzgjedhura pilote (Ministria e Brendshme, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia e Vlorës dhe Rrugor Shqiptar Autoriteti).
- Gjatë vitit 2018, janë planifikuar 10 vlerësime të jashtme të cilësisë në tetë ministri të linjës dhe dy bashki. Deri në shtator u realizuan shtatë vlerësime të jashtme të cilësisë në njësitë e AB.
- Lidhur me auditimin e brendshëm, procesi i certifikimit të auditorëve të brendshëm në sektorin publik për periudhën 2018 - 2019 është miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 162, datë 29.05.2018.
- Auditimet financiare të llogarive financiare të institucioneve të veçanta buxhetore janë rritur në vitin 2018 në 28 përkundërt 15 në 2017. Kapaciteti i auditimeve të jashtme është rritur nëpërmjet binjakëzimit dhe trajnimit, duke çuar gradualisht në një vlerësim më profesional të financave publike, prokurimit dhe asetëve publike, duke u fokusuar më shumë në çështjet e qeverisjes sesa në pajtueshmërinë formale.

Prioritetet për vitin 2019

Për vitin 2019, synohet progres i mëtijshëm në realizimin e objektivave të cilat janë pjesë e shtyllave të strategjisë si:

- Të nisë zbatimin e Strategjisë së Rishikuar të MFP-së dhe Planit të Veprimit 2018-2022.
- Të bëhen funksional sistemet AFMIS dhe IPSIS dhe të realizohet integrimi i këtyre sistemeve dhe EAMIS. Trajnim i stafit që do të përdorë sistemet.
- Të bëhet funksional sistemi për kadastrën fiskale. Ky sistem do të shërbejë për të përmirësuar administrimin dhe performancën e taksimit të pasurisë si dhe krijimin e bazës së nevojshme për të kaluar në një metodologji moderne llogaritje të taksës kalimin në sistemin e taksimit ku baza e taksës të jetë vlera e pronës.
- Forcimi i kapaciteteve të Institutit të Statistikave në fushën e llogarive kombëtare të qeverisë duke synuar përmirësimin e cilësisë dhe sasisë së të dhënave të nevojshme të Statistikave Financiare Qeveritare (SFQ) dhe transmetimin e tabelave të reja me të dhënat e SFQ-së në EUROSTAT sipas kërkesave të Standardeve Europiane të Kontabilitetit 2010.
- Zbatimi i udhëzimit të ri standard për përgatitjen e PBA-së duke synuar forcimin e rolit udhëheqës të dokumentit të PBA-së dhe cilësinë e procesit strategjik të përgatitjes së buxhetit; përmirësimin dhe asistimin në përgatitjen e metodologjive të PBA-së dhe Buxhetit Vjetor; si dhe pilotimin e metodologjive të avancuara të PBA-së dhe të buxhetimit në Ministrinë e Linjës të përzgjedhura; Asistimi i Ministrive të Linjës në zbatimin e qasjes së rishikuar të përgatitjes së buxhetit gjatë ciklit të përgatitjes së buxhetit.

- Paraqitja e pasqyrave financiare në përputhje me standardet e përzgjedhura të IPSAS.
- Zhvillimi i një kualifikimi të qëndrueshëm të kontabilitetit në sektorin publik në përputhje me praktikën e mira ndërkombëtare si dhe përmirësimin e mirëkuptimit dhe zbatimit të standardeve përkatëse të kontabilitetit nga praktikuesit dhe auditorët e sektorit publik.
- Rritja e kapaciteteve të inspektorëve të jashtëm nëpërmjet zhvillimit të vazhdueshëm profesional.
- Përgatitja e një dokumenti gjithëpërfshirës strategjik mbi politikën e kontrollit të brendshëm duke u fokusuar në zbatimin e një sistemi efikas të llogaridhënies së menaxhimit në njësitë publike si dhe përgatitja e një udhëzimi specifik për delegimin e detyrave të menaxherëve në njësitë e qeverisjes së përgjithshme.
- Rritja e bashkëpunimit të KLSH-së përmes Memorandumit të Mirëkuptimit me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me qëllim të rritjes së shkallës së zbatimit të rekomandimeve të auditimit.

8. RREZIQET FISKALE DHE MASAT MBROJTËSE

Me qëllim ndjekjen e performancës të zbatimit të buxhetit të shtetit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë me mbështetjen e FMN dhe BB që prej vitit 2017 është duke monitoruar rreziqet që shoqërojnë zbatimin e tij. Ky proces ka për qëllim që, në bazë të analizave të thelluara të rekomandojë zbutjen dhe/apo parandalimin në kohë të rreziqeve fiskale, pasuar nga një vendimarrje koherente.

Rreziqet fiskale janë faktorë që mund të shkaktojnë devijim nga parashikimet fiskale dhe buxhetore gjatë ciklit të buxhetit, si rrjedhojë e disa ngjarjeve të paparashikuara. Rreziqet mund të lindin si pasojë e supozimeve dhe zhvillimeve makroekonomike, vendimeve *ad-hoc* mbi politikën fiskale dhe/ose materializimin e detyrimeve kontingjente.

Vlerësimi i probabilitetit dhe ndikimit të rreziqeve fiskale kryhet në bazë të analizave të thelluara dhe parashikimeve në kuadër të Buxhetit Afatmesëm. Përkatësisht vlerësohen dy kategori rreziqesh:

- “*Explicite*”, apo risqet të cilat kanë lidhje me supozimet dhe zhvillimet makroekonomike, të ardhurat e qeverisë, shpenzimet dhe menaxhimi i borxhit, etj.
- “*Implicite*”, apo detyrimet kontingjente, PPP-të, ato të vetëqeverisjes vendore, ndërmarrjet publike me kapital shtetëror, risqe të tjera si vendime gjyqësore, fatkeqësi natyrore dhe sektori financiar apo risqet afatgjata.

Tabela 9– Matrica e rrezikut

Lloi i rrezikut	Skenarët e mundshëm
Risqet dhe detyrimet <u>eksplite</u>	
Goditje Makroekonomike	Zhvillime makroekonomike të paparashikuara, që mund të ndryshojnë perspektivën e rritjes ekonomike dhe pozicionin fiskal
Parashikimi i të ardhurave	Mosrealizimi i të ardhurave, që mund të sjellë përkeqësimin e bilancit fiskal
Shpenzime të paplanifikuara	Detyrime ligjore ose presione politike, që mund të sjellin rishpërndarje të shpenzimeve

Borxhi publik	Zhvillime të papritura të tregut, ndryshime në normën e interesit ose në kursin e këmbimit, që mund të rrisin nivelin e borxhit publik
Risqet <u>implicite</u> dhe detyrimet <u>kontigjente</u>	
Pagesat për PPP	Pagesat vjetore për PPP-të, mund të tejkalojnë nivelin e lejuar ligjor prej 5% të të ardhurave tatimore faktike të vitit paraardhës
Vështirësia financiare e Ndërmarrjeve Shtetërore (NSH)	Qeverisë mund t'i duhet të ndërhyjë për të mbështur financiarisht NSH-të
Risqe të tjera	Vendime gjyqësore, arbitrazhe ndërkombëtare, fatkeqësi natyrore, etj, që mund të sjellin kosto buxhetore shtesë në buxhetin e shtetit

Më poshtë jepen vlerësimet më të fundit të rreziqeve, aktualisht nën monitorim nga MFE:

Nga pikëpamja Makroekonomike:

Risku i rritjes ekonomike

Ky risk ka të bëjë me nivelin e realizimit të rritjes makroekonomike, vecanërisht asaj nominale. Ndonëse projeksioni për rritjen ekonomike, e vecanërisht për rritjen nominale të PBB-së (variabël kyç në programimin e buxhetit) konsiderohet realist, pasi tashmë është i ankoruar në mënyrë ligjore me projeksionet respektive të FMN-së (Ligji Organik i Buxhetit), sërisht ekziston njëfarë risku që treguesi faktik i rritjes ekonomike reale dhe nominale të rezultojë në më poshtë se sa ky projeksion. Në një rast të materializimit të një risku të tillë, implikimet e mundshme do të ishte një ngadalësim i konsolidimit fiskal ose dhe përkeqësim i raportit të borxhit publik ndaj PBB-së. Kjo mund të shoqërohet me rritjen e kostos të shërbimit të borxhit publik.

Në projektbuxhetin 2019, goditjet eventuale në anën e rritjes ekonomike, do të përballohen/mbulohen (në rast nevojë) përmes kontigjencave dhe rialokimeve të mundshme mes zërave, për të garantuar **ruajtjen e nivelit të parashikuar të treguesve të konsoliduar** për vitin 2019.

Risqet Fiskale në krahun e të Ardhurave

Në krahun e të ardhurave buxhetore risqet fiskale për vitin 2019 konsistojnë në:

- Rritja jo sipas parashikimeve e çmimit Brent të naftës bruto. Në planifikimin e të ardhurave, është vlerësuar kompensimi i ndonjë oshilacioni të mundshëm të çmimeve, nëpërmjet disiplinimit maksimal të rasteve të përjashtimeve dhe rimbursimeve përtej normave ligjore dhe parashikimeve.
- Importi i cigareve nuk rritet sipas parashikimeve (200 ton) me një efekt në të ardhura nga TVSH, Akciza dhe Taksa Doganore prej 1.8 miliardë lekë, bazuar në performancën e vitit 2018. Ky parashikim mund të mos realizohet në 100% të tij dhe mund të ketë riskun e rritjes së importit të cigareve me 100 ton dhe jo me 200 ton sa është parashikuar, me një efekt negativ rreth 0.8 miliardë lekë.
- Është parashikuar rritje e importit dhe prodhimit vendas të karburantit me 4% bazuar në performancën e vitit 2018. Në rast se nuk verifikohet kjo rritje mund të shkojë në 3% me një efekt negativ në të ardhurat me -0.4 miliardë lekë.

- Mosrealizimi në masën e projektuar i të ardhurave nga tatimi mbi dividendin dhe që lidhet me incentivimin e shpërndarjes së fitimeve të mbartura nga vitet e kaluara. Vlerësojmë një risk për rreth 1 miliardë lekë.

Tabela 10

RISQET	Efektet negative në të ardhurat				Total
	Akcizë	Taksë Doganore	TVSH	TAP	
Rritja e cmimeve Brent jo 28% sipas parashikimit por 18%			1,407		1,407
Rritja e karburantit (import+prodhim vendi) jo 4% sipas ecurisë 2018 por 3%	229		138		367
Rritja e importit të cigareve jo me 200 ton sipas parashikimit por +100 ton	570	22	167		759
Mosrealimi i shpërndarjes së dividendit të viteve të kaluar				1,000	1000
Total	799	22	1,712	1,000	3,533

Si në rastin e goditjeve makroekonomike dhe në rastin e mos-realizimit të të ardhurave kontigjencat dhe rishikimet e mundshme të shpenzimeve lejojnë mundësinë e ruajtjes të nivelit të deficitit.

Risku i normave të interesit

Projeksionet aktuale lidhur me shpenzimet për interesa në buxhet, vlerësohen realiste dhe me risqe të balancuara. Gjithashtu, tashmë edhe si detyrim ligjor i LOB, duke nisur nga viti 2017 në buxhetin e shtetit janë programuar kontigjenca të veçanta me qëllim absorbimin deri në një farë mase të një rasti potencial të rritjes së normave të interesave dhe shpenzimeve respektive. Niveli i këtij fondi kontigjent për vitin 2019 është në masën 4 miliardë lekë, aq sa ka qenë alokuar respektivisht edhe në vitin 2017 e 2018.

Megjithatë, sërish ekziston risku i një rritje më të shpejtë të normave të interesit. Kjo mund të vinte nga goditje të forta negative qoftë prej amientit të jashtëm ekonomik, ashtu edhe në atë të brendshëm ose kombimin i të dyjave. Në rast të materializimit të një risku të tillë, pra nëse rritja e normave të interesit do të ishte mjaft e fortë dhe nuk do të mbulohej nga kontigjencat e parashikuara aktualisht në buxhet, atëherë kjo do të krijonte presione negative në deficitin fiskal, borxhin publik e rrjedhimisht në qëndrueshmërinë e financave publike. Kjo do të kërkonte masa korrektuese për të minimizuar efektet negative zinxhir që inicohen dhe për të rivënë nën kontroll parametrat e financave publike si dhe parametrat e tjerë të stabilitetit makroekonomik të vendit.

Nisur nga kjo, referuar goditjeve të mundshme në zërin interesave, **theksojmë** se projektbuxheti 2019 ka parashikuar nivelin e duhur të rezervave për të garantuar fleksibilitetin e nevojshëm për **përballimin pa devijime të konsiderueshme të nivelit të parashikuar të parametrave kryesorë**.

Koncesionet dhe PPP-të:

Ministria e Financave vlerëson dhe miraton paraprakisht të gjitha projektet koncesionare dhe të partneritetit publik privat (PPP), si edhe çdo ndryshim të tyre, nga pikëpamja e implikimeve individuale apo në grup, për shpenzimet buxhetore, deficitin buxhetor, qëndrueshmërinë e borxhit publik dhe detyrimet kontingjente eventuale. Shuma e përgjithshme e pagesave vjetore neto, që kryhen nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të cilat rezultojnë nga kontrata koncesionare apo partneriteti publik privat (PPP), si rregull, nuk duhet të tejkalojnë kufirin prej 5 për qind të të ardhurave tatimore faktike të vitit

paraardhës buxhetor. Në rast tejkalimi të këtij kufiri, Këshilli i Ministrave merr masa korrektuese në krahun e të ardhurave buxhetore, të nevojshme dhe të mjaftueshme, për t'u rikthyer brenda kufirit të lejuar, gjatë dy viteve të ardhshme buxhetore.

Aktualisht, janë aktive 11 kontrata koncesionare apo partneriteti publik privat (PPP), ndërkohë që në fund të vitit 2018 si dhe përgjatë vitit 2019 pritet të nisin dhe 4 kontrata të reja nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, sipas Tabelës së mëposhtme:

Tabela 11: Koncesionet/PPP aktive me mbështetje financiare nga buxheti i shtetit

Autoriteti Kontraktor	Nr.	Emertimi i Kontrates PPP	Viti i fillimit	Viti i perfundimit	Programi	Lloji i shpenzimit	në mijë Lekë			
							2018	2019	2020	2021
							9 mujori Fakt	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	1	Ndërtimi, operimi dhe transferimi e inceneratorit për përpunimin e mbetjeve urbane të Bashkisë së Elbasanit	2015	2021	06220	Investime	405,441	661,500	661,500	661,500
	2	Ndërtimi, operimi dhe transferimi e inceneratorit për përpunimin e mbetjeve urbane të Bashkisë Fier	2016	2023	06220	Investime	564,578	752,772	752,772	752,772
	3	Ndërtimi, Operimi dhe Transferimi (BOT) HEC mbi lumin Devoll, rimbursimi i ndërtimit të rrugëve zëvendësuese	2015	2019	04320	Investime	1,355,108	1,584,406	0	0
	4	Ndërtimi dhe Operimi i Rruges së Arbrit	2018	2030	04520	Investime	0	2,600,000	2,600,000	2,600,000
	5	Ndërtim, Operim dhe Mirëmbajtje e Rruges Milot-Morinë	2017	2047	04520	Investime	27,780	681,101	899,160	899,160
	6	Ndërtimi dhe Operimi i Rruges Thumane-Vore*	2018	2030	04520	Investime	0	0	2,445,408	2,520,000
	7	Ndërtimi dhe Operimi i Porti Jahteve Oriukum - Dukat*	2018	2030	04520	Investime	0	0	0	354,984
	8	Ndërtimi dhe Operimi i Rruges Milot - Ballëdren*	2018	2032	04520	Investime	0	0	0	0
Ministria e Financave dhe Ekonomisë	1	Shërbimi i Skanimit në Dogana	2013	2030	01150	Korrente	1,148,843	1,624,419	1,710,582	1,761,582
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	1	Konçesioni/PPP Kontrolli baze i popullsisë 35-70 vjeç (check up)	2015	2024	07220	Korrente	657,062	876,090	876,090	876,090
	2	Konçesioni/PPP (Ofrimi i setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale, material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimi i mbetjeve biologjike dhe dezinfektimi i sallave kirurgjikale)	2015	2024	07330	Korrente	1,162,302	1,607,109	1,655,322	1,704,982
	3	Konçesioni/PPP (Ofrimi i shërbimit të dializës në 5 spitale rajonale)	2016	2025	07330	Korrente	437,798	646,637	688,581	734,021
	4	Ofrimi i Shërbimeve laboratorike spitalore*	2019	2028	07330	Korrente	0	886,000	886,000	886,000
Bashkia Tiranë / Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	1	Ndërtimi i Shkollave të Arsimit Parauniversitar në Bashkinë e Tiranës	2017	2024	09120	Investime	0	0	1,018,303	1,528,336
Ministria e Infrastruktures dhe Energjisë / Bashkia Tiranë	1	Inceneratori i Tiranës	2017	2046	06220	Korrente	626,551	756,828	756,828	894,433
TOTALI							6,385,463	12,676,862	14,950,546	16,173,859
Totali i të Ardhurave Tatimore i parashikuar per periudhen 2018-2020							419,402,377	447,136,713	478,911,309	...
Respektimi i Rregullit Fiskal (përpjesa e pagesave të PPP ndaj totalit të të ardhurave tatimore të vitit paraardhës buxhetor me pak se 5%)							...	3.0%	3.3%	3.4%

*Kërkesa për mbështetje financiare për këto projekte është miratuar nga MoFE dhe pritet që të lidhen kontratat përkatëse gjatë fundit të 2018 dhe përgjatë vitit 2019

Për sa i përket respektimit të nenit 4/2 të ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor ku përcaktohet se "...shuma e përgjithshme e pagesave vjetore neto, që kryhen nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të cilat rezultojnë nga kontrata koncesionare apo partneriteti publik privat (PPP), si rregull, nuk duhet të tejkalojnë kufirin prej 5 për qind të të ardhurave tatimore faktike të vitit paraardhës buxhetor.", për vitin 2019 vërehet se:

- Për vitin 2019, **kufiri i lejuar** i pagesave neto për kontratat koncesionare/PPP, prej 5% i të ardhurave tatimore faktike të vitit 2018, është rreth **20.97 miliardë lekë**.
- Referuar Tabelës 11, **për vitin 2019 pagesat vjetore neto** që parashikohen të kryhen nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme për kontratat koncesionare apo PPP, kapin vlerën rreth **12.7 miliardë lekë**.
- Rrjedhimisht, në **buxhetin 2019 është respektuar kufizimin ligjor** i sipërcituar në zbatim të rregullit fiskal respektiv, pasi vlera e parashikuar prej 12.7 miliardë lekë për pagesat vjetore neto të kontratave koncesionare apo PPP për vitin 2019, përbën **vetëm 3 përqind të totalit të të ardhurave tatimore të pritshme të vitit 2018**, prej 419.4 miliardë lekë.

Gjatë vitit 2018, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka intensifikuar monitorimin e performancës financiare të kontratave koncesionare/PPP-ve me mbështetje buxhetore. Ky monitorim është kryer në

mënyrë periodike mbi bazë tremujore, me qëllim identifikimin dhe monitorimin hap pas hapi të risqeve potenciale që mund të materializohen nga implementimi i tyre.

Përsa i përket ecurisë faktike të pagesave konçesionare, për periudhën janar-shtator 2018 dhe pritshmëritë deri në fund të vitit 2018, në vijim jepet një tablo përmbledhëse:

- Fondet buxhetore të planifikuara për vitin 2018, me destinacion mbështetjen nga buxheti për kontratat konçesionare/PPP, janë në total 7.37 miliardë lekë. Nga këto, 2.85 miliardë lekë janë investime dhe 4.5 miliardë lekë shpenzime korente.
- Kundrejt faktit të vitit 2017 që kapi vlerën 6.5 miliardë lekë, plani 2018 rezulton rreth 13.2% më i lartë ose 858.7 milionë lekë më shumë.
- Pagesat faktike në total për 9-mujorin 2018, rezultojnë 6.4 miliardë lekë ose 79.3% e planit vjetor 2018. Nivelin më të lartë të pagesave e ka shënuar muaji Mars me 1.85 miliardë lekë disbursim, nga të cilat 1.35 miliardë lekë është pagesa “one-time” e kontratës konçesionare të HEC-it mbi lumin Devoll.
- Bazuar në parashikimin e ecurisë së pagesave për periudhën e mbetur të vitit 2018 (tetor-dhjetor), fondi i planifikuar për t’u shpenzuar është 1.24 miliardë lekë, nivel ky që do të përmbushte 100% planin vjetor të miratuar për vitin 2018.

Duke nisur nga viti 2019, monitorimi dhe raportimi mbi kontratat konçesionare/PPP do të institucionalizohet përmes përfshirjes në udhëzimin vjetor të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë mbi zbatimin e buxhetit të shtetit, të skedulit të detyrueshëm kohor të raportimit të tyre nga çdo autoritet kontraktor dhe të formateve standarde respektive, me qëllim thellimin e analizës dhe rritjen e transparencës.

Në bazë të vlerësimit të deritanishëm, **rreziku që pagesat për koncesionet/PPP të tejkalojnë limitin ligjor është i ulët,** për sa kohë që numri i koncesioneve/PPP të reja mbahet nën kontroll.

Sektori Energjistik

Ky sektor strategjik ka qenë dhe mbetet nën monitorimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, duke marrë parasysh ndikimin e ndjeshëm fiskal dhe në ekonomi të këtij sektori kyç. Ky monitorim, i cili është kryer periodikisht mbi bazë tremujore, ka konsistuar në analizimin e treguesve të performancës financiare të secilës prej tre kompanive KESH, OSHEE dhe OST.

Në mbështetje të nenit 4/2 të ligjit 57, datë 2.06.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, sipas së cilit: “*Planet financiare vjetore dhe pasqyrat financiare mbi bazë tremujori, të çdo njësie jo të qeverisjes së përgjithshme, dorëzohen në Ministrinë e Financave*”, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, periodikisht mbi bazë tremujore, ka mbledhur, përpunuar dhe analizuar informacionin e nevojshëm në lidhje me treguesit e performancës financiare të tre kompanive të sektorit energjistik. Kjo, me qëllim identifikimin, vlerësimin, monitorimin dhe raportimin e risqeve fiskale që rezultojnë nga ndërmarrjet publike me kapital shtetëror në tërësi dhe nga sektori energjistik në veçanti, duke konsideruar rëndësinë strategjike të tij dhe problematikat sesitive që e karakterizojnë.

Referuar analizës mbi raportimin më të fundit të treguesve financiarë të miratuar zyrtarisht për këtë sektor, atyre të **periudhës janar-qershor 2018**, mëposhtë është një tablo përmbledhëse e ecurisë së shënuar:

Tabela 12

Në milionë lekë

	2014	2015	2016	2017	Shtat. 18
Mbështetje neto për Sektorin e Energjisë nga e cila:	8.166	8.529	6.309	11.419	4.905
-Për garancitë e paguara nga MFE	2.269	2.278	2.061	2.652	1.875
-Për fondet me financim të huaj të nënhuazuara	4.292	6.143	3.002	6.170	2.881
-Për mbështetjen buxhetore me fonde nga buxheti i shtetit	1.500	-	1.000	2.241	98
-Për interesat e fondeve të nënhuazuara	106	108	246	356	247

Disbursimet për sektorin e Energjisë (2011-2018)										në milion lekë
		2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	9 m 2018	
ENERGJIA	Projekte	3,354.7	1,514.8	2,103.1	4,431.1	6,201.7	3,652.3	5,911.2	2,881.0	
	Mbështetje Buxhetore	0	2,000	0	1,500	0	1,000	2,500	0	
	Gjithsej	3,354.7	3,514.8	2,103.1	5,931.1	6,201.7	4,652.3	8,411.2	2,881.0	
Arkëtimet nga nënhuaja për sektorin e Energjisë (2011-2018)										në milion lekë
		2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	9 m 2018	
ENERGJIA	Interesa	215.8	116.4	121.6	4,431	399.5	326.2	157.1	47.9	
	Principal	831.4	3,332.6	108.4	1,500	56.1	707.2	898.5	97.8	
	Gjithsej	1,047.2	449.0	230.1	5,931	455.6	1,033.3	1,055.6	145.7	

Tabela 13

Detyrimet kontigjente nga garancitë

	31 Dhjetor					Shtator 2018
	2013	2014	2015	2016	2017	
	(Milion lekë)					
Stoku i borxhit të garantuar	51,324	54,540	56,030	53,468	49,885	46,882
Grancitë e brendshme.....	19,918	26,033	30,439	30,286	30,117	15,328
Grancitë e jashtme.....	31,406	28,507	25,591	23,182	19,768	31,554

Përsa i përket performancës së Sektorit në tërësi dhe OSHEE sh.a në veçanti për vitin 2018, në analogji retrospektive me ecurinë që shënoi viti i vështirë 2017, vlen të theksojmë se:

- **Viti 2017 ishte një vit problematik** referuar aspektit klimaterik që e karakterizoi atë, nëse konsiderojmë nivelin drastikisht të ulët të rreshjeve. Për rrjedhojë, KESH sh.a. prodhoi më pak energji sesa ajo e planifikuar, duke shkaktuar një kosto shtesë për OSHEE sh.a, duke bërë që çmimi i energjisë së blerë në treg të lirë të rezultonte rreth 6 herë më i lartë se sesa çmimi që KESH ofronte në atë periudhë.
 - *Një domosdoshmëri përbën planifikimi/parashikimi optimal nga ana e KESH dhe OSHEE e prodhimit të pritshëm të energjisë në nivel vjetor, në mënyrë që sektori në tërësi të mos përballlet papritmas me kosto të larta të çmimit të blerjes së energjisë.*
- **Gjatë muajve të parë të vitit 2018**, OSHEE u përball me një kosto të lartë të energjisë si pasojë e mbi-prodhimit të energjisë nga ana e HEC-eve, si edhe rritjes së tarifave të HEC-eve, KESH-it dhe OST-së.
 - *Vlerësimet tregojnë se, nëse OSHEE do të blinte energji nga KESH (dhe jo vetëm nga HEC-et), ose ta importonte atë sipas çmimit të bursës hungareze apo bursës evropiane, kosto për blerjen e energjisë do të ishte ndjeshëm më e ulët.*

- **Mbështetja buxhetore neto** për sektorin e energjisë **për vitin 2018**, është miratuar në nivelin 3.5 miliard lekë sipas buxhetit fillestar dhe rishikuar në 5 miliard lekë sipas Aktit Normativ nr.1 2018. Në këto kushte, nga ana e të tre kompanive duhet të rishikohen dhe të prioritarizohen shpenzimet operative dhe sidomos ato kapitale të planifikuara për vitin 2018, me qëllim paraprirjen e ndonjë nevoje kritike për mbështetje buxhetore extra gjatë fundit të vitit 2018.

Për vitin 2019, parashikimet e kompanive dhe monitorimi i MFE do të kenë një emërues të përbashkët, atë të garantimit të objektivit madhor për një performancë të shëndetshme të Sektorit, përmes:

- 1) Ruajtjes së një rezultati neto (net position) të qëndrueshëm, që nuk rrezikon buxhetin për sektorët e tjerë prioritarë (**3 mld lekë në vit**).
- 2) Mbajtjen e një rezerve për përballimin e vulnerabilitetit ndaj kushteve meteorologjike të paparashikuara (**1-3 mld lekë në vit**).

Këto parametra janë plotësisht të arritshëm, duke konsideruar përmirësimin e performances dhe disiplinimin e shpenzimeve (operative dhe kapitale) të secilës prej tre kompanive. Mbi këto baza, **pritsmëritë 2019 janë për një rezultat financiar pozitiv të sektorit**, që është i rëndësishëm për përballimin e situatave të vështira të motit pa rënduar buxhetin e shtetit.

Detyrimet Kontigjente:

- **Vendimet e Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strasburg (GJEDNJ)** kryesisht çështje dhe vendime që lidhen me kthimin dhe kompensimin e pronave tek ish-pronarët. Sipas Avokaturës së Shtetit, risqet financiare që burojnë nga vendimet e GJEDNJ-së janë të karakterizuara nga një aftësi e dobët parashikuese, përse kohë që kjo Gjykatë nuk funksionon me një kalendar të përcaktuar për komunikimin e çështjeve dhe nxjerrjen e vendimeve.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka respektuar në vazhdimësi të gjitha vendimet e miratuara nga GJEDNJ përmes zbatimit të VKM-ve respektive miratuar në mbështetje të tyre, me përpikmëri dhe brenda afateve strikte të përcaktuara prej këtij organi. Kjo, duke konsideruar faktin se kur pagesat nuk kryhen brenda afatit tre mujor nga data kur vendimi përkatës merr formën e prerë, shteti shqiptar ngarkohet me pagesën e një kamatë-vonesë për çdo ditë vonesë. Sidoqoftë, për garantimin e shlyerjes në kohë të këtyre vendimeve, MFE ka rekomanduar vazhdimisht përdorimin e të gjitha kanaleve të mundshme institucionale dhe procedurale, brenda hapësirave që siguron kuadri ligjor në fuqi, duke sugjeruar që:

- *Vendimet e GJEDNJ-së duhet të dërgohen fillimisht për zbatim në Agjencinë e Trajtimin të Pronës, duke shfrytëzuar të gjitha mundësitë për kompensim fizik të tyre, nëse kjo parashikohet nga vendimi i Gjykatës.*
- *Pjesa tjetër e detyrimit financiar të paguhet sipas mundësive të buxhetit të shtetit me këste, në negociim me përfituesit.*

Edhe për vitin 2019, likuidimi i detyrimeve të këtij lloji do të përballohet nga Fondi Rezervë i buxhetit të shtetit.

- **Vendimet e Gjykatës Ndërkombëtare të ARBITRAZHIT** që kanë të bëjnë me zgjidhjen e konflikteve në mosmarrëveshjet dy ose shumëpalëshe, në ngarkim të shtetit shqiptar, përbëjnë gjithashtu një risk real për buxhetin e shtetit. Në pjesën më të madhe, efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtyre vendimeve janë përballur nga buxheti i vetë institucioneve buxhetore

(kryesisht ministri linje) që kanë përfaqësuar Qeverinë shqiptare. Në raste të tjera, sipas specifikave, është përdorur për këtë qëllim edhe Fondi Rezervë i Buxhetit të Shtetit.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka rekomanduar forcimin e rolit negociues të institucioneve buxhetore dhe Avokaturës së Shtetit në çështjet e kësaj natyre, si edhe disiplinimin e procesit të shlyerjes financiare të vendimeve finale.

- **Vendimet gjyqësore administrative të formës së prerë**, kryesisht për largime nga puna të ish-punonjësve, procese gjyqësore me karakter shpronësimi etj, implikojnë kosto buxhetore të paparashikuara. Për t'i paraprirë stokut eventual të akumulimit të tyre në kohë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë përveç një monitorimi periodik, vazhdimisht i ka bërë apel edhe aftësisë menaxhuese të vetë institucioneve buxhetore, përmes aplikimit me këste apo instrumentave të tjerë zbutës në kohë të barrës së tyre buxhetore.

Detyrimet e Prapambetura

Një nga çështjet problematike në sistemin tonë buxhetor, u vërtetua se ishte akumulimi i detyrimeve të prapambetura të krijuara përpara vitit 2014. Qeveria jo vetëm e adresoi me prioritet çështjen e shlyerjes së tyre, por me angazhimin maksimal si të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ashtu edhe të institucioneve buxhetore të përfshira në këtë proces, u arrit që brenda dy viteve (2014-2015) të shlyen të gjitha detyrimet e prapambetura të raportuara, në vlerën 67 miliardë lekë. Bazuar në VKM nr. 50 datë 05.02.2014 “Për miratimin e Strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit” dhe Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka ndërmarrë disa hapa konkretë në drejtim të monitorimit, raportimit dhe parandalimit të detyrimeve të prapambetura.

Vlen për t'u theksuar se tashmë ky është një proces i konsoliduar në kohë dhe cilësi, përmes monitorimit periodik intensiv të të gjitha detyrimeve të pashlyera të institucioneve buxhetore. Duke nisur nga muaji Shtator 2017, ky monitorim dhe raportim i cili më parë kryhej mbi bazë katërmujorësh, **tashmë ndiqet dhe analizohet mbi bazë tremujore**, në funksion të intensifikimit të rolit mbikqyrës të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në këtë drejtim. Kjo, me qëllimin final të përmbushjes së objektivit konkret të Qeverisë, për ‘zerimin’ e të gjitha detyrimeve të prapambetura deri në vitin 2020.

Specifikisht për vitin 2018, skeduli dhe modaliteti i raportimit dhe monitorimit të detyrimeve të prapambetura, **u përfshi në Udhezimin Nr.2 datë 19.01.2018 “Mbi zbatimin e Buxhetit 2018”**, duke përcaktuar si afatet strikte të raportimit nga ana e institucioneve buxhetore, ashtu edhe ato të analizimit dhe publikimit nga ana e MFE.

Për më tepër, **që prej muajit Janar 2018**, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka nisur edhe **monitorimin periodik mbi ekzekutimin e pagesave (likuidimin)** e detyrimeve të prapambetura përçdo institucion buxhetor, sipas angazhimeve të marra prej tyre për vitin buxhetor 2018. Kjo, krahas përditësimit dhe monitorimit të skedulit të parashikuar të këtyre pagesave edhe për vitin që pason, pra deri në Dhjetor 2019.

Në funksion të sa mësipër, duke konsideruar startimin në 1 Janar 2019 të implementimit të plotë të sistemit të ri informatik financiar të Qeverisë AFMIS, respektimi i angazhimeve financiare të institucioneve buxhetore do të garantohet, përmes monitorimit dhe kontrollit të automatizuar elektronik në kohë reale.

Në përfundim, parë në një aspekt më të gjerë dhe gjithëpërfshirës, Ministria e Financave dhe Ekonomisë i ka sugjeruar të gjitha njësitë të auditimit të brendshëm në sektorin publik që në “Planin strategjik dhe vjetor të veprimtarisë audituese për vitet 2018 – 2020” të përfshijnë angazhime auditimi për analizimin dhe vlerësimin e situatës së detyrimeve të prapambetura të njësitë publike. Kjo, përse kohë që detyrimet e prapambetura janë përcaktuar si fushë me risk të lartë, dhe duhet të trajtohen me përparësi nga auditimi i brendshëm i njësitë publike, për të paraqitur gjendjen aktuale dhe për të dhënë rekomandime sa më të vlefshme për shlyerjen e tyre në afate të përcaktuara.


8.1 VEPRIMTARITË POTHUAJSE FISKALE

Në fund të muajit shtator 2018, portofoli i borxhit të garantuar vlerësohet në 46.9 miliard Lek (2.8% e PBB²) ose 4.3% e portofolit të borxhit të Qeverisjes Qendrore. Garancitë në tregun e brendshëm përfaqësojnë 32.7% të totalit të stokut të borxhit të garantuar ose 15.3 miliard Lek, ndërsa garancitë e emetuara në favor të kreditorëve të huaj përfaqësojnë 67.3% të stokut të borxhit të garantuar ose 31.6 miliard Lek. Krahasuar me fundin e vitit të kaluar, borxhi i garantuar është reduktuar në vlerë absolute me rreth 3.0 miliard Lek, kryesisht si rezultat i ritmeve më të larta të ripagesave krahasuar me disbursimet si edhe për shkak të mbiçmimit të monedhës vendase në raport me monedhat e tjera që kompozojnë këtë portofol.

Gjatë periudhës Janar-Shtator të vitit 2018, është disbursuar totalisht transhi i parë i huasë së garantuar nga BERZH, në vlerën 118 milion Euro, i cili ka shërbyer për rifinancimin e portofolit të garancive të brendshme të akorduara për Korporatën Elektroenergjitike Shqiptare (*KESH sh.a.*), duke i mundësuar KESH sh.a. konvertimin e një pjese të borxhit me norma interesi tregtare në borxh me norma interesi më të favorshme.

Garancitë e brendshme përbëhen nga linja kredie afatshkurtra dhe me norma interesi tregtare, të cilat i janë akorduar KESH sh.a. nga bankat tregtare vendase. Në dallim nga garancitë e brendshme, garancitë e huaja janë kredi afatgjata të akorduara kryesisht me norma interesi koncesionale.

Figura 7: Portofoli i Garancive Shtetërore (2014–Shtator 2018)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Më shumë se 83% e totalit të garancive shtetërore vazhdojnë t’i përkasin sektorit të Energjisë.

² PBB mbi bazë vjetore; referuar Draft-Kuadrit Makroekonomik 2020-2022, datë 12.10.2018.

Përqendrimi i lartë i garancive në drejtim të këtij sektori është në përputhje me objektivat e qeverisë për të mbështetur sektorin e Energjisë, me qëllim që të përmirësojë performancën financiare dhe të rrisë efikasitetin.

Figura 8: Portofoli i Garancive shtetërore (2014 – Shtator 2018)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Deri në shtator 2018 portofoli i garancive përbëhet nga 33 linja garancie, përkatësisht 7 garanci të brendshme dhe 26 garanci të huaja. Në tabelën e mëposhtme paraqitet lista e detajuar e garancive të lëshuara nga qeveria deri në shtator 2018:

Tabela 14: Portofoli i garancive shtetërore (Shtator-2018)

I. Garanci të Brendshme					
Huamarrësi	Kreditori	Projekti	Data e Nënshkrimit	Shuma (në milion Lek)	Stoku më 30.09.2018 (në milion Lek)
KESH	Raiffeisen Bank	Kredia KESH	27.08.2008	4,980.00	4,980.00
	Raiffeisen Bank	Kredia KESH	19.11.2012	1,390.00	1,390.00
	IntesaSanPaolo	Kredia KESH	14.01.2013	270.00	270.00
	IntesaSanPaolo	Kredia KESH	03.03.2014	1,000.00	1,000.00
	Societe Generale	Kredia KESH	10.02.2014	757.74	757.74
	Raiffeisen Bank	Kredia KESH	20.11.2014	2,838.55	2,838.55
	Raiffeisen Bank	Kredia KESH	05.02.2015	4,091.70	4,091.70
Totali I				15,327.99	15,327.99
II. Garanci të Huaja					
ATK	KfW, Gjermani	Ndihmë në Mallra II	11.05.1992	491.72	211.53
	KfW, Gjermani	Ndihmë në Mallra III	11.05.1992	351.23	151.35
	KfW, Gjermani	Ndihmë në Mallra IV	04.01.1993	421.48	187.26
	KfW, Gjermani	Sektori Bujqësor Privat I	08.09.1993	545.08	254.91
DPUK/NUK Tiranë	Artigiancassa, Itali	Ujësullësi i Tiranës I	10.09.1995	922.43	314.11
	Artigiancassa, Itali	Furnizimi me Ujë i Tiranës II	18.03.1996	1,561.03	637.74
	Artigiancassa, Itali	Rehabilitimi i Rrjetit Hidrik të Tiranës	11.05.2000	3,774.86	2,110.16
	Artigiancassa, Itali	Rehabilitimi i Rrjetit Hidrik të Tiranës	11.05.2000	482.43	443.45
Albtelekom	Artigiancassa	Albtelekom	10.02.1995	935.46	334.40
NUK Krujë	KfW, Gjermani	Ujësullës-Kanalizime Krujë	26.03.1998	147.52	90.40
Hekurudha Durrës	Artigiancassa, Itali	Rehabilitimi i Hekurudhës së Durrësit	08.05.1995	425.74	152.19
KESH	OECE	Hydrocentrali mbi Lumin Drin	28.11.1995	1,753.79	562.59
	EBRD	Plani i ristrukturimit të KESH	30.06.2016	29,937.94	14,902.22
OST	EBRD	Nënstacioni i Transmetimit të Energjisë	10.10.2006	2,198.24	146.79
	KfW, Gjermani	Linja 400 kV Tiranë-Maqedoni	18.11.2016	6,797.50	-
	KfW, Gjermani	Projekti i efikasitetit në energji	30.06.2015	5,495.60	78.54
KESH, OST	OECE	Transmetim, Shpërndarje e Energjisë	19.12.1996	3,205.43	1,218.13
	EIB	Transmetim, Shpërndarje e Energjisë	30.10.2001	4,121.70	1,296.90
	EBRD	TEC-i Vlorë	09.07.2004	5,495.60	473.06
	Exim Bank of Korea	Elektrifikimi i Zonave Rurale	20.10.2004	3,214.89	2,344.95
	EIB	TEC-i Vlorë	06.12.2004	5,495.60	2,169.26
	KfW, Gjermani	Linja e Transmetimit 400 KV Tiranë-Podgoricë II	18.11.2004	4,808.65	442.02
	KfW, Gjermani	Linja e Transmetimit 400 KV Tiranë-Podgoricë I	18.11.2004	479.24	389.70
TIA	EBRD	Rruga Tiranë-Rinas	23.03.2005	1,236.51	142.08
Porti i Durrësit	EBRD	Porti i Durrësit	06.10.2010	1,923.46	654.62
RTSH	Deutsche Bank Frankfurt	Radio Televizioni Shqiptar	11.06.2015	2,756.67	1,845.42
TOTALI II				88,979.80	31,553.79
TOTALI I GARANCIVE (I+II)				104,307.79	46,881.77

Gjatë pjesës së mbetur të vitit 2018, niveli i garancive shtetërore në terma relativ ndaj PBB dhe ndaj totalit të stokut të borxhit pritet të qëndrojë pothuajse në të njëjtat nivele.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet në mënyrë të përmbledhur informacion për kreditë e marra në nivel vendor.

Tabela 15: *Regjistri i borxhit të pushtetit lokal*

milion Lekë

Emri i Kredisë	Huamarrësi	Huadhënësi	Shuma	Data e Nënshkrimit	Data e Përfundimit	Stoku 30.09.2018
Kredia Infrastruktura Korçë	Bashkia Korçë	Pro Credit	100	31.03.2010	31.12.2020	30.32
Kredia Infrastruktura Korçë	Bashkia Korçë	ISBA	200	15.05.2014	31.12.2024	148.43
Kredia Infrastruktura Pogradec	Bashkia Pogradec	ProCredit	113	05.10.2010	05.10.2020	10.91
Kredia Infrastruktura Vlorë	Bashkia Vlorë	BKT	420	21.12.2010	21.12.2020	53.95
Kredia Infrastruktura Petrelë	Kom. Petrelë	BKT	15	01.09.2010	24.05.2019	0.80
Kredia Infrastruktura Elbasan	Bashkia Elbasan	BKT	800	29.09.2010	30.12.2020	450.27
Kredia Infrastruktura Lezhë	Bashkia Lezhë	ISBA	107	12.06.2014	31.12.2023	50.46

*) Borxhi i marrë nga sektori bankar brenda vendit. Shifrat janë objekt rishikimi

9. SHTOJCA ILUSTRUESE

9.1 TREGUESIT E PËRZGJEDHUR MAKROEKONOMIKË DHE FISKALË

Tabela 16: Produkti i Brendshëm Bruto (rritja vjetore në përqindje, në terma real)

	2013	2014	2015	2016	2017*	2018 para	2019 para
<i>Rritja reale ekonomike, në %</i>							
Shqipëria	1.0	1.8	2.2	3.4	3.8	4.2	4.3
Bosnja dhe Hercegovina	2.4	1.1	3.0	3.1	3.0	3.2	3.4
Kosova	3.4	1.2	4.1	4.1	4.4	4.8	4.8
Maqedonia	2.9	3.6	3.9	2.9	0.0	2.3	2.7
Mal i Zi	3.5	1.8	3.4	2.9	4.3	2.8	2.5
Serbia	2.6	-1.8	0.8	2.8	1.9	3.0	3.5
Mesatarja e rajonit	2.5	0.3	2.2	3.1	2.4	3.2	3.5

Figura 9: Ndryshimi Vjetor i Inflacionit




Figura 10: Treguesi i Ndjesisë Ekonomike




Figura 11: Rritja e Volumit së Tregtisë me Pakicë (rritja vjetore në përqindje)

Figura 12: Rritja e Vlerës së Tregtisë me Pakicë (rritja vjetore në përqindje)





Tabela 17: Tregtia e Jashtme: Eksportet dhe Importet për periudhën Janar-Shtator 2018 (krahasuar me të njëjtën periudhë të viti më parë).

Tregtia e Jashtme	Ekspotet Janar - Shtator 2018 / 2017		Importet Shtator 2018 / 2017	
	Rritja	Kontributi në rritje	Rritja	Kontributi në rritje
Ushqime, pije, duhan	9.5	1.0	1.2	0.2
Minerale, lëndë djegëse, en.elektrike	34.2	5.6	5.9	0.6
Produkte kimike dhe plastike	28.0	0.5	0.9	0.1
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	-3.7	0.0	1.2	0.0
Prodhime druri dhe letre	11.7	0.3	5.4	0.2
Tekstile dhe këpucë	6.1	2.7	2.3	0.3
Materiale ndërtimi dhe metale	25.9	4.1	0.2	0.0
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	16.3	0.9	6.3	1.3
Të tjera	10.1	0.3	4.0	0.2
Gjithsej	15.3	15.3	3.0	3.0

Figura 13: Dinamika e rritjes së stokut total të Depozitave (në përqindje, krahasuar me të njëjtin muaj të njëjti viti më parë)

Figura 14: Dinamika e rritjes së stokut total të Kredive (në përqindje, krahasuar me të njëjtin muaj të njëjti viti më parë)





Figura 15: Lehtësimi (+) Shtrengimi (-) i Standardeve të Kredisë për Biznesin

Figura 16: Lehtësimi (+) Shtrengimi (-) i Standardeve të Kredisë për Individë



9.2 ZHVILLIMET FISKALE GJATË 9-MUJORIT 2018

Pas ndryshimeve të Aktit Normativ nr. 1, datë 26.07.2018, të ardhurat totale për 8 mujorin 2018, u realizuan në vlerën 294 miliardë lekë, 3% ose 9 miliardë lekë më shumë se 8 mujori i vitit 2017 dhe me realizim kundrejt planit të periudhës në masën 99%.

Nga totali i të ardhurave, të ardhurat e arkëtuara nga “tatimet dhe doganat” (përfshirë kontributet e mbledhura nga DPT) për 8 mujorin 2018, u realizuan në vlerën 259 miliardë lekë, 4.3% ose 10.7 miliardë lekë më shumë se 8 mujori 2017 dhe me realizim kundrejt planit të periudhës në masën 99.7%.

Tabela 18: Performanca Tatime+Dogana dhe Kontributet Janar- Gusht 2018 (në milionë lekë)

Lloji i taksave	Fakt 8-mujor 2018	Plan 8-mujor 2018	Δ Fakt/Plan 2018	Δ% Fakt/Plan 2018
Tvsh në import	69,562	70,569	-1,007	-1.4%
Tvsh brenda vendit	23,734	23,524	210	0.9%
Tatimi mbi fitimi	21,727	22,204	-478	-2.2%
Akciza	29,714	30,337	-623	-2.1%

Tatimi mbi të ardhurat personale	25,111	24,405	706	2.9%
Taksat nacionale	23,780	23,670	111	0.5%
Renta Minerare	1,810	1,934	-124	-6.4%
Taksë doganore	4,092	4,252	-161	-3.8%
Totali të ardhura	199,530	200,896	-1,366	-0.7%
Kontributet e mbledhura (DPT)	59,524	59,035	489	0.8%
Totali tatime+dogana (përfshirë kontributet)	259,053	259,931	-877	-0.3%


Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Faktorët kryesorë që kanë ndikuar në performancën e 8 mujorit kundrejt planit janë:

- Rënia e kursit të këmbimit të monedhës vendase ndaj monedhës USD dhe EURO, ka dhënë efekte të ndjeshme negative në uljen e të ardhurave nga TVSH-ja e importeve për të gjitha kategoritë e mallrave. Efekti i kursit të këmbimit për 8 mujorin ka qenë 7mld lekë.
- Kriza energjitike e vitit të kaluar ka dhënë efekte negative në rezultatin financiar të kompanive të sistemit energjistik, çka u reflektua në uljen e fitimit të tatueshëm dhe tatimit mbi fitimin për tu paguar gjatë vitit 2018.
- Rënie të importit të cigareve, çka ka ulur të ardhurat doganore me 400 milionë lekë, krahasura me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për 8-mujorin e vitit 2018, ka arkëtuar 105.2 miliardë lekë, duke shënuar një performancë pozitive krahasuar me vitin 2017, në masën 2.3 miliardë lekë ose 2.2% dhe me realizim kundrejt planit në masën 98.2%. Deficiti i krijuar me planin lidhet kryesisht me impaktin negativ të kursit të këmbimit mbi të ardhurat doganore, duke sjellë vlera më të ulta të importit të taksuar, çka ka ndikuar në uljen e të ardhurave tatimore nga veprimtaria doganore.

Figura 17: Performanca e DPD-së Janar-Gusht 2018/2017 (në milionë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Të ardhurat nga “TVSH”-ja në import janë realizuar në vlerën 71 miliardë lekë, 4% ose rreth 2.7 miliardë lekë më shumë se 8 mujori i vitit 2017 dhe realizim në masën 99% kundrejt planit të periudhës. Rënia e kursit të këmbimit të monedhave të huaja (EURO dhe USD) kundrejtë monedhës vendase, ka dhënë efekte të ndjeshme negative në uljen e të ardhurave nga TVSH-ja në import për të gjitha kategoritë e mallrave.

Të ardhurat nga “Akciza” janë realizuar në vlerën 29.7 miliardë lekë, me realizim kundrejt planit në masën 98%. Ndikim ka patur “Karburanti” (import+prodhim vendas), që rezultoi rreth 384,075 ton, me një rritje prej 2,897 ton ose +0.8% krahasuar me 8 mujorin e vitit 2017. Gjithashtu performancë pozitive


si rezultat i rritjes së sasisë kanë shënuar: importi dhe prodhimi i “Birrës” +2.4%; importi i “Duhanit” +4.9%; importi i “Vaj lubrifikant” +6.3%, import i “Kafesë” +8.4%. Deklarimi i prodhimit vendas të duhanit është rritur nga 7 ton në 13 ton të deklaruara në periudhën Janar-Gusht 2018.

Të ardhurat nga “Renta Minerare” në eksport janë realizuar në vlerën 1.8 miliardë lekë, 17.5% ose 269 milionë lekë më shumë krahasuar me 8 mujorin e vitit 2017, dhe realizim në masën 93.7% kundrejt planit. Krahasuar me vitin e kaluar të ardhurat nga renta minerare për naftën bruto janë rritur, si rezultat i rritjes së sasisë së eksportuar dhe si rezultat i rritjes së çmimit të naftës bruto në tregjet ndërkombëtare. Të ardhurat nga renta minerare për naftën bruto janë rritur me 230 milionë lekë, si rezultat i rritjes së sasisë së eksportuar me rreth 81 mijë ton dhe janë rritur me 280 milionë lekë si rezultat i rritjes së çmimit të naftës bruto në tregjet ndërkombëtare krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, duke sjellë rritje të rentës për njësi nga 2.85 lekë/kg në 3.54 lekë/kg. Ndërkohë, të ardhurat nga mineralet e eksportuara kanë pësuar rënie në masën 115 milionë lekë për shkak të rënies së sasisë së eksportuar, me rreth 297 mijë ton si dhe janë ulur me 126 milionë lekë, për shkak të rënies së çmimit të mineraleve në tregjet ndërkombëtare, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Të ardhurat nga “Taksa Doganore” janë realizuar në vlerën 4 miliardë lekë, me një realizim në masën 96% krahasuar me vitin 2017 dhe me planin e periudhës. Vlera e importit të taksuar për 8 mujorin 2018, është në të njëjtën vlerë krahasuar me periudhën Janar–Gusht 2017.

Të ardhurat e mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (përfshirë kontributet) për 8 mujorin e vitit 2018 janë realizuar në vlerën 154 miliardë lekë, 8.4 miliardë lekë ose 5.8% më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë dhe tejkalim të parashikimeve me 1 miliardë lekë ose 0.7%.

Figura 18: Performanca e DPT-së për periudhën Janar-Gusht 2018/2017 (në milionë lekë)



Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)*

Të ardhurat nga TVSH-ja brenda vendit janë realizuar në vlerën 23.8 miliardë lekë, 3.5% ose 0.8 miliardë lekë më shumë se 8 mujori i vitit 2017 dhe 1% ose 0.2 miliardë lekë më shumë se parashikimi. Rimbursimi i TVSH është realizuar në vlerën 9.2 miliardë lekë, 12.6% ose 1 miliardë lekë më shumë se 8-mujori i vitit 2017.

Të ardhurat nga “Tatimi mbi Fitimin” janë realizuar në vlerën 21.7 miliardë lekë, 3.1% ose 658 milionë lekë më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar dhe realizim në masën 97.8% të planit. Kriza energjitike e vitit të kaluar ka dhënë efekte negative në rezultatin financiar të kompanive të sistemit energjistik, çka u reflektua në uljen e fitimit të tatueshëm dhe tatimit të paguar në vitin 2018.

Nga tatimi mbi të ardhurat personale janë realizuar në vlerën 25.1 miliardë lekë, 14.2% ose 3.1 miliardë lekë më shumë se 8-mujori i vitit 2017 dhe +2.9% ose 706 milionë lekë më shumë krahasuar me planin. Krahasuar me 8-mujorin e vitit të kaluar, të ardhurat nga të punësuarit e sektorit publik dhe sektorit privat, janë rritur ndjeshëm, kjo si rezultat i rritjes së numrit të kontribuesve aktiv krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Të ardhurat nga “Taksat Nacionale” janë realizuar në vlerën 23.8 miliardë lekë, realizim në masën 100.5% ose 111 milionë lekë më shumë se plani.

Të ardhurat nga “Kontributet e DPT-së” janë realizuar në vlerën 59.5 miliardë lekë, 9% ose 5 miliardë lekë më shumë se 8 mujori i vitit 2017 dhe 0.6% ose 384 miliardë lekë më shumë se plani. Rezultati i lartë me rritje të qëndrueshme buron kryesisht nga situata pozitive ekonomike dhe rritja si rrjedhojë e numrit të të punësuarve. Nga ana tjetër aksioni antiinformalitet ka dhënë efekte të dukshme në formalizimin e tregut të punës.

9.3 TË ARDHURAT E PRITSHME PËR VITIN 2018

Të ardhurat e buxhetit të shtetit në fund të vitit 2018, pritet të jenë 458.2 miliardë lekë. Krahasuar me vitin 2017, parashikohet një rritje prej 6.5%, ose 27.8 miliardë lekë duke përfaqësuar 27.8% të PBB-së nga 27.7% që ishin në vitin 2017. Rritja me 0.1% e kontributit të të ardhurave të buxhetit të shtetit në raport me Produktin e Brendshëm Bruto për vitin 2018, është tregues i rëndësishëm i përmirësimit të performancës së mbledhjes së të ardhurave në kuadër të reformës së konsolidimit të financave publike. Kjo rritje vjen kryesisht nga impakti i rritjes ekonomike dhe nga përmirësimi në administrimin e taksave, pavarësisht efekteve negative në të ardhurat nga importi që ka gjeneruar ndryshimi i kurseve të këmbimit.

Të ardhurat që administrohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD), përfshirë kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, realizohen në nivelin 98%. Të ardhurat e arkëtuara shënojnë përmirësim krahasuar me periudhat e kaluara. Ky rezultat është efekt i përpjekjeve intensive për uljen e informalitetit në ekonomi si edhe rritjes së nivelit të pajtueshmërisë së tatimpaguesve me ligjin, përmes parimit të vetëkorrigjimit.

Tabela 19

(në milionë lekë)

Tatime dhe Dogana	Buxheti zyrtar 2018	Vlerësim Buxheti 2018	Diferencë në vlerë	Diferencë në %
Tatimi mbi vlerën e shtuar	148,134	143,800	-4,334	-3%
Tatimi mbi fitimin	33,823	31,300	-2,523	-7%
Akciza	49,000	45,500	-3,500	-7%
Tatimi mbi të ardhurat personale	36,800	37,400	600	2%
Taksa Nacionale dhe të tjera	38,340	40,100	1,760	5%
Taksa Doganore	7,000	7,000	0	0%
Totali "Tatime dhe Dogana"	313,097	305,100	-7,997	-3%
Kontribute nga DPT	87,900	88,700	800	1%

Totali	400,997	393,800	-7,197	-2%
---------------	----------------	----------------	---------------	------------

Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)*

Pritshmëria e të ardhurave nga Administrata Doganore

Të ardhurat e pritshme për vitin 2018, janë vlerësuar mbi bazën e performancës së të ardhurave në periudhën Janar-Gusht 2018 si dhe të faktorëve që do të ndikojnë në muajt në vijim.

Tabela 20 (në milionë lekë)

Administrata Doganore	Buxheti zyrtar 2018	Vlerësim Buxheti 2018	Diferencë në vlerë	Diferenca në %
Taksa doganore	7,000	7,000	0	0.0%
Tatimi mbi vlerën e shtuar	109,974	105,800	-4,174	-3.8%
Akciza	49,000	45,500	-3,500	-7.1%
Renta minerare	3,010	3,010	0	0.0%
Totali	168,984	161,310	-7,674	-4.5%

Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)*

Performanca e të ardhurave nga TVSH në import është ndikuar në një masë të rëndësishme nga disa faktorë:

- Rënie e kursit të këmbimit të monedhave USD dhe EURO kundrejt monedhës vendase, përkatësisht në masën 14.2% dhe 4.1%, ka dhënë efekte të ndjeshme negative në uljen e të ardhurave nga TVSH-ja e importeve për të gjitha kategoritë e mallrave. Vetëm për periudhën 8 mujore Janar-Gusht, ky efekt negativ në të ardhurat nga Dogana ka qënë -6 miliardë lekë, ndërkohë që efekti i pritshëm vjetor pritet të jetë -9 miliardë lekë.
- Rënie e importit të energjisë elektrike, si rezultat i rritjes së prodhimit vendas dhe disiplinimit të konsumit.
- Rënie e të ardhurave nga importi i pajisjeve të Projektit TAP, si rezultat i përfundimit të importit të tubove dhe pajisjeve të tjera.

Tabela 21: Janar-Gusht 2018

Produktet	Të ardhurat e munguara TVSH (në milionë lekë)	Arsyet
Kursi i këmbimit	(6,000)	Rënie e kursit të USD dhe Euro në raport me Lekun
Energjia Elektrike	(715)	Rënie e sasisë së importuar me 707 mijë MG, me efekt negativ 715 milionë lekë , si rezultat i rritjes së prodhimit vendas.

Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)*

Performanca e të ardhurave nga Akciza, është ndikuar nga disa faktorë:

- Rënie e sasisë së importuar të cigareve, nga ulja e konsumit, ku për periudhën 8-mujore 2018 rezultoi 104 ton ose 5.1% më pak krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.
- Mosrealizimi i rritjes së programuar në akcizën e karburanteve.
- Performancë pozitive si rezultat i rritjes në sasi kanë shënuar: importi dhe prodhimi vendas i birrës me +2.4%, importi i verës +1.7%; importi i duhanit të grirë +5%, importi i kafesë +5.5%, si dhe

rritje të deklarimit të prodhimit vendas të duhanit, nga 7 ton në 13 ton të deklaruar në periudhën Janar-Gusht 2018.

Të ardhurat nga Renta Minerare në eksport për 12- mujorin 2018 pritet të shënojnë vlerën 3 miliardë lekë, ose realizim në masën 100% ndaj planit. Të ardhurat nga renta minerare për naftën bruto janë rritur si rezultat i rritjes së sasisë së eksportuar, si dhe si rezultat i rritjes së çmimit të naftës bruto në tregjet ndërkombëtare krahasuar me 8-mujorin e vitit të kaluar, duke sjellë rritje të rentës për njësi nga 2.85 lekë/kg në 3.54 lekë/kg. Ndërkohë, të ardhurat nga mineralet e eksportuara kanë pësuar rënie për shkak të rënies së sasisë së eksportuar, me rreth 297 mijë ton si dhe për shkak të rënies së çmimit të mineraleve në tregjet ndërkombëtare.

Të ardhurat nga Taksa Doganore parashikohet të realizohen për 12-mujorin 2018 në masën 7 miliardë lekë ose në masën 100% ndaj planit. Përmirësimi i kontrollit doganor është faktor kryesor në përmirësimin e performancës.

Pritshmëria e të ardhurave nga Administrata Tatimore

Të ardhurat e pritshme për vitin 2018 janë vlerësuar mbi bazën e performancës gjatë periudhës Janar-Gusht 2018, si dhe të faktorëve që do të ndikojnë në muajt në vijim.

Tabela 22

(në milionë lekë)

Administrata Tatimore	Buxheti zyrtar 2018	Vlerësim Buxheti 2018	Diferenca në vlerë	Diferenca në %
Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	38,160	38,000	-160	-0.4%
Tatim mbi Fitimin	33,823	31,300	-2,523	-7.5%
Tatimi mbi të ardhurat personale	36,800	37,400	600	1.6%
Taksa Nacionale dhe të tjera	35,330	37,090	1,760	5.0%
Totali	144,113	143,790	-323	-0.2%
Kontribute nga DPT	87,900	88,700	800	0.9%
Totali	232,013	232,490	477	0.2%

Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)*

Të ardhurat nga Tatimi mbi Vlerën e shtuar brenda vendit pritet të realizohen në masën 38 miliardë lekë, pra pothuajse realizim në masën 100% kundrejt planit. Në periudhën Janar-Gusht 2018, janë rimbursuar 9.2 miliardë lekë, rreth 1 miliardë lekë ose 12.6% më shumë se 8-mujori i vitit 2017. Rritja e prodhimit brenda vendit të energjisë elektrike si dhe ndikimi i rritjes së sasisë së karburantit të prodhuar në vend, në 6-mujorin e dytë të vitit, kanë dhënë rezultate pozitive në të ardhurat nga TVSH brenda vendit. Po kështu janë rritur të ardhurat nga sektori i turizmit.

Të ardhurat nga Tatimi mbi Fitimin pritet të realizohen në masën 31.3 miliardë lekë, pra rreth 2.5 miliardë lekë ose 7.5% më pak se plani. Kriza energjitike e vitit 2017 ka dhënë efekte negative në rezultatin financiar të kompanive të sistemit energjistik, çka u reflektua në uljen e fitimit të tatueshëm dhe tatimit të paguar nga ana e tyre në vitin 2018. Kjo situatë do tejkalohet në vitin 2019, ku do reflektohet përmirësimi i situatës energjitike të vitit 2018.

Tatimi mbi të Ardhurat Personale pritet të realizohen në masën 37.4 miliardë lekë, duke shënuar rritje me rreth 0.6 miliardë lekë ose 1.6% më shumë se parashikimi. Të ardhurat nga të punësuarit e sektorit publik dhe sektorit privat, janë rritur, kjo si rezultat i rritjes së numrit të të punësuarve dhe nivelit të pagës. Gjithashtu ka rritje edhe në tatimin mbi dividendin dhe tatimin mbi të ardhurat individuale.

Të ardhurat nga Taksa Nacionale pritet të realizohen në masën 37 miliardë, duke shënuar një rritje prej 1.8 miliardë lekë ose 5% më shumë sesa parashikuar.

Të ardhurat nga Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore priten të realizohen në masën 88.7 miliardë lekë, duke shënuar një rritje prej 0.5 miliardë lekë ose 1% më shumë se parashikimi. Krahasuar me vitin 2017, të ardhurat nga kontributet rriten me 7%. Rezultatet me rritje të qëndrueshme në arkëtimin e kontributeve janë pasojë e situatës pozitive ekonomike dhe rritjes së numrit të të punësuarve. Ndërkohë, aksioni antiinformalitet ka dhënë efekte të dukshme në formalizimin e tregut të punës. Të ardhurat nga pagesat e sigurimeve shoqërore në bujqësi (bujku) pritet të arkëtohen në masën 3 miliardë lekë.

Krahasimi me vitin 2017 për të Ardhurat Doganore, Tatimore dhe Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore

Viti 2018 pritet të mbyllet me një performancë pozitive në të ardhura, duke shënuar një rritje me 11.7 miliardë lekë, ose +4% kundrejt vitit 2017. Kjo rritje është rezultat i drejtpërdrejtë i efektit të rritjes ekonomike reale, reformave strukturore në ekonomi, aksionit ndaj informalitetit dhe përmirësimit të efikasitetit dhe efikasitetit të administratës fiskale. Nëse nuk do të kishim efekte negative në të ardhurat nga importi si rezultat i kurseve të këmbimit, rritja e të ardhurave do të ishte +7% ose 26.6 miliardë lekë.

- Të ardhurat nga TVSH-ja pritet të jenë +4.3 miliardë lekë ose +3.1% kundrejt vitit 2017.
- Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin, pritet të jenë -0.3 miliardë lekë, ose -1.1% kundrejt vitit 2017.
- Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale, pritet të jenë +5.3 miliardë lekë, ose +16.5% krahasuar me vitin 2017.
- Të ardhurat nga akciza pritet të jenë +0.4 miliardë lekë ose +1% kundrejt vitit 2017.
- Të ardhurat nga taksat nacionale dhe të tjera pritet të jenë +1.6 miliardë lekë ose +4.2% kundrejt vitit 2017.
- Të ardhurat nga taksa doganore pritet të jenë +0.5 miliardë lekë ose +7.8% kundrejt vitit 2017.
- Të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore pritet të jenë +5.9 miliardë lekë ose +6.7% krahasuar me vitin 2017.

Tabela 23

(në milionë lekë)

Tatime dhe Dogana	Fakt 2017	Vlerësim Buxheti 2018	VI Buxh 2018/Fakt 2017	% VI. Buxh 2018/Fakt 2017
Tatimi mbi vlerën e shtuar	139,541	143,800	4,259	3.1%
Tatimi mbi fitimin	31,645	31,300	-345	-1.1%
Akciza	45,105	45,500	395	0.9%
Tatimi mbi të ardhurat personale	32,102	37,400	5,298	16.5%
Taksa nacionale dhe të tjera	38,502	40,100	1,598	4.2%
Taksa doganore	6,492	7,000	508	7.8%
Totali	293,387	305,100	11,713	4%
Kontributet Shoqërore&Shëndetësore	85,601	91,500	5,899	6.7%

Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)*


9.4 ANALIZA E SHPENZIMEVE BUXHETORE PËR PERIUDHËN JANAR-SHTATOR 2018

9.4.1 BUXHETI QENDROR

Të ardhurat e përgjithshme, për muajin e nëntë të vitit 2018, arritën në rreth 328.9 miliardë LEK me një realizim në masën 97.9 përqind të planit të periudhës, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017 ky zë ka rezultuar 2.8 përqind më i lartë ose rreth 8.8 miliardë LEK më shumë. *Në terma vjetorë*, të ardhurat e përgjithshme për 9 mujorin e vitit 2018 u realizuan në masën 70.8 përqind të planit vjetor sipas Buxhetit Fillestar dhe AN nr. 1.

Shpenzimet e përgjithshme publike, për muajin e nëntë të vitit 2018, arritën në rreth 325.2 miliardë LEK me një realizim në masën 96 përqind të planit të periudhës, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017 ky zë ka rezultuar 0.8 përqind më i lartë ose 2.6 miliardë LEK më shumë. *Në terma vjetorë*, shpenzimet e përgjithshme për 9 mujorin e vitit 2018 u realizuan në masën 65.4 përqind të planit vjetor sipas Buxhetit Fillestar dhe të Aktit Normativ nr. 1, datë 26.07.2018. Shpenzimet e përgjithshme për periudhën 9 mujore përbëjnë rreth 19.7 përqind të Produktit të Brendshëm Bruto. Nga grafiku i mëposhtëm vihet re trendi i qëndrueshëm ndër vite, i raportit të shpenzimeve korente kundrejt PBB, me një nivel mesatar prej rreth 20.4 përqind.

Figura 19 Shpenzimet e përgjithshme dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Shpenzimet korrente dhe ato kapitale, kanë shënuar një realizim optimal, respektivisht në masën 97.6 përqind dhe 88 përqind të planit të periudhës. Ndërkohë që, *në terma vjetorë* ato janë realizuar përkatësisht: Shpenzimet korente 69 përqind të planit vjetor sipas Buxhetit Fillestar dhe 68.9 përqind të planit vjetor sipas AN nr.1, shpenzimet kapitale 50.7 përqind të planit vjetor sipas Buxhetit Fillestar dhe 50.5 përqind të planit vjetor sipas AN nr. 1.

Tabela 24 Treguesit fiskalë të konsoliduar për 9 mujorin e vitit 2018 (në milion LEK)

Emertimi	Shtator 2018		Diferenca		Viti 2018			
	Plan	Fakt	Fakt-Plan	ne % mbi Plan	Plani Vjetor Buxhet Filleshtar	Plani Vjetor ANI	% e realizimit Buxhet Filleshtar	% e realizimit ANI
Te Ardhurat e Pergjithshme	335,885	328,910	-6,975	97.9%	464,702	464,703	70.8%	70.8%
Shpenzimet e Pergjithshme	338,742	325,237	-13,505	96.0%	497,069	497,069	65.4%	65.4%
<i>Shpenzimet Korente</i>	288,335	281,470	-6,865	97.6%	407,981	408,778	69.0%	68.9%
<i>Shpenzimet Kapitale</i>	49,719	43,768	-5,951	88.0%	86,388	86,691	50.7%	50.5%
Deficit/Suficit	-2,857	3,673	6,530	228.6%	-32,367	-32,367	111.3%	111.3%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Tabela 25: Treguesit fiskalë të konsoliduar për 9 mujorin e vitit 2017 dhe 2018 (në milion LEK)


Emertimi	Fakt Shtator 2017	Plan 2018	Fakt 2018	Diferenca		Diferenca	
				Fakt 2018	Ne % ndaj Plan 2018	Fakt 2018 Fakt 2017	Ne % ndaj Fakt 2017
Te Ardhurat e Pergjithshme	320,072	335,885	328,910	-6,975	97.9%	8,838	102.8%
Shpenzimet e Pergjithshme	322,603	338,742	325,237	-13,505	96.0%	2,634	100.8%
<i>Shpenzimet Korente</i>	277,626	288,335	281,470	-6,865	97.6%	3,844	101.4%
<i>Shpenzimet Kapitale</i>	41,336	49,719	43,768	-5,951	88.0%	2,432	105.9%
Deficit/Suficit	-2,531	-2,857	3,673	6,530	228.6%	6,204	245.1%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Shpenzimet korrente për periudhën 9 mujore të vitit 2018 rezultuan në rreth 281.5 miliardë LEK, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë ky zë ka rezultuar 1.4 përqind më i lartë ose rreth 3.8 miliardë LEK më shumë. Shpenzimet korrente për periudhën 9 mujore zënë 86.5 përqind të totalit të shpenzimeve ndërkohë që krahasuar me Produktin e Brendshëm Bruto zënë 17 përqind. Nga grafiku i mëposhtëm vihet re trendi i qëndrueshëm ndër vite, i raportit të shpenzimeve korrente kundrejt PBB, me një nivel mesatar prej rreth 17 përqind.

Shpenzimet kapitale për muajin e nëntë të vitit 2018 paraqesin një realizim në masën rreth 43.8 miliardë LEK. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017, ky zë është 5.9 përqind më i lartë ose rreth 2.4 miliard LEK më shumë. Shpenzimet kapitale për periudhën 9 mujore zënë 13.5 përqind të totalit të shpenzimeve ndërkohë që krahasuar me PBB zënë 3 përqind. Edhe për shpenzimet kapitale vihet re një trend i qëndrueshëm për pesë vitet e fundit kundrejt PBB, me një nivel mesatar prej rreth 2.5 përqind.

Figura 20: Struktura e shpenzimeve të përgjithshme dhe raporti me PBB




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Niveli i suficitit në muajin e nëntë të vitit 2018 rezultoi në rreth 3.67 miliardë LEK, ose rreth 6.2 miliardë LEK më i lartë se e njëjta periudhë e një viti më parë ku niveli i deficitit ishte në masën rreth 2.5 miliardë LEK.


Shpenzimet korrente në raport me planin 9 mujor të këtij viti, paraqesin një realizim prej 97.6 përqind, duke rezultuar në rreth 281.5 miliardë LEK. Zërat kryesorë që ndikuan në nivelin e realizimit të shpenzimeve korente kundrejt planit 9 mujor janë përkatësisht: shpenzimet e personelit me 94.9 përqind, shpenzimet për fondet speciale me 98.4 përqind dhe shpenzimet operative mirëmbajtje me 95.2 përqind.

Figura 21: Shpenzimet Korente dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)


Figura 22: Struktura e shpenzimeve korente



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Shpenzimet korrente për periudhën 9 mujore të vitit 2018 rezultuan në rreth 281.5 miliardë LEK ku peshën kryesore e zënë shpenzimet për fondet speciale, me 43 përqind të totalit të shpenzimeve korente. *Shpenzimet e Personelit* gjatë muajit Shtator 2018, përfaqësuan 19.5 përqind të totalit të shpenzimeve korente. Niveli i shpenzimeve faktike të personelit prej rreth 54.8 miliardë LEK, realizon nivelin e parashikuar për këtë zë në planin e periudhës 9 mujore, në masën 94.9 përqind. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017, ky zë është 1.8 përqind më i lartë ose 990 milion LEK më shumë. Në raport me planin vjetor, shpenzimet e personelit janë realizuar 69.5 përqind të planit vjetor sipas Buxhetit Fillestar dhe 70.4 përqind të planit vjetor sipas AN nr. 1.


Figura 23: Shpenzimet e Personelit dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Shpenzimet për Paga në fund të muajit të nëntë të vitit 2018 u realizuan në masën rreth 46.4 miliardë LEK, duke qenë 0.2 përqind më të larta se e njëjta periudhë e vitit 2017, ose 84 milion LEK më shumë. Për rrjedhojë, edhe shpenzimet për sigurime shoqërore rezultuan në masën 2.5 përqind më të larta se një vit më parë ose 183 milion LEK më shumë.


Figura 24: Shpenzimet e Pagave dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Shpenzimet për Interesa gjatë periudhës 9 mujore 2018 kanë përfaqësuar rreth 8.3 përqind të shpenzimeve korente. Niveli faktik i tyre ka rezultuar në masën 94.9 përqind të planit të periudhës. Në raport me planin vjetor sipas Buxhetit Fillestar dhe AN nr.1, në nivel 9 mujori këto shpenzime janë realizuar në masën 56.3 përqind të tyre, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017, ky zë ka rezultuar 8 përqind më i lartë ose rreth 1.7 miliardë LEK më shumë.

Figura 25: Shpenzimet për Interesa (në miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Shpenzimet Operative & Mirëmbajtje, gjatë periudhës 9 mujore 2018, kanë shënuar një realizim në masën rreth 28.8 miliardë LEK, ose 95.2 përqind të planit të periudhës. Niveli faktik i tyre ka rezultuar në masën 63.2 përqind të planit vjetor sipas Buxhetit Fillestar dhe 62.1 përqind të planit vjetor sipas AN nr. 1. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017, ky zë ka rezultuar 3.2 përqind më i lartë, ose 902 milion LEK më shumë.


Figura 26: Shpenzimet Operative dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Shpenzimet për Subvencione, në fund të muajit të nëntë të vitit 2018, arritën nivelin 616 milion LEK, me një realizim në masën 67.9 përqind ose 291 milion LEK më pak se plani i periudhës. Në raport me planin vjetor sipas Buxhetit Fillestar dhe AN nr. 1, ky zë është realizuar në masën 29.4 përqind, ndërkohë që kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2017 shpenzimet për subvencione rezultojnë 52.4 përqind më të ulëta ose 678 milion LEK më pak.


Figura 27: Shpenzimet për Subvencione dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Shpenzimet për Fondet Speciale për muajin e nëntë të vitit 2018 rezultuan në nivelin rreth 120.9 miliardë LEK, me një realizim 98.4 përqind kundrejt planit të periudhës. Përkatësisht, shpenzimet për Sigurime Shoqërore u realizuan në masën rreth 90.4 miliardë LEK, shpenzimet për sigurime shëndetësore në rreth 28.7 miliardë LEK dhe shpenzimet për kompensimin pronarësh në rreth 1.78 miliardë LEK. Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2017, shpenzimet për sigurime shoqërore janë rreth 3.5 miliardë LEK më të larta, shpenzimet për sigurime shëndetësore janë 652 milion LEK më të larta ndërsa shpenzimet për kompensimin e pronarëve janë rreth 2.2 miliardë LEK më të ulëta.

Figura 28: Shpenzimet për Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore (në miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)


Shpenzimet për Papunësinë për 9 mujorin e vitit 2018 janë realizuar në masën 82 përqind e planit të periudhës ose 30.5 përqind e planit vjetor sipas Buxhetit Fillestar dhe 48.9 përqind e planit vjetor sipas AN nr. 1. Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2017 shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një ulje në masën rreth 10 përqind, ose 27 milion LEK më pak në terma nominalë.

Shpenzimet për Ndhmën Ekonomike dhe Pagesën e Paaftësisë (PAK) për periudhën 9 mujore të vitit 2018 u realizuan në masën 97.1 përqind ose 426 milion LEK më pak kundrejt planit të periudhës. Në raport me planin vjetor sipas Buxhetit Fillestar dhe AN nr.1, ato janë realizuar në masën 70 përqind të

tyre. Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2017 shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një ulje në masën 1.4 përqind ose 204 milion LEK më pak në terma nominalë.

Shpenzimet për kompensimin e ish-të përndjekurve politik për periudhën 9 mujore të vitit 2018 u realizuan në masën 49.6 përqind ose 228 milion LEK më pak kundrejt planit të periudhës. Në raport me planin vjetor sipas Buxhetit Fillestar ato janë realizuar në masën 11.2 përqind ndërkohë që, krahasuar me planin vjetor sipas Aktit Normativ nr. 1 ato janë realizuar në masën 22.4 përqind të tij. Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2017 shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një ulje në masën 84 përqind ose rreth 1.17 miliardë LEK më pak në terma nominalë.


Figura 29: Shpenzimet për Ndihmën Ekonomike, PAK dhe Papunësinë (në miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Shpenzimet për Pushtetin Vendor, gjatë periudhës 9 mujore të vitit 2018 kanë përbërë rreth 13.6 përqind të shpenzimeve korente. Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2017 ky nivel rezulton 351 milion LEK më i lartë ose 0.9 përqind më shumë. Kjo rritje vjen në kuadër të përforcimit të rolit të njësisë të reja/të riorganizuar të qeverisjes vendore. Niveli i shpenzimeve për Pushtetin Vendor, për periudhën 9 mujore, arriti në nivelin rreth 38.1 miliardë LEK.

Figura 30: Shpenzimet e Pushtetit Vendor dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë LEK)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Shpenzimet kapitale, në vijim të analizës së ecurisë së realizimit të investimeve publike, për muajin e nëntë të vitit 2018 janë konstatuar me një realizim në masën rreth 43.8 miliardë LEK ose 88 përqind në raport me fondet e planifikuara për këtë periudhë. Respektivisht, projektet e investimeve me financim të brendshëm kanë shënuar një realizim në masën rreth 26.8 miliardë LEK ose 87 përqind të planit të periudhës, ndërkohë që ato me financim të huaj kanë shënuar një realizim në masën rreth 16.5 miliardë LEK ose 89.5 përqind të planit të periudhës.


Krahasuar me planin vjetor, për 9 mujorin e vitit 2018 është konstatuar një realizim i përgjithshëm i investimeve publike në masën 50.7 përqind të planit vjetor sipas Buxhetit Fillestar dhe 50.5 përqind të planit vjetor sipas AN nr. 1. Financimi i brendshëm është realizuar 48.6 përqind i planit vjetor sipas Buxhetit Fillestar dhe 48.4 përqind të planit vjetor sipas AN nr.1. Financimi i huaj është realizuar përkatësisht në masën 54.1 përqind dhe 54 përqind të planit vjetor të Buxhetit Fillestar dhe AN nr.1. Referuar planit vjetor sipas Aktit Normativ nr.1, janë planifikuar 1 miliard lekë hua të kthyer nga sektori energjitik.

Figura 31: Shpenzimet Kapitale dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)


Figura 32: Shpenzimet Kapitale dhe burimi i financimit të tyre (në miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Grafiku i mëposhtëm paraqet ndarjen e **shpenzimeve publike faktike** për 9 mujorin e vitit 2018. Shpenzimet korente për këtë periudhë përbëjnë pjesën më të madhe të shpenzimeve totale faktike me 86.5 përqind, ndërsa shpenzimet kapitale përbëjnë 13.5 përqind.


Figura 33: Detajimi i Shpenzimeve Buxhetore (në milion LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Sikurse evidentohet nga tabela e treguesve fiskal të konsoliduar, realizimi i shpenzimeve të përgjithshme është rreth 325.2 miliardë LEK ose 96 përqind kundrejt planit të periudhës. Kjo situatë është shoqëruar me një suficit buxhetor prej rreth 3.67 miliardë LEK. Grafiku i mëposhtëm tregon tendencat pozitive të treguesve kryesorë të buxhetit të shtetit.

Figura 34: Të ardhurat, shpenzimet dhe deficitit/suficitit - Plan vs Fakt 2018 (në milion LEK)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

9.4.2 BUXHETI VENDOR

❖ Të ardhurat e Pushtetit Vendor

Për 9 mujorin e parë të vitit 2018, njësitë e vetëqeverisjes vendore në nivel kombëtar kanë mbledhur të ardhura (tatimore dhe jo-tatimore) në masën 15.6 miliard lekë dhe krahasuar me njëjtën periudhë të një viti më parë janë 227 milion lekë më shumë ose 1.5 përqind më e lartë. Në mënyrë krahasimore në tabelën e mëposhtme paraqiten nivelet e të ardhurave sipas taksave për të njëjtën periudhë për disa vite.

Figura 35: Të ardhurat sipas burimit për njësitë vendore




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018);

Të ardhurat e qeverisjes vendore ndër vite kanë pësuar ndryshime si në vlerë ashtu dhe në strukturë. Taksat lokale gjenerojnë pjesën më të madhe të të ardhurave vendore me rreth 71% të vlerës totale të tyre. Kjo konfirmon edhe një herë që procesi i decentralizimit kryesisht në vitin 2016 e në vazhdim ka dhënë një efekt pozitiv duke bërë që njësitë e vetëqeverisjes vendore të mbledhin më shumë të ardhura dhe sigurisht të ofrojnë më shumë shërbime dhe investime publike nga të ardhurat që ato vetë gjenerojnë. Pas kësaj takse pjesën më të madhe të të ardhurave e zënë ato që vijnë nga taksa mbi pasurinë, afërsisht rreth 4.2 miliard lekë ose 27 % të totalit të të ardhurave.

Parë në këtë këndvështrim, rritja e efektshmërisë së mbledhjes së taksave nga qeverisja vendore bën të mundur që njësitë të sigurojnë një nivel më të lartë decentralizimi dhe burimesh financiare për të ofruar shërbime dhe investime më të mira vendore. Nëse do ti referohemi zërave të të ardhurave në raport me 9 mujorin e një viti më parë, konstatojmë që në raport me të njëjtën periudhë të një viti më parë kemi një rritje në të gjithë zërat e të ardhurave, si në taksat vendore ashtu edhe në taksën e pasurisë apo atë të biznesit të vogël. Rritje të ndjeshme në raport me të njëjtën periudhë të një viti më parë ka në zërin e taksës së pasurisë ku rezulton të jetë mbledhur rreth 220 milion lekë më shumë. Nga ana tjetër vihet re qëndrueshmëria e taksave vendore përgjatë 9 mujorit të viteve të ndryshme duke siguruar një vlerë në rreth 11 miliard lekë. Taksa e biznesit të vogël nuk ka peshë të lartë në të ardhurat vendore prandaj edhe efekti nuk ka ndikim në ecurinë fiskale të pushtetit vendor për 9 mujorin e vitit 2018. Vlen të theksohet fakti që, reforma në taksën e pasurisë ka dhënë efekte pozitive në rritjen e të ardhurave vendore në raport me një vit më parë, rritje kjo e cila deri në fund të vitit pritet të jetë në trend rritës pozitiv duke u shoqëruara me më shumë të ardhura për pushtetin vendor dhe me shumë mundësi për investime e zhvillim në projektet e njëjësive vendore. Sigurisht ndryshime deri në fund të vitit pritet të ketë edhe në rritjen e të ardhurave nga taksat lokale, të ardhura këto që zënë një pjesë të ndjeshme të buxhetit të njëjësive të vetëqeverisjes vendore.

Figura 36: Të ardhurat totale nga pushteti vendor




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018);

Nga analiza 9 mujore konstatohet që, në tërësi qeverisja vendore ka rritur peshën e të ardhurave të veta vendore në raport me të ardhurat në tërësi. Rritja e të ardhurave të veta vendore është tregues thelbësor i faktit që rritja e autonomisë dhe decentralizimit fiskal ka rritur përgjegjësinë dhe efektshmërinë e ushtrimit të funksioneve nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Gjithashtu kjo rritje në të ardhurat vendore është tregues i performancës në rritje fiskale të pushtetit vendor i cili tashmë ka hyrë në një fazë të re të menaxhimit financiar në nivel vendor. Nga ana tjetër ndërtimi i kadastrës fiskale dhe reforma në taksën e pasurisë, është një tregues që tashmë nga ky burim do të pritët rritje e të ardhurave në mënyrë progresive nga viti në vit.

- *Taksa mbi Pasurinë*

Të ardhurat nga taksa mbi pasurinë përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave të pushtetit vendor. Për 9 mujorin e vitit 2018, kjo taksë është mbledhur në vlerën 4.2 miliardë lekë, ose rreth 220 milion lekë më shumë se 9 mujori i vitit 2017. Parë në këndvështrimin e eficiencës, mbledhja e kësaj takse është përmirësuar në raport me një vit më parë në përputhje me pritshmëritë që ishin nga ndryshimet e ndodhura. Gjithashtu, në kuadër të procesit të reformimit të kësaj takse duke ndryshuar legjislacionin dhe ngritur kadastrën fiskale, nga kjo taksë pritët që në vitin 2019 të rriten të ardhurat duke u bërë kështu një zë i rëndësishëm i të ardhurave të njësitë të vetëqeverisjes vendore. Rritja e të ardhurave nga ky burim do të sigurojë pushtetit vendor konsolidimin e një burimi të rëndësishëm të të ardhurave dhe sigurisht një mundësi më të madhe për të zhvilluar investime publike në nivel vendor.


Figura 37: Të ardhurat nga taksa mbi pasurinë



- *Taksa e biznesit të vogël*

Të ardhurat nga taksa mbi biznesin e vogël, për 9 mujorin e viti 2018, janë realizuar në masën 296 milionë lekë, shifër kjo që vjen me një rritje krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ulja e të ardhurave në raport me vitin 2015 vjen si rezultat i ndryshimeve ku subjektet me një xhiro nga 0-5 milionë lekë janë përjashtuar nga detyrimi tatimor, ndërsa ato me xhiro 5-8 milionë lekë kanë përfituar një reduktim me 2.5% të detyrimit, ndryshime të cilat kanë ndikuar pozitivisht në përmirësimin e klimës së biznesit. Megjithatë këto ndryshime u shoqëruan me masa për kompensimin e këtyre të ardhurave për qeverisjen vendore. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë në 9 mujorin e vitit 2018 janë realizuar rreth 34 milion lekë të ardhura më shumë nga taksa e biznesit të vogël. Ky burim i të ardhurave vendore zë një peshë të vogël në raport me burimet e tjera të të ardhurave vendore, duke dhënë ndikim relativisht të vogël.


Figura 38: Të ardhurat nga taksa mbi biznesin e vogël



- *Taksat lokale*

Të ardhurat nga taksat lokale, vazhdojnë të konsolidojnë trendin në rritje që nga fillimi i zbatimit të reformës administrativo-territoriale. Për 9 mujorin 2018, këto taksa janë mbledhur në vlerën 11.1 miliardë lekë, ose rreth të njëjtës vlerë të një viti më parë. Rritja e kapaciteteve të krijuara nga njësitë e reja dhe kontrolli më i mirë i shtrirjes territoriale ka rritur mbledhshmërinë e këtyre taksave duke ndikuar pozitivisht në qëndrueshmërinë financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore. Gjithashtu, rritja e të ardhurave nga ky burim dhe fakti që përbëjnë peshën më të madhe të të ardhurave vendore tregon qartë rritjen cilësore në drejtim të decentralizimit fiskal të pushtetit vendor.

Figura 39 :Të ardhurat nga taksat lokale




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018);

❖ Shpenzimet e qeverisjes vendore

Shpenzimet e qeverisjes vendore janë një tregues i rëndësishëm i procesit të menaxhimit të financave publike në nivel vendor dhe tendencave zhvillimore të ekonomisë në tërësi. Rritja e peshës së shpenzimeve të pushtetit vendor në raport me peshën që zënë shpenzimet e buxhetit qendror ndaj produktit të brendshëm bruto përbëjnë një tregues të rëndësishëm të përpjekjes për thellimin e decentralizimit fiskal vendor. Ndër vite shpenzimet e qeverisjes vendore janë një tregues në rritje dhe kjo vjen si pasojë e rritjes së nivelit të shërbimeve dhe funksioneve që qeverisja vendore ofron për qytetarët e saj të financuara nëpërmjet rritjes së të ardhurave vendore dhe mbështetjes financiare nga qeveria qendrore. Rritja e kompetencave dhe hapësirës administrative ka bërë që tashmë njësitë e vetëqeverisjes vendore të rrisin përgjegjësinë, transparencën dhe konsultimin publik në përdorimin e financave publike vendore.

Buxheti vendor ndër vite ka një rritje të dukshme që është rrjedhojë e decentralizimit fiskal në aspektin e mbledhjes dhe përdorimit në mënyrë autonome të të ardhurave dhe rritjes së transfertave buxhetore nga qeveria. Kjo reflektohet edhe në nivelin e shpenzimeve për 9 mujorin e vitit 2018, në raport me atë të vitit 2017. Nga grafiku i mëposhtëm kuptohet qartë që buxheti i qeverisjes vendore tashmë është drejt konsolidimit duke paraqitur vlerë të njëjtë në raport me një vit më parë. Viti 2018, për financat vendore konsiderohet si viti i qëndrueshmërisë fiskale në kënvështimin e menaxhimit të plotë pas periudhës tranzitore të reformës administrativo-territoriale por gjithashtu edhe nën kuadrin e ri ligjor e nënligjor për menaxhimin financiar vendor. Në tërësi, të gjithë zërat e buxhetit vendor kanë patur rritje në raport me 9 mujorin e vitit 2017, kjo tregon që tashmë njësitë vendore po shikojnë me prioritet rritjen e investimeve dhe cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve.


Figura 40: Shpenzimet për pushtetin lokal dhe ritmi i rritjes së tyre



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018);

Shpenzimet e pushtetit vendor sipas zërave kanë pësuar luhatje në vitin 2018 krahasuar me vitin 2017. Në vitin 2018, shpenzimet e personelit kanë pësuar një rritje të lehtë në raport me një vit më parë, rritje kjo e cila nuk ka një ndikim të ndjeshëm në strukturën e shpenzimeve. Tashme shpenzimet e personelit kanë marrë një natyrë të qëndrueshme në vite, tregues ky që reflekton mbylljen e periudhës tranzitore të konsolidimit të njësisive të reja vendore. Gjatë 9 mujorit të vitit 2018, konstatohet rritje në zërin shpenzime operative të pushtetit vendor në raport me një vit më parë, kjo rritje vjen kryesisht si rrjedhojë e nevojës për mirëmbajtje të investimeve të kryera nga njësitë vendore në vitet e mëparshme. Qëndrueshmëria e shpenzimeve për investime dhe lidhja e tyre me shpenzimet operative tregon qartë që shumë shpejt kjo do të shoqërohet me efekte të drejtpërdrejta pozitive në punët publike, dhe cilësinë e shërbimeve të cilat ndikojnë në jetën e qytetarëve. Njësitë e vetëqeverisjes vendore tashmë janë më të përgjegjshme si në drejtim të rritjes së cilësisë së shërbimeve që ofrojnë por edhe të volumit të punëve publike të cilat ato duhet të kryejnë për përmirësimin e jetës së qytetarëve.

Figura 41: Shpenzimet e qeverisjes vendore sipas strukturës ekonomike



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018);

Pas miratimit dhe jetësimit të reformës administrativo-territoriale janë bërë analiza periodike të ecurisë së shpenzimeve vendore në raport me shpenzimet para reformës, kryesisht në termat e tendencës së shpenzimeve të personelit dhe atyre kapitale. Krahasuar me vitin 2014 si vit para reformës konstatohet se ka një ndryshim të strukturës së shpenzimeve në favor të rritjes së shpenzimeve kapitale. Gjithashtu shpenzimet nga viti në vit konsolidohen dhe orientohen në investime dhe shërbime publike. Më poshtë

paraqitet në mënyrë të përmbledhur tabela e ndryshimeve të të ardhurave dhe shpenzimeve në financat publike vendore midis të njëjtës periudhë të vitit 2018 dhe 2017.

Tabela 26: Të ardhurat dhe shpenzimet e qeverisjes vendore sipas natyrës

Të dhëna progresive (në milion LEKË)

Nr	E M Ë R T I M I	Fakt 9 mujori		Diferenca	
		2018	2017	2018 / 2017	% e 2018 kundrejt 2017
I.	Të ardhura nga Pushteti vendor	15.585	15.358	227	101%
I.1	<i>Taksa mbi pasurinë</i>	4.224	4.009	215	105%
I.2	<i>Taksa e biznesit të vogël</i>	296	262	34	113%
I.3	<i>Taksa Lokale</i>	11.065	11.087	-22	100%
II.	Shpenzime nga Pushtetit Vendor	38.147	37.795	352	101%
II.1	Shpenzime Korente	26.474	24.123	2.351	110%
	<i>Personeli</i>	15.400	14.890	510	103%
	<i>Shpenzime Oper. Mirmbajtje</i>	10.284	8.346	1.938	123%
	<i>Interesa</i>	94	33	61	285%
	<i>Subvencione</i>	402	428	-26	94%
	<i>Te tjera</i>	294	426	-132	69%
II.2	Shpenzime Kapitale	11.673	13.672	-1.999	85%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018);

Shpenzimet e Personelit, përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve totale të njësive të vetëqeverisjes vendore. Për 9 mujorin e vitit 2018, këto shpenzime janë realizuar në masën 15.4 miliard lekë ose rreth 500 milion lekë më shumë se e njëjta periudhë e vitit 2017. Rritja e lehtë e këtyre shpenzimeve për vitin 2018, argumentohet me faktin se në buxhetin e vitit 2018 u konsoliduan strukturat organizative të njësive të reja të vetëqeverisjes vendore. Në buxhetin e vitit 2018, në vijim të konsolidimit të funksioneve të decentralizuara në vitin 2016, u shtua numri i punonjësve për funksione si: shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (zjarrëfikës) në 13 bashki, administrimi i pyjeve (roje pylli) etj. Nga ana tjetër edhe rritja e pagave e aplikuar për funksionet e decentralizuara në vitin 2016 ka ndikuar në rritjen e shpenzimeve të personelit. Po ashtu shtimi i investimeve, e për rrjedhojë shtimi i aseteve vendore kanë kërkuar në njësitë respektive edhe shtim të shpenzimeve të personelit me qëllim ofrimin e shërbimit sa më afër qytetarëve, detyra të cilat janë konsoliduar një vit më parë dhe këtë vit është ndjekur trendi i vitit 2017. Në këto kushte, themi që tashmë njësitë vendore kanë strukturuar plotësisht organizimin funksional sipas ndarjes administrativo territoriale e si rrjedhim peshë e shpenzimeve të personelit për ofrimin cilësor të shërbimit ndaj qytetarëve ka mbetur i njëjtë në raport me një vit më parë. Po të abstragojmë faktorët objektiv që kanë ndodhur pas reformës administrativo territoriale si; decentralizimi i funksioneve në vitin 2016 dhe politika e rritjes së pagave, shpenzimet e personelit rezultojnë më të ulta krahasuar me periudhën para reformës.

Shpenzimet Operative, të cilat janë shumë të rëndësishme për mbarëvajtjen dhe ushtrimin e funksioneve, rezultojnë me një rritje të ndjeshme në 9 mujorin e vitit 2018, në krahasim më të njëjtën periudhë të një viti më parë. Shpenzimet operative përbëjnë rreth 27% të totalit të shpenzimeve të pushtetit vendor për 9 mujorin e vitit 2018. Në vlerë absolute në 9 mujorin e vitit 2018, janë shpenzuar rreth 10.2 miliard lekë ose e thënë ndryshe rreth 1.9 miliard lekë më shumë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Faktorët

që kanë ndikuar në rritjen e nivelit të shpenzimeve operative janë të lidhura me rritjen e nevojës për mirëmbajtje për funksionet e transferuara në vitin 2016, përmirësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve publike vendore, si dhe shtimin e aseteve të ndryshme nga investimet që kërkojnë shpenzime për ruajtje dhe mirëmbajtje. Por nga ana tjetër vihet re tendenca e rritjes nga viti në vit e peshës që zënë shpenzimet operative në totalin e shpenzimeve, kjo për shkak se tashmë shpenzimet për investime të realizuara kanë nevojë për mirëmbajtje të vazhdueshme.

Shpenzimet për subvencione dhe të tjera, janë shpenzimet që zhvillojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore për të paguar interesat, për të subvencionuar politikatat e ndryshme vendore, dhe mbuluar funksione të tjera administrative. Në këto kushte nga sa përcaktohet në tabelën mësipër në raport me 9 mujorin e vitit 2017, këto shpenzime në 9 mujorin e vitit 2018 kanë një rënie të lehtë nga 887 milion lekë në rreth 790 milion lekë. Këto ndryshime janë rezultat i procesit të riorganizimit dhe të shtrirjes së re që kanë marrë njësitë e vetëqeverisjes vendore ku nën juridiksionin administrativ tashmë përmbajnë më shumë përgjegjësi për të ushtruar. Në mbështetje të të dhënave konstatohet një rritje e shpenzimeve për interesa dhe rënie në shpenzimet për subvencione dhe të tjera. Njësitë e reja të vetëqeverisjes vendore duhet në të ardhmen të kenë strategji afatgjata në ofrimin e shërbimeve publike sa më afer qytetarëve, në mënyrë të tillë që efienca e ofrimit të shërbimit të rritet ndjeshëm.

Shpenzimet Kapitale, janë një zë mjaft i rëndësishëm jo vetëm për faktin që përbëjnë pjesë të madhe të buxhetit vendor por edhe për shkak se këto shpenzime janë ato që ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen ekonomike dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës së qytetarëve. Nga tabela e mësipërme vëmë re që shpenzimet për investime krahasuar me të njëjtën periudhë kanë një rënie të lehtë. Ky ndryshim vjen për shkak se, tashmë njësitë re vetëqeverisjes vendore investimet e realizuara në vitet e mëparshme kërkojnë ti mirëmbajnë dhe të rrisin jetëgjatësinë e tyre.

Në tërësi shpenzimet për investime pas reformës administrative territoriale kanë ardhur gjithmonë e në rritje, tregues ky i një performance më të mirë vendore dhe që ka ndikuar në rritjen e punëve publike që po realizojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Në periudhë afatgjatë vazhdimi i kësaj tendence rritëse të shpenzimeve për investime nga njësitë e vetëqeverisjes vendore do të sigurojë vepra infrastrukturore dhe punë publike në interes dhe favor të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.


Treguesit fiskal të qeverisjes vendore të 9 mujorit të vitit 2018, premtojnë një optimizëm për vazhdimësinë e tyre pozitive edhe për muajt e mbetur të vitit buxhetor 2018. Si rrjedhojë, parashikohet që edhe për vitin 2019 njësitë e vetëqeverisjes vendore të kenë një buxhet më të plotë financiarisht dhe më të konsoliduar..

9.5 ECURIA E BORXHIT PUBLIK PËR PERIUDHËN JANAR-SHTATOR 2018

Borxhi i Qeverisjes Qendrore gjatë periudhës Janar-Shtator 2018 është karakterizuar nga një ecuri pozitive, kryesisht në aspektin e plotësimit të nevojave të qeverisë për likuiditet, në aspektin e përmirësimit të raporteve ndërmjet kostos dhe riskut, si dhe në aspektin e aktiviteteve të ndërmarra në kuadër të zhvillimit të tregut primar dhe krijimit të kushteve për zhvillimin e tregut sekondar.

Në fund të muajit Shtator 2018, Borxhi i Qeverisjes Qendrore u vlerësua në nivelin 1,087.3 miliard Lek ose 66.0% e PBB³. Duke iu referuar deficitit buxhetor të planifikuar, parashikimeve të rritjes ekonomike dhe kursit të këmbimit, në fund të vitit 2018 borxhi i Qeverisjes Qendrore në raport me PBB pritet të ulet me rreth 1.0 pikë përqindje krahasuar me vitin e kaluar, duke vazhduar tendencën rënëse në përputhje me objektivat e qeverisë për uljen e borxhit.


Figura 42: Borxhi i Qeverisjes Qendrore në vlerë absolute dhe relative ndaj PBB (2014–Shtator 2018)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Peshën më të madhe në stokun e borxhit të qeverisjes qendrore vazhdojnë ta mbajnë instrumentet e tregtueshme (*bono thesari, obligacione, eurobond*) dhe huatë e huaja me destinacion financimin e projekteve. Niveli i borxhit të brendshëm dhe atij të jashtëm në raport me totalin e borxhit të qeverisjes qendrore janë përkatësisht rreth 54% dhe 46%, duke ruajtur pothuajse të njëjtat raporte me fundin e vitit të kaluar, si edhe duke qenë në linjë me objektivat e vendosura në SAMB në kuadër të menaxhimit të riskut të kursit të këmbimit.

Figura 43: Përbërja e borxhit të Qeverisjes Qendrore në raport me totalin (2014–Shtator 2018)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)


Përbërja e Borxhit Shtetëror

Gjatë nëntëmujorit të vitit 2018, ashtu si edhe gjatë vitit paraardhës, në përputhje me politikat menaxhuese për uljen e ekspozimit ndaj risqeve, ka vazhduar tendenca e rritjes së peshës së titujve afatgjatë (*mbi 5 vite*) në portofolin e borxhit të brendshëm. Gjithashtu, pesha e titujve me norma interesi

³ PBB mbi bazë vjetore; referuar të dhënave të Draft-Kuadrit Makroekonomik 2020-2022, datë 12.10.2018

të ndryshueshme është reduktuar, pasi edhe gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur asnjë emetim të titujve me norma interesi të ndryshueshme.


Figura 44: Kompozimi i Borxhit të Brendshëm Shtetëror (2014-Shtator 2018)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Për sa i përket kompozimit të portofolit të borxhit të jashtëm, peshën më të madhe të stokut të borxhit të jashtëm vazhdon ta mbajë borxhi me terma koncesionale, duke mundësuar optimizimin e kostove dhe diversifikimin e burimeve të financimi

Figura 45



Kompozimi i borxhit të jashtëm shtetëror sipas koncesionalitetit dhe instrumenteve (2014–Shtator 2018)

Realizimi i Huamarrjes

Huamarrja gjatë nëntëmujorit të vitit 2018 u realizua me sukses, duke mundësuar rifinancimin e borxhit ekzistues dhe mbulimin e nevojave të qeverisë për likuiditet në përputhje me objektivat strategjikë për ruajtjen e qëndrueshmërisë së raporteve ndërmjet kostos dhe risqeve.

Huamarrja e Brendshme

Gjatë periudhës Janar-Shtator 2018, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka emetuar në tregun e brendshëm tituj shtetërorë në vlerën 249.3 miliard Lek, nga të cilat 219.6 miliard Lek kanë shërbyer për rifinancimin e titujve ekzistues dhe pjesa tjetër (29.7 miliard Lek) për financimin e deficitit buxhetor të planifikuar për vitin 2018 dhe menaxhimin aktiv të likuiditetit. Në linjë me objektivin për reduktimin e ekspozimit ndaj risqeve, financimi neto është siguruar në masën 89.5% nëpërmjet titujve afatgjatë.

Tabela 27: Huamarrja shtetërore nga burime të brendshme në terma bruto dhe neto

Huamarrja e Brendshme	Janar-Shtator 2018			
	Emetim (në mld Lek)	Maturim (në mld Lek)	Huamarrja Neto (në mld Lek)	Huamarrja Neto (në %)
Tituj Afatshkurtër	169.8	166.7	3.1	10.5%
Bono Thesari në Lek	169.8	166.7	3.1	10.5%
Bono Thesari në Euro	0.0	0.0	0.0	0.0%
Tituj Afatgjatë	79.5	52.9	26.5	89.5%
Obligacione 2 vjeçare	36.4	27.4	9.0	30.4%
Obligacione 3 vjeçare	5.0	8.1	-3.1	-10.4%
Obligacione 5 vjeçare	20.0	17.4	2.6	8.7%
Obligacione 7 vjeçare	8.9	0.0	8.9	30.1%
Obligacione 10 vjeçare	9.1	0.0	9.1	30.8%
Gjithsej Tituj Shtetërorë	249.3	219.6	29.7	100.0%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Huamarrja e Huaj

Në periudhën Janar-Shtator 2018, huamarrja e huaj në terma bruto rezulton në vlerën 11.0 miliard Lek dhe është realizuar kryesisht nëpërmjet huave që financojnë projektet ekzistuese. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraardhës, huamarrja e huaj ka rënë me rreth 26.2 miliard Lek, kryesisht për shkak të mungesës së disbursimeve në formën e mbështetjes buxhetore.

Tabela 28: Huamarrja e huaj në terma bruto

Disbursime të borxhit të jashtëm shtetëror	Janar-Shtator 2017		Janar-Shtator 2018	
	në mld Lek	në %	në mld Lek	në %
Hua për financim projektësh	17.5	47.2%	10.9	99.7%
Energjia	2.6	6.9%	3.0	27.6%
Transporti	7.3	19.6%	2.7	25.0%
Ujësjellës-Kanalizime	4.7	12.8%	3.2	29.4%
Infrastruktura Urbane	2.6	7.0%	0.9	8.7%
Të Tjera	0.3	0.9%	1.0	9.1%
Mbështetje Buxhetore	19.6	52.8%	0.0	0.3%
Total Huamarrja e Huaj	37.2	100.0%	11.0	100.0%


Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Kostot dhe Risqet

Kostot

Shpenzimet për interesa gjatë periudhës Janar-Shtator të vitit 2018 janë vlerësuar në 23.3 miliard Lek. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017, shpenzimet për interesa të borxhit shtetëror janë rritur me rreth 1.7 miliard Lek. Rritja e shpenzimeve për interesa është në linjë me pritshmëritë dhe i atribuohet kryesisht rritjes së normave të interesit të titujve shtetërorë përgjatë vitit 2017 dhe rritjes së stokut të borxhit shtetëror në vlerë absolute.

Figura 46 Interesat e Borxhit Shtetëror në vlerë absolute dhe relative ndaj PBB



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Risqet

Gjatë nëntëmujorit të vitit 2018 ekspozimi i portofolit të borxhit ndaj risqeve është menaxhuar me sukses, në linjë me objektivat strategjikë afatmesëm. Ulja e peshës së titujve afatshkurtër dhe atyre me norma interesi të ndryshueshme në portofolin e borxhit të brendshëm, ka qenë faktori mbizotërues në uljen e riskut të rifinancimit dhe riskut të normave të interesit. Pesha e titujve afatshkurtër dhe atyre me norma interesi të ndryshueshme janë ulur përkatësisht me 1.24 pp dhe 1.60 pp.

Risku i rifinancimit është përmirësuar, pasi jetëgjatësia e borxhit të brendshëm është rritur me 10 ditë duke prekur nivelin e 790 ditëve në fund të muajit shtator 2018, krahasuar me 780 ditë në fund të vitit 2017.

Risku i normave të interesit gjithashtu është reduktuar, pasi pesha e instrumenteve që rivlerësojnë normën e interesit në harkun kohor të një viti është ulur nga 56.7% në dhjetor 2017 në 56.4% në shtator 2018.

Tabela 29: Treguesit e riskut të normave të interesit (2016–Shtator 2018)

Treguesi	2016	2017	Shtator 2018
Borxhi me normë fikse ⁴ /Total	47.5%	55.6%	58.4%
Borxhi i rivlerësuar në një vit	62.6%	56.7%	56.4%
KMR (në vite)	1.80	1.96	2.07

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Zhvillimet e Tregut Primar të Titujve Shtetërorë


⁴ Nuk përfshihen bonot e thesarit. Pavarësisht faktit që janë instrumente me norma interesi fikse, në aspektin e riskut të normave të interesit paraqesin karakteristika të njëjta me titujt me norma interesi të ndryshueshme.

Tregu primar i titujve shtetërorë gjatë nëntëmujorit të vitit 2018 përgjithësisht është karakterizuar nga zhvillime pozitive, ndër të cilat mund të përmenden: i) kërkesa e kënaqshme e tregut në raport me nevojat e qeverisë për huamarrje; ii) rritja e kërkesës për tituj shtetërorë në drejtim të individëve; iii) qëndrimi i normave të interesit të titujve shtetërorë në nivele të krahasueshme me ato të vitit 2017; iv) zbatim i Projektit Pilot për obligacionin referencë 5 vjeçar.

Ecuria e ankandeve dhe kërkesa për titujt shtetërorë

Gjatë periudhës Janar-Shtator të vitit 2018 kërkesa për tituj shtetërorë ka rezultuar në vlerën 320.8 miliard Lek, nga të cilat 213.6 miliard Lek për Bono Thesari dhe 107.2 miliard Lek për Obligacione. Kërkesa gjatë nëntëmujorit të vitit 2018 ka qenë relativisht më e lartë se oferta e qeverisë për tituj shtetërorë duke rezultuar në një raport të përgjithshëm mbulimi prej 1.25. Gjithsej gjatë këtij nëntëmujori janë realizuar 44 ankande, nga të cilat vetëm 7 ankande nuk janë plotësuar.

Figura 47 Raporti i mbulimit të ankandeve të titujve shtetërorë (Janar–Shtator 2018)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Gjatë nëntëmujorit 2018, është vënë në zbatim *Projekti Pilot* në lidhje me obligacionin referencë 5 vjeçar. Në ankandet e obligacioneve referencë 5 vjeçare lejohet të marrin pjesë vetëm zhvilluesit e tregut (*market makers*), të cilët janë 5 banka të nivelit të dytë që marrin përsipër të tregtojnë këtë titull në tregun sekondar, duke kontribuar në këtë mënyrë në zhvillimin e aktivitetit të tregut sekondar.

Gjatë periudhës Janar-Shtator 2018 karakteristike ka qenë rritja e konsiderueshme e kërkesës nga *Individët*, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Rritja e kërkesës nga *Individët* reflekton normat e interesit më të favorshme që ofrojnë titujt shtetërorë krahasuar me depozitat bankare.


Figura 48: Kërkesa për tituj shtetërorë në tregun e brendshëm



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Gjatë nëntëmujorit të vitit 2018 normat mesatare të ponderuara të titujve shtetërorë kanë shfaqur një tendencë të moderuar rritëse në segmentin e titujve afatgjatë, ndërkohë që janë shoqëruar me rënie në segmentin e bonove të thesarit.

Figura 49: Kurba e yield-it mesatar të ponderuar të titujve shtetërorë



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Pritshmëritë e Borxhit për vitin 2019

Referuar parashikimeve të rritjes ekonomike, si edhe deficitit buxhetor të planifikuar, niveli i borxhit publik në raport me PBB parashikohet të ulët me rreth 3.6 pp gjatë vitit 2019.

Nga pikëpamja e kompozimit të borxhit pritet të ketë një rritje në favor të borxhit të denominuar në monedhë vendase dhe atij afatgjatë në portofolin e borxhit të brendshëm.

Huamarrja e brendshme do të realizohet nëpërmjet titujve shtetërorë në përputhje me kapacitet e kërkesës, ndërkohë që financimi i huaj do të realizohet nëpërmjet disbursimit të huave që financojnë ecurinë e zbatimit të projekteve prioritare të qeverisë.

Normat e interesit të titujve shtetërorë pritet të jenë të qëndrueshme, të paktën deri në gjysmën e parë të vitit 2019, duke marrë në konsideratë vijimin e politikave monetare lehtësuese të Bankës së Shqipërisë, si edhe efektet që pritet të krijojnë flukset monetare hyrëse të Eurobond-it të emetuar në tremujorin e fundit të vitit 2018.

Tendenca e normave të interesit në tregjet e huaja paraqitet më pak e qartë, për shkak të divergjencave në politikat monetare të BQE dhe Rezervës Federale. Në këto kushte, vlerësimet aktuale për vitin 2019 parashikojnë një rritje të normave të interesit, kryesisht për huamarrjen në monedhën USD dhe një qëndrueshmëri ose rritje më të moderuar për huamarrjen në monedhën Euro. Në këto kushte, kostot për njësi të borxhit të brendshëm dhe atij të huaj pritet të qëndrojnë pothuajse në nivele të krahasueshme me ato të vitit 2018.

Shpenzimet për interesa të borxhit parashikohen pothuajse në nivele të krahasueshme me vitin 2018, duke reflektuar nivelin e ulët të normave të interesit aktuale, si edhe efektin që krijon procesi i blerjes mbrapsht së Eurobondit ekzistues (*buyback*) në shpenzimet për interesa të borxhit të jashtëm.

Tabela 29: Shërbimi i Borxhit Shtetëror të pritshëm 2018-2019

(në milion Lek)

Shërbimi	Jan-Sht 2018 (Fakt)	2018 (I pritshmi)	2019 (Parashikim)
I. Shërbimi i Borxhit Shtetëror	41,821.1	91,697.0	72,797.0
i. Interesat e Borxhit Shtetëror	23,343.8	37,207.0	37,400.0
- Interesat e Borxhit të Brendshëm	17,816.7	23,350.0	24,500.0
- Interesat e Borxhit të Jashtëm	5,527.1	13,857.0	12,900.0
ii. Ripagesat e Borxhit të Jashtëm	18,477.3	54,490.0*	35,397.0

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

*Është përfshirë pagesa për parablerjen e Eurobond-it ekzistues në vlerën 200 milion Euro

9.6 LISTA E KONCENSIONEVE AKTIVE DHE TË PLANIFIKUARA

Kategoria	Lloji	Objekti i Kontratës	Vlera e Plotë e Kontratës (në lekë)
Sektori i Shendetesise			22,208,400,000
	Kontrate Sherbimesh		22,208,400,000
		Ofrimi i setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale, material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimi i mbetjeve biologjike dhe dezinfektimi i sallave kirurgjikale.	12,300,000,000
		Shërbimi i Hemodializës	1,147,500,000
		Për paketën e shërbimeve të kontrollit mjekësor bazë për grupmoshat 40-65 vjeç	8,760,900,000
Sektori Tatimor dhe Doganor			28,163,764,824
	Kontrate Sherbimesh		28,163,764,824
		Financimi, ngritja dhe operimi i shërbimit të skanimit të konteineve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë.	27,663,364,824
		Shërbimi i markimit dhe monitorimit të karburanteve	500,400,000
Zhvillim Ekonomik			1,435,691,880
	Kontrate Sherbimesh		1,435,691,880
		Për dhënie me koncesion të prodhimit të kripës Natë Vlorë	1,400,000,000
		Për Dhënie me Koncesion të Rregjistrimit të Barreve Siguruese	35,691,880
Total			544,756,232,622

Koncesione/PPP v.2019

Kategoria	Lloji	Objekti i Kontratës	Vlera e kontrates
Sektori i Arsimit			10,158,000,394
	Ndërtim, Operim, Transferim		10,158,000,394
		Ndërtimi i Shkollave në Arsimin Parauniversitar në Bashkinë e Tiranës (Proces)	10,158,000,394
Sektori i Shendetesise			18,656,120,000
	Ndërtim, Operim, Transferim		9,598,120,000
		Spitali Rajonal i Fierit	9,598,120,000
	Kontrate Sherbimesh		9,058,000,000
		Ofrimi i shërbimeve laboratorike spitalore	9,058,000,000
Sektori i Transportit			233,848,224,425
	Ndërtim, Operim, Transferim		84,374,224,425
		Ndërtimi dhe Operimi i Rruges Milot - Balldren	29,337,997,500
		Ndërtimi dhe Operimi i Rruges Onikum - Himarë	9,466,166,925
		Ndërtimi dhe Operimi i Aksit Tirane-Thumane-Vorë	45,570,060,000
	Ndërtim, Operim, Mirembajtje		149,474,000,000
		Aeroporti i Vlores	14,690,000,000
		Aeroporti i Kukësit	884,000,000
		Autostrada Keshar-Rrogozhinë	84,760,000,000
		Autostrada Tirane-Durres	49,140,000,000
Total			262,662,344,819

PBB nominal 2019	Vlera totale e kontratave	PPP ne % te PBB
1,752,735,842,766	807,418,577,441	46%

KËSHILLI I MINISTRAVE